








VLERËSIM STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

KOMUNA E SHTËRPCËS

Komuna e Shtërpcës

2020

INSTITUTI PËR SHKENCË DHE TEKNOLOGJI - INSI SH.P.K

PËRMBAJTJE

1. HYRJE 4
2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE 7
3. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-SË 13
4. PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL (INFORMATAT E RËNDSISHME PËR VSM) . 18
5. PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I SHTËRPCËS 64
6. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E VEÇANTA 66
7. HISTORIKU I PLANEVE DHE ANALIZË E SITUATËS EKZISTUESE NË FUSHËN E MJEDISIT DHE TË PLANIFIKIMIT 72
7.1 PROBLEMATIKA TË ZHVILLIMIT DHE PLANIFIKIMIT KOMUNAL NË SHTËRPCËS 72
7.2 PROJEKSIONET SIPAS VENDBANIMEVE 72
7.3 ZHVILLIMI EKONOMIK 74
7.4 KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR 76
7.5 PLANI I SHFRYTZIMIT TË TOKËS 83
7.6 RRJETI RRUGOR DHE TRANSPORTI PUBLIK 84
8. KONSIDERATA MBI ALTERNATIVAT E KONCEPTIT TË SHPËRNDARJES HAPËSINORE NË KOMUNËN E SHTËRPCËS 85
8.1 SHKALLA QË PZHK-JA NDIKON NË PLANET E TJERA 86
9. KUSHTET TJERA MJEDISORE TË KOMUNËS SË SHTËRPCËS 87
9.1 POPULLSIA DHE SHËNDETI 87
9.2 SHËNDETI 87
9.3 ÇESHTJE EKZISTUESE MJEDISORE TË LIDHURA ME POPULLSINE DHE SHËNDETIN 88
9.4 MJEDISI FIZIK 88
9.5 ZONIMI I TERRITORIT TË KOMUNËS SË SHTËRPCËS 89
11. PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QE KUFIZOJNE ZHVILLIMIN KOMUNAL 102
11.1 OBJEKTIVA STRATEGJIKE 103
11.2 VEPRIME OPERACIONALE NE MBESHTETJE TE OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE 104
11.3 KRITERET MJEDISORE QE KUFIZOJNE ZHVILLIMIN KOMUNAL 105
12. NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE .. 108
13. EFEKTET KUMULATIVE 123
13.1 PROBLEME TË MJEDISIT NË SHTËRPCËS DHE PËRGJIGJA QË JEPET PËRMES PZHK-SË 125
14. MONITORIMI 137
15. PERFUNDIME DHE REKOMANDIMET 143
16. LITERATURA 146

LISTA E SHKURTIMEVE

AKMM Agjencia Kosovarë për Mbrojtjen e Mjedisit

BE Bashkimi Evropian

KSH Komuna e Shtërpcës

GIS Sistemit i Informacionit Gjeografik

GNP Grimcat e Ngurta Pezull

NOQ Ndotësa Organike të Qëndrueshem

OBSH Organizata Botërore e Shëndetësisë

OJQ Organizata Jo Qeveritare

SDG Sustainable Development Goals

OZHM Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

PZHK Plani Zhvillimor Komunali

HZK Harta Zonale Komunale

PRRH Plani Rregullues Urban

TeR Termat e Referencës

UNDP Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara

UNEP Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara

VNM Vlerësim i Ndikimit në Mjedis

VSM Vlerësim Strategjik Mjedisor

ZVM Zona të Veçanta të Mbrojtura

1. HYRJE

Komuna e Shtërpcës siç dihet ka një potencial të konsiderueshëm të vlerave mjedisore në krahasim me komunat tjera të rajonit dhe nihet si vend turistik në rajon dhe më gjerë për shkak të këtyre vlerave që ka. Janë të njohura ndryshimet që ka pësuar në dekadat e fundit. Planet e mëhershme që kanë mbuluar territorin e Kosovës, rajonit edhe komunës së Shtërpcës para luftës dhe decentralizimit pas ndryshimeve ishin jashtë funksionit, ndryshimet e vrullshme për shkak të kërkesave të reja për njësi banimi sidomos villave dhe objekteve hoteliere në territorin e komunës së Shtërpcës ka ndodhur edhe një tjetërsim intensiv në përdorimin e tokës, duke konvertuar në truall ndërtimi sipërfaqe të gjera dikur me përdorim bujqësor në periferi të disa vendbanimeve dhe përgjat rrugëve, dhe duke rritur intensitetin dhe koeficientin e ndërtimit.

Në të kaluarën popullsisa ka qenë e akomodimodur në mënyrë të paplanifikuar, dhe e përqëndruar sidomos në zonat periferike të vendbanimeve dhe në zonat afër rrugëve. Kjo gjë ka vënë nën presion edhe infrastrukturën dhe shërbimet ekzistuese, të cilat nuk kanë arritur tu përgjigjen kërkesave në rritje si pasojë e këtij zhvillimi. Orientimi i zhvillimit të Shtërpcës për të siguruar shërbime efektive (dhe funksionale) dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së aspekteve mjedisore të komunës ka qenë i tillë që as nuk i është afruar niveleve të planifikuara apo të kërkuara. Sigurisht, zhvillimet ekzistuese për Shtërpcës, janë të pamjaftueshëme dhe jorealiste për t'iu përgjigjur nevojave hapësinore dhe kërkesave të zhvillimit të Shtërpcës së 20 viteve të fundit.

Duke qenë të ndërgjegjshëm për situatën, dhe duke njohur nevojën për orientim të zhvillimit në Shtërpc, Komuna e Shtërpcës vendosi të zhvillojë Planin Zhvillimor Komunal.

Procesi dhe qëllimet e zhvillimit të planit nga detyra projektuese përmblidhen si mëposhtë:

• Të japë një profil të gjendjes së tanishme për të patur një analizë të faktorëve me ndikim në zhvillimin e komunës së Shtërpcës, si tani edhe në të ardhmen;

• Të bëjë një analizë të profilit të siguruar duke identifikuar tendencat dhe faktorët e zhvillimit që do të kenë një ndikim kyç në zhvillimin e komunës në 8+ vitet në vijim;

• Të identifikojë perspektivat e zhvillimit të komunës në një vizion, parime dhe prioritet strategjike për komunën e Shtërpcës.

• Të bëjë shtrirjen hapsinore të zhvillimeve në kornizen e zhvillimit hapësinor

Një kërkesë ligjore për Planin Zhvillimor Komunal është vlerësimi i ndikimeve potenciale nga zbatimi i këtij Plani në mjedis. Ky Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM) ka për qëllim t'i sigurojë komunës së Shtërpcës një seri rregullash dhe kriteresh mjedisore te nevojshme për t'u zbatuar, të përmbledhura këto në një raport VSM-je që do të kalojë nga konsultimi publik, dhe më tej nga miratimi përfundimtar eventual nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA).

1.1. Nevoja për Vlerësim Strategjik Mjedisor

Komuna e Shtërpcës ka përvoja të më hershme në procesin e hartimit të VSM-së nga PZHK e kaluar, pothuajse nuk ka asnjë zhvillim me origjinë njerëzore që mos të shkaktojë ndikim mjedisor, në shkallë të ndryshme. Kjo është arsyeja se pse tashmë i është dhënë gjithmonë e më shumë rëndësi aspekteve mjedisore të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në

tërësi të investimeve të propozuara. Bazuar në parimin mjedisor të "parandalimit" sipas të cilit çdo ndërhyrje e planifikuar duhet të provojë paraprakisht që nuk do të ketë pasoja negative në mjedis, të gjitha vendet me legjislacion mjedisor bashkekohor kryejnë atë që quhet Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) për çdo ndërhyrje apo investim konkret.

Po ashtu, edhe politikat, planet, dhe programet mund të kenë ndikime mjedisore. Nëse nuk hartohen mbi baza të shëndosha parimore edhe mjedisore, planet apo strategjitë mund të përfundojnë duke shkaktuar dëme mjedisore afatgjata dhe të llojit strategjik. Për këtë specifikë, ato i nënshtrohen një procedure të veçantë dhe të ndryshme nga VNM-ja, siç është Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM).

Procesi i VSM-se eshte nje detyrim ligjor për politikat, planet apo programet. VSM është një instrument i rëndësishëm për të integruar konsiderata mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e planeve dhe të programeve të caktuara, të cilat kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin. Vlerësimi Strategjik Mjedisor është procesi dhe sistemi i përfshirjes së konsideratave mjedisore brenda politikave, planeve, programeve, apo strategjive.

1.2. Projekt-Raporti Përfundimtar

Ky Raport përfundimtar është rezultati kryesor raportues i procesit të VSM-së. Mbas shqyrtimeve dhe komenteve të komunës së Shtërpcës, si edhe seancave të dëgjesave me pubikun, do shihen pyetjet, komentet apo sugjerimet qe dalin gjate procesit, do u jepet pergjigje dhe do integrohen nese gjykohen të drejta, dhe ne fund do të prodhohet Raporti Përfundimtar për miratim nga Komuna e Shtërpcës dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

Ky kapitull i parë jep sfondin dhe të dhënat historike, si dhe shpjegon nevojën për një VSM, duke detajuar edhe objektivat e VSM-së. Kapitulli i dytë mbulon paraqitjen e kuadrit ligjor dhe institucional mbi të cilin bazohet procesi i zhvillimit të raportit të VSM-së. Kapitulli i tretë trajton procesin dhe metodologjine e VSM si edhe jep burimet e shkruara apo takimet e kryera ku autoret jane bazuar ne kuader te pergatitjes se projekt-raportit perfundimtar te VSM-se.

Kapitulli i katert bën një përmbledhje të qëllimit dhe komponentëve të Planit Zhvillimor Komunal të Shtërpcës (PZHK-së) dhe të mënyrës së integrimit të tij me planet e tjera, duke vënë theksin tek aspektet mjedisore. Shpjegohet nevoja për planin, objektivat dhe shtrirja e tij, përpunimi dhe zbatimi i PZhK-së, shkalla në të cilën PZHK-ja ndikon në planet e tjera.

Në kapitullin e pestë jepet një shqyrtim i gjendjes mjedisore ekzistuese në komunën e Shtërpcës perfshi paraqitjen e problematikave kryesore në cilesine mjedisore te ujit, ajrit, biodiversitetit dhe tokes, nivelit te zhurmave dhe shendetit publik.
Kapitulli i gjashtë përmban analizën mjedisore të alternativave, e cila ballafaqon alternativën "0" (mos bëj asgjë), duke e ballafaquar me alternativen e zhvillimit sipas modelit te zgjerimit të planit të qendres, dhe me alternativën sipas PZhK-së.

Në kapitullin e shtatë jepen parimet kryesore mjedisore dhe shqyrtohen objektivat strategjike të zhvillimit urban. Jepen disa veprime konkrete qe mund te realizohen nembeshtetje te objektivave strategjike. Gjithashtu paraqiten ne menyre te detajuar edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal, kritere të ndara në katër kategori bazë.

Kapitulli i tetë paraqet ndikimet e mundshme mjedisore nga PZhK-së si edhe masat zbutëse të propozuara. Vleresohen ndikimet si pozitive dhe negative nga alterantivat e zhvillimeve te PZHK-së, me objektiv qe të permiresohet cilësia e jetes se banorëve të

Shtërpcës qe banoje aktualisht dhe qe do te akomodohen ne te ardhmen. Ne pergjithesi masat zbutese do te synojne qe te permiresojne gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore jane te cenuara dhe te sigurojne qe zhvillimet ne zonat e tjera dhe ato qe do te integrohen rishtazi ne Planin Zhvillimor të behen ne perputhje me standardet mjedisore.

Kapitulli i nëntë trajton aspektet e monitorimit afatgjate për verifikimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Do të monitorohen treguesit e objektivave të mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

Raporti paraqet përfundimet me një përmbledhje të shkurter dhe sugjeron disa prej veprimeve kryesore mjedisore që duhen ndërmarrë dhe pasur parasysh gjatë zbatimit te PZhK-së dhe detajimit te punes gjate hartimit te Planeve zhvillimore urbane dhe rregulluese.

2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Direktiva VSM e BE-së

Direktiva e BE-së2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis u aprovua më 27.06.2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Kjo direktive nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlamenti Evropian…,2001) thotë që planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legjislative, rregulluese ose administrative.

Një VSM është i obligueshëm për planet/programet si vijon:

- Përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ ujit, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & vendit ose shfrytëzim të tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM);
- Janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve´. Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejnë një procedure të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse ka në efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

Procedura VSM mund të përmblidhet si vijon: raporti VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa te arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh para aprovimit. Kur të aprovohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet paparashikueshme të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

Direktivat tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke u shqyrtuar çështjet mjedisore. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve (dhe të programeve) poashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme´.

Strategjia 2020 e BE-së

Për veç dokumenteve të sipërpërmendura legjislative të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha[1] është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor meqë bashkëpunimi rajonal me këtë rajon është identifikuar si njëri prej prioriteteve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetet e strategjisë janë "zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës". Janë shtatë nisma të mëdha, prej të cilave *Evropa efikase sa ju përket burimeve* dhe *Një politikë industriale për epokën e globalizimit* janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të qëndrueshmërisë, por nisma te tjera si *Agjenda digjitale për Evropën, Unioni i përtëritjeve, Rinianë lëvizje, Një agjendë për shkathtësi dhe vende të reja pune* dhe *Platforma evropiane kundër varfërisë* do të mundeshin poashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji poashtu përfshihen objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme si për shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t'i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave të serrave, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjërat e ripërtëritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB dhe Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ)

Kombet e Bashkuara-KB kanë një rol aktiv në zhvillimin shteteve të ndryshme në botë . Edhe pse Kosova nuk është anëtare e kombeve të bashkuara, KB-ja aktualisht vepron në Kosovë nën mandatin e misionit UNMIK, në mënyrë që t'i sigurojë kushtet për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mblodhën në NjuJork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo ishte bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit[2]. Të cilat ishin 8 objektiva ndërsa, një prej objektivave i kushtohej qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosje e qëllimeve në vijim:

- Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe kthim i mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;
- Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme tek uji i sigurt i pijshëm dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;

[1] http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

[2] http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

- Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetëte sëpaku100 banorëve të lagjeve të varfra.

Edhe pse në këto 15 vitet e fundit u bë një progres i dukshëm në arritjen e OZHM-ve, shumë objektiva nuk u arritën. Për të përshpejtuar progresin dhe avancuar zhvillimin përtej vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 25 shtator 2015 miratoi axhendën e zhvillimit të post 2015, duke vendosur objektivat dhe pikësynimet e reja për 15 vitet e ardhshme. Axhenda e re përcakton shtatëmbëdhjetë Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) ose Sustainable Development Goals (SDG), të cilat kanë si afat vitin 2030 dhe kërkojnë të ndërtojnë e plotësojnë atë që OZHM nuk e arritën. Në këtë axhendë të re të zhvillimit, mjedisi konsiderohet të kenë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa qështjet mjedisore kanë lidhje me disa probleme kryesore globale dhe kanë ndikim në të gjitha aktivitetet njerëzore dhe në cilësinë e jetës së njeriut. Kjo është arsyeja pse mjedisit i janë dhënë objektiva të posatshme (OZHQ nr. 11, 13 dhe 15) por edhe objektiva tjera substancialisht përmbajn çshtjet mjedisore. Këto objektiva janë të rëndësishme që të kenë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin dhe adresimin e problemeve globale të mjedisit.

Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit

Konventa Århus

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Konventa Århus vendosë një numër të të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNECE mbi Qasjen…,1998) ´Nga palët në këtë Konventë kërkohet t'i hartojnë dispozitat e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Konventa parashikon:

- Të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaj i pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat i posedojnë;
- Të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet t'i bëjnë përgatitjet që t'ia mundësojnë opinion të influencuar dhe organizatave joqeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim;
- të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisore në përgjithësi.´

Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi.....Mjedisor,1991) përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit´. Poashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projektet e mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm të pa favorshëm në mjedis përtej kufijve´. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997.

Siç thekson Marsden (2008), Protokolli i Kievit është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, me që do të mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008). Protokolli është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse në Konventën Espoo, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësimi strategjik i mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (VNP) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Protokolli poashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit. Protokolli kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transport, zhvillim rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzim të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Sugjerimet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përfshirja e aktorëve po ashtu janë në përputhje me protokollin.

Historiku legjislativ, organet administrative përgjegjëse

Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor

Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjinr. 03/L-106), ndërkaq në korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L-174) duke pasur si qëllim kryesor:
Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;
Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;
Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet.
Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.
Sipas Ligji Nr. 04/L-174 në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (Qendror dhe lokal) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Harta Zonale e Komunës, dhe Planet Rregulluese Urbane të Hollësishme. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrje të opinionit. HZK si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton kushtet zhvillimore dhe masat për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet ta përfshijë periudhën prej së paku 4 vjetëve dhe ta përfshijë një Plan për zhvillimin e hapësirave urbane dhe fshatrave brenda komunës. Te gjitha nivelet e Planeve duhet te përfshijnë zhvillimin e qendrueshëm si dhe për secilin Plan obligohet përgaditja e raportit të VSM paralelisht me Planin.
Sipas Ligji Nr. 04/L-174 Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikat për zhvillim hapësinor në fushën e planifikimin hapësinor, si dhe për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin e Kosovës. Ndërsa autoritetet lokale janë përgjegjës për zbatimin zhvillimet urbane të nivelit lokal të cilat duhet të jenë në harmonime politikat dhe programet nacionale si dhe duke rrespektuar përgjegjësitë qe dalin nga Ligji Nr. 04/L-174.

Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit

Ky ligj nënvizon rëndësinë e integrimit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes, aprovimit dhe realizimit të planeve dhe të programeve përkatëse nëse është e qartë që këto të fundit kanë ndikime domethënëse në mjedis. Lista e planeve dhe e programeve të obligueshme është e përcaktuar në kuadër të ligjit. Ato plane nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin VSM. Nëse mendohet që VSM nuk nevojitet vendimi përkatës duhet të jetë në formë të shkruar dhe duhet t'i përfshijë arsyet tij. Raport i NMV identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikime te mundshme të rëndësishme në mjedis nga zbatimi i planit ose programit dhe vlerëson alternativat e arsyeshme. Kërkesat përcaktohen në ligj në mënyrë që t'i u ofrojnë qasje në dokumentet VSM organeve këshilluese dhe opinionit të përgjithshëm. Projekti i dokumenteve VSM është një objekt për diskutim publik. Në kuadër të ligjit përcaktohet kërkesa te posaçme për rastet e këshillimeve ndërkufitare. Para se të aprovohet raporti

VSM, ministria duhet ta shqyrtojë atë dhe të pajtohet me të. Poashtu janë përcaktuar procedurat për informimin lidhur me aprovimin e vendimeve, për monitorimin dhe mbikëqyrjen. Shtojcat e ligjit përmbajnë kritere të caktuara për përcaktimin e rëndësisë së mundshme të ndikimeve në mjedis dhe informatat e nevojshme që duhet të ofrohen në raportet VSM si edhe kriteret për vlerësimin e raporteve VSM.

Planet dhe programet e tjera të rëndësishme

Përveç legjislacionit raporti i VSM-së duhet te merr parasysh edhe Planin Hapësinorë të Kosovës 2010-2020+, Strategjinë për mjedisin dhe Planin e veprimit në Mjedis, si dhe disa plane, programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera relevante për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

3. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së

3.1. Metodologjia

Kryerja e VSM per programe, plane zhvillimore dhe projekte të mëdha është detyrim ligjor.

Qëllimi i raportit të VSM-së pë Planin Zhvillimor Komunal të Shtërpcës është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikepamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme nga zhvillimi i Planit Zhvillimor Komunal të propozuar.

Metodolgjia e ndjekur eshte ne perputhje me Direktiven e BE: 2001/42/EC „Mbi Vleresimin e Efekteve te disa Planeve dhe Programeve ne Mjedis" dhe ligjin për VSM, i cili eshte transpozimi i direktives së BE.

Mbeshtetur në sa mesiper VSM do të përfshijë pikat e mëposhtme:

a) një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor;

b) përshkrim të Vizionit,priritet dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal dhe marrëdhëniet e tij me politikat, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;

c) përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritur të tij në rast se nuk zbatohet plani ;

d) përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;

e) përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin;

f) përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;

g) përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.;

h) Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit.

i) një përmbledhje për përzgjedhjen e alernativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësite e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.

j) përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.

Plani Zhvillimor Komunal per numurin e madh dhe diversitetin e gjere te problematikes qe trajton, kerkon konsultimin e nje game te konsiderushme dokumentacioni. Behet fjale per plane, raporte, projekte, studime dhe literature teknike nga sektore te ndryshem ekonomik dhe social. Ky dokumentacion pervec materialeve qe dispononte vete Grup hartues i VSM-s, u sigurua nga komuna e Shtërpcës, institucione te tjera publike dhe kerkimet ne internet. Me poshte po rendisim disa nga dokumetat kryesore qe u perdoren ne trajtimin e aspekteve te ndryshme mjedisore për komunën e Shtërpcës dhe me gjere.

3.2. Literatura dhe Burime te Shkruara Informimi për VSM

Materiali që përben Detyren e Projektimit, sqaruar në dokument si Plani Zhvillimor Komunal i hartuar nga grupet punuese, trajton ne menyre serioze problemet mjediore te komunës së Shtërpcës.

Ky dokument nder te tjera permban informacion lidhur me shtrirjen gjeografike, gjeologjine, sizmiken, hidrologjine, hidrografine, mbetjet e natyrave te ndryshme, cilesine e ajrit, ndotjen e burimeve ujore, ekonomine, infrastrukturen, transportin, urbanistiken, informacion mbi sektoret socio-ekonomik. Ne pergjithesi materiali eshte i kompletuar, në veçanti në trajtimin e problemeve mjedisore me te cilat perballet komuna. Ai permban të dhena analitike mbi mjedisin fizik, mbetjet, cilesine e ajrit dhe te ujrave siperfaqesore, Zonat e mbrojtura Parkun Nacional Mali Sharr, Biodiversitetin, etj.
Plani Hapësinor i Parkut Nacional "Mali Sharr"
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin 2011 – 2020
Vlerat natyrore të Parkut Nacional "Mali Sharr".
Gjendja e Resurseve Natyrore në Parkun Nacional për vitin 2008.

Plani hapësinor i Kosovës dhe Plani i Kosovës për Veprim në mjedis kanë percaktuar vizionin per mjedisin i cili perkufizohet si: zhvillimi i qendrueshem i vendit duke mbrojtur pasurite natyrore nga ndotja dhe demtimi dhe promovimi i vlerave mjedisore.

Per realizimin e këtyre prespektivave, investimet per mbrojtien e mjedisit me qellim qe standardet e Bashkimit Europian te mund te arrihen brenda vjeteve te ardhshem do te fokusohen ne fushat e meposhtme:

- Trajtimi i ujrave te ndotura;
- Trajtimi i cilësisë së ajrit
- Mbrojtja e Biodiversitetit (Larmanisë të llojeve organike)
- Menaxhimi i mbetjeve te ngurta dhe ndertimi i vend-depozitimeve sipas standardeve te BE;
- Mbyllja ne zonat e ndryshme e vend-depozitimeve ekzistuese;
- Rehabilitimi i tokave te ndotura dhe burimeve te ndotjes;
- Permiresime teknollogjike ne objektet industriale

Drejtimet e mesiperme per rehabilitimin dhe mbrojtjen e mjedisit, jane probleme prioritare per komunën e Novebërdës.

Plani Zhvillimor Komunl i Shtërpcës paraqet nje plan të hapësirës së Shtërpcës dhe propozon zhvillime të perdorimit tokës e të infrastrukturës deri në vitin 2022+. Ai nënvizon gjithashtu edhe nevojën për të adresuar boshllëqet financiare, njerëzore e të burimeve institucionale për një ekzekutim efektiv të planit.

Mbi bazen e programit te Qeverise për mbrojtjen e mjedisit, ajo percakton edhe qellimet të cilat në mënyre të përmbledhur jane:

• Përmbushja e standarteve të kërkuara (BE, Organizata Boterore e Shendetesise - OBSH) për cilësinë e ajrit, ujit (furnizim dhe trajtim), zhurmat, mbetjet urbane, zonat e mbrojtura etj, me qëllim përmiresimin e cilësisë së jetës;
• Ulja e nivelit të çlirimit të gazeve të efektit serrë dhe substancave ozon-holluese, me qëllim që të kontribuohet për parandalimin e ndryshimit të klimës;
• Mbrojtja dhe mirëmbajtja e të gjitha burimeve të ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë për përdorim aktual dhe në të ardhmen;
• Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës, me qëllim që të shtohet në maksimum pjelloria, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja;

• Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe specieve të mbrojtura, me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit tonë në përputhje me angazhimet tona europiane dhe ndërkombëtare;
• Një sistem i integruar dhe efikas i planifikimit hapësinor dhe i zhvillimit, i cili merr në konsideratë në mënyrë të ekuilibruar objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore, dhe;
• Riparimin dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme të zonave që kanë pësuar dëme të mëdha mjedisore, me qëllim që të eliminohen kërcënimet ndaj shëndetit publik dhe biodiversitetit, si rezultat i këtyre dëmtimeve.

Pothuajse te gjitha keto probleme mjedisore per te cilat Plani ka percaktuar synimet, jane probleme me te cilat ndeshet edhe komuna e Shtërpcës. Zbutja dhe zgjidhja e tyre perben nje kontribut madhor ne realizmin e këtij Plani.

Per një vleresim sa me real te situates mjedisore në komunën e Shtërpcës dhe luhatjen e saj ne vite, krahas te dhenave per problematiken mjedisore të Komunës të nxjerra nga Detyra e Projektimit (Plani Zhvillimor Komunal), informacione më të gjëra dhe sistematike të ndotjes së ajrit, ujit në lumenjte e komunës së Shtërpcës, zhurmave, manaxhimit te mbetjeve, etj, u gjeten ne Raportet Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenta tjera të nivelit qendrorë, pergatitur institucionet e ndryshme të Republikës së Kosovës.

3.3. Takime dhe Biseda me Perfaqsues te Institucioneve

Autoret e raportit të VSM kane pasur fatin te jene perfshire ne shume takime dhe mbledhje me perfaqsues me institucione te ndryshme ne kuader te hartimit te PZHK-së. Disa nga hartuesit kane qene edhe anetarë të Grupeve punuese që u ngritën për të kryer punen e hartimit te PZHK-së.

Grupet punuese me perfaqsues te insitucioneve profesionale të qeverisjes komunale dhe qendrore, si edhe botes akademike dhe eksperte te pavarur kan zhvilluar nje dyzine mbledhjesh per te percaktuar ecurine e PZHK-së qysh nga fillimi deri tek debatet mbi zgjidhjet hapësinore apo infrastrukturore. Shenimet e ketyre mbledhjeve jane bere pjese e shqyrtimit nga autoret ne kuader te pergatitjes se raportit te VSM.

Ne menyre te ngjashme, Grupet punuese me perfaqsues te institucioneve te qeverisjes komunale dhe qendrore, mepërfaqsues edhe të shoqëris civile dhe sektorit privat gjatë disa takimevekanë debatuar per vizionin e zhvillimit te komunës ne nivel me te gjere. Edhe shenimet e ketyre takimeve jane shqyrtuar nga autoret e raportit te VSM.

Nga proces-verbalet e mbledhjeve dhe takimet me antare te Grupeve punuese të komunës së Shtërpcës, si edhe me Drejtorinë e Planifikimit Urban prane kesaj komune, jane marrë informacione dhe te dhena te ndryshme qe lidhen me shtrirjen e komunës (gjeografia), projeksione te popullsise ne zona te ndryshme të komunës, zonimin e ndërtimeve, peizazhin, zonat e mbrojtura në Parkun Nacional "Mali Sharr", infrastrukturen rrugore, zonat rekeative, zonat e ndotura, menaxhimin e mbetjeve, infrastruktura e ujit te pijshem, ujrave te zeza dhe te bardha, zonat e parkimit. Keto informacione dhe takime kane ndihmuar grupin e hartimit te VSM-s, te fokusohet me mire ne zona ekzistuese të Komunës dhe siperfaqe qe mendohet ti shtohen, ku parashikohen zhvillime te caktuara.

Gjithashtu takime jane realizuar me perfaqsues te Ministrise se Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor lidhur problematiken mjedisore në komunën e Shtërpcës, zonat e ndotura mjedisore (hot spote) dhe zonat me rendesi ekologjike. Keto takime kane ndihmuar autoret veçanerisht ne hartimin e kritereve kufizuese mjedisore.

3.4. Struktura e Raportit të VSM-së

Kapitujt e mesiperm paraqiten sfondin, të dhënat historike, nevojën për VSM, perfshi kuadrin ligjor dhe institucional mbi të cilin bazohet procesi i zhvillimit të raportit të VSM-së. U paraqit gjithashtu procesi dhe metodologjia për VSM si edhe burimet e shkruara apo takimet e kryera ku autoret jane bazuar ne kuader te pergatitjes se projekt-raportit perfundimtar te VSM-se.

Kapitulli i katert paraqet nevojen dhe objektivat e PZHK-së, si edhe marrdheniet e tij me planet dhe programet qe kane lidhje me të. Paraqitet një përmbledhje të qëllimit dhe komponentëve të PZHK-së dhe të mënyrës së integrimit të tij me planet e tjera të qytetit, duke vënë theksin tek aspektet mjedisore.

Situata mjedisore në komunën e Shtërpcës paraqitet në kapitullin e peste. Ketu pasqyrohet situata mjedisore, perfshire infrastrukturen dhe aspekte socio-ekonomike, në komunën e Shtërpcës dhe rreth e saj.

Mbeshtetur ne publikimet mbi gjendjen e mjedisit në komunën e Shtërpcës do te analizohen treguesit e cilesise se mjedisit; fizik dhe biologjik (gjeologjia, hidrologjia, sizmika, perdorimi i tokes, biodiversiteti, cilesia e ajrit, e ujrave siperfaqesore, ndotja e tokes, pikat e nxehta mjedisore, niveli i zhurmave, menaxhimi i mbetjeve ne pergjithesi dhe atyre urbane ne vecanti, siperfaqet e gjelbra, etj). Mbi bazen e kesaj analize do te vleresohet situata mjedisore aktuale dhe do te identifikohen zonat me problematike te qytetit si ne aspektin e ndotjes ashtu dhe vlerave rekreative.

Kapitulli i gjashtë përmban analizën mjedisore të alternativave, e cila ballafaqon alternativën "zero" (mos bej asgje), duke e ballafaquar me sipas PZHK-së. Ne kete kapitull evidentohen perparesite e zhvillimit te planifikuar ne drejtim te krijimit të njëkomune me më teper infrastruktur dhe me pake zhurme e pluhur, me me shume hapesira te gjelbra dhe me te paster, e njekomune qe rritet dhe zhvillohet me nje cilesi jete me te mire qe orjentohet nga parimet e zhvillimit te qendrueshem.

Ne kapitullin e shtatë jepen parimet kryesore mjedisore dhe shqyrtohen objektivat strategjike të zhvillimit komunal. Në të jepen në mënyrë të detajuar edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal, kritere të ndara në katër kategori të rëndësishme.
Vendosja e objektivave per mbrojtjen e mjedisit eshte kerkese e Direktives se 2001/42/EC te BE që është shprehur gjithashtu në ligjin e VSM. Objektivat që synohet të arrihen, përcaktohen mbi bazen e situatës mjedisore të komunës së Shtërpcës, problemeve mjedisore të identifikuara dhe kërkesave që synon të realizojë PZHK.

Gjithashtu ne kete kapitull do te prezantohen dhe kriteret mjedisore qe kufizojne ne nje apo disa drejtime te zhvillimit zona te vecanta, me qellim respektimin e standardeve shendetesore e mjedisore si dhe ruajtjen e trashegimise.

Kapitulli i tetë paraqet ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat zbutëse të propozuara. Mbi bazen e informacionit mbi situaten aktuale mjedisore, ndikimet eventuale te PZHK-së ne shendetin e njeriut dhe elementet e mjedisit dhe ne perputhje me kerkesat e legjislacionit per mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin komunal, në të propozohen masa per zbutjen e çdo ndikimi negativ ne cilesine e mjedisit nga zbatimi i PZHK-së.

Do te vleresohen ndikimet si pozitive dhe negative nga alterantivat e zhvillimeve të PZHK-së, me objektiv qe te permiresohet cilesia e jetes se qytetarëve të komunës qe banoje aktualisht dhe qe do te akomodohen ne te ardhmen. Mbi bazen e vleresimit analitik te cilesise se elementeve te mjedisit si ajrit, ujrave siperfaqesore, dhe netokesore, mbetjeve te ngurta, zhurmave, siperfaqeve te gjelbra, ne zonat e ndryshme te komunës, do të behen propozime për masa zbutese të pergjitheshme dhe specifike, sipas karakteristikave dhe

mundesive qe lejohen per nderhyrje per tu konsideruar nga ekipi i hartimit te PZhK-së. Ne pergjithesi masat zbutese dhe kufizuese/ndaluese do te synojne qe te permiresojne gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore jane të cenuara dhe të sigurojne që zhvillimet komunale ne zonat e tjera dhe ato qe do te integrohen rishtazi ne Planin Zhvillimotte behen ne perputhje me standardet mjedisore.

Kapitulli i nëntë trajton aspektet e monitorimit afatgjate për verifikimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Do të monitorohen treguesit e objektivave të mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për cdo element mjedisor.

Qellimi i monitorimit te PZHK-së, eshte identifikimi në kohe i efekteve të padëshiruara që mund të shfaqen në fazat e hershme të zbatimit të PZHK-së, për të mundësuar masat e nevojshme për parandalim apo zbutjen të këtyre efekteve. Për këtë qëllim është hartuar një program monitorimi i cili do të ndjekë të gjitha zhvllimet ne kuadrin e zbatimit të Planit.

Raporti përfundon me një përmbledhje të shkurter dhe disa sugjerime per veprime kryesore mjedisore që duhen ndërmarrë dhe pasur parasysh gjatë zbatimit te PZHK-së.

4. PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL (informatat e rëndsishme për VSM)

4.1. Nevoja për Plan Zhvillimor Komunal

Komuna e Shtërpcës poashtu ka një përvojë të mirë në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal duke qenë se ishte e përfshir vetë me ekspertët komunal në hartimin dy dokumenteve kryesore të planifikimit lokal siç ishin PZHK dhe PZHU, si komounë e kishte më të leht edhe identifikimin e problemeve mjedisore. Territori i komunës së Shtërpcës (lugina e Sirinikut) më sipërfaqe është i vogël, por natyra e tij komplekse karakterizohet me llojllojshmëri dhe kompleksitet. Prandaj, kjo pronë është transferuar edhe në kushtet natyrore të përfshira në këto komplekse, që mund të përcaktohen më një term unik **potenciali natyror**. Bazuar në analizën e pjesshme të elementeve individuale të kompleksit natyror do të theksojmë pasuritë e tyre të rëndësishme dhe vlerën e aplikimit.

Komuna e Shtërpcës ka përjetuar një proces më të ngadalshë të urbanizimit. Pas luftës në Kosovë rajoni por edhe komuna e e Shtërpcës ka përjetuar migrimin të një pjese të popullatës nga zonat rurale dhe ato të thella malore drejt zonave periurbane dhe të vendbanimeve të mëdha të komunës. Komuna ka pasë ramje në numrin e banorëve. Kuptohet që kjo komunë ka pasë shtrirje në disa vendbanime të mëdha por gjithashtu dhe një intensifikim të pjesës së konsoliduar të vendbanimeve për shkak të pamundësisë së shtrirjes së infrastrukturës në këto zona.
Në vitet e para të pas luftës mungesa e PZHK-së është justifikuar me:

(I) Mungesene kornizës ligjore
(II) Mungesën e kapaciteteve njerëzore dhe financiare
(III) Paqartësinë profesionale për natyrën e politikës për t‟u përballur me këtë fenomen, dhe
(IV) Pa-aftësinë për ta kthyer çështjen e Planifikimit Zhvillimor Komunal dhe Urban në një prioritet për qeverin komunale. Ndërsa viteve të fundit, dukshëm, çështja e planifikimit dhe zhvillimit komunal dhe urban ndërtoi interesa që u konsoliduan në sektorin e ndërtimit me ndikim të dukshëm në ekonomi, por që nuk ishin vazhdimisht në balancë me interesin publik. Kjo situatë justifikoi gjithmonë ndërhyrje të pjesshme në indin ndërtimor të vendëbanimeve pa u kujdesur për një vizon të përgjithshëm të zhvillimit të qëndrueshëm komunal në të gjithë vendbanimet e Shtërpcës.


Kjo gjë ka rezultuar me një përdorim të paefektshëm të tokës, që është i kushtueshëm për shërbimet dhe kërkojn mobilitet të lartë. Në një pjesë të Shtërpcës ngjeshja kaotike e vendbanimeve ushtron presion në shërbimet ekzistuese, shkakton kërcnim për trashëgiminë dhe zvogëlon zonat e gjelbërta dhe të qarkullimit. Në tërësi, në vendëbanimet ka ndodhur një degradim serioz mjedisor.

Në këtë mënyrë, Komuna e Shtërpcës vendosi të përgatisë dhe miratojë një Planin Zhvillimor Komunal që do t‟i përgjigjej më mirë situatës aktuale të përdorimit të tokës dhe do të akomodonte nevojat e komunës për planifikim dhe zhvillim por edhe do të plotsonte një aspekt legal që obligon komunat të përgatisin Plane Zhvillimore Komunale.

Pozita gjeografike karakteristikat natyrore

Komuna e Shtërpcës shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës me rreth 72 km në jug të Prishtinës. Kufizohet me komunën e Prizrenit, Therandës, Ferizajt, Kaçanikut dhe me Maqedoninë (harta nr. 1). Në territorin prej 247,36 km2 shtrihen 16 vendbanime në të dyja anët e Lepencit, në lartësi mbidetare prej 600 deri 1.200 metra.

Kosova, e bashkë me të edhe komuna e Shtërpcës zënë pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik, shtrihet në udhëkryqin e rrugëve Lindje – Perëndim mbi detin e Zi dhe Adriatik, dhe në drejtimin Lindje – Jug mbi Evropën qendrore dhe detin Egje.



Harta 1. Pozita gjeografike e komunës së Shtërpcës në hartën e Republikës së Kosovës

UJI

Ujërat e luginës së Sirinikut paraqitet në tri mënyra: ujërat nëntokësore, rrjedhat e ujit dhe liqenet.

Ujërat nëntokësor

Ujërat nëntokësor kryesisht paraqiten në formë të ujëmbajtësit freatik dhe të thyer, deri sa paraqitja e ujërave nëntokësor krasik është më pak e pranishme, falë rezervave të

shumta të ujrave nëntokësor ata janë në mundësi të ushqejnë një numër të madh të burimeve. Më të shpeshta janë burimet e dobëta që japin prej 0,1 - 1 l/sek, dhe ka mjaft prej atyre qe japin 1 - 5 l/sek. Me të pasura më ujë janë burimet karsike (dy burime nën Lubotenin, luginën e Heshtur, Gurin e zi I dhe II etj,) që kanë rëndësi të madhe për menaxhimin e ujit.

Paraqitja e ujarëve nëntokësor dhe liqeneve është shkaktuar nga kushtet e veçanta. Terreni i komunës së Shtërpcës janë të ndërtuar nga rreshpe të gjelbra, filita, kretakut të zi të flishit, gurit gëlqeror dhe dolomitit, serpentinit, formacioneve diabazë, rërës, zhavorrit dhe argjilës. Vet zona karakterizohet me shkëmbinj ujëmbajtës ku ekziston thyerja të burimit me shkëmbim që nuk e përshkojnë ujin përmbi të cilët uji kalon. Ky burim ushqen burime të shumta që paraqiten në majat e shumta të kreshtës nga të cilat formohet rrjeti hidrografik i zhvilluar. Burimet kanë kapacitet të ulët prej 0,10 l/sek deri disa l/sek. Temperatura e ujit varion nga 3-10º C. Burimet janë kryesisht të pambuluar dhe gjenden në lartësi të mëdha dhe hapësirën e tërë.

Prandaj ne mendojmë se duhet mbrojtur së pari ato komplekse të vegjetacionit në të cilat rolin edifaktorial luajnë pikërisht rrobulli dhe molika. Në anën tjetër, duke mbrojtur pyjet e rrobullit dhe molikës mbrojmë një gamë të tërë të llojeve interesante dhe të rëndësishme të bimëve dhe fushave dhe jo vetëm rrobullin dhe molikën (sigurisht, një numër të tërë të specieve të shtazëve). Përveç rrobullit dhe molikës, me ligj janë të mbrojtura edhe specie të shumtë të bimëve ndër të cilat me rëndësi të venat në kuadër të komunës së Shtërpcës janë:

- Gentiana lutea (lincura)
- Pinus mughus (pisha krivelj)
- Të gjitha speciet e lisave

Bota shtazore e luginës së Sirinikut dhe anëve të saj periferike dhe majave, karakterizohet me numër të madh të llojeve dhe numër të vogël të ekzemplarëve të specieve të caktuara. Në këtë rajon ekzistojnë kushte të favorshme natyrore për jetën e specieve të shumta të kafshëve, por është gjithnjë ndikimi më i madh i njerëzve, me kohë, shumë negativisht ka ndikuar në zvogëlimin e popullatës së specieve të caktuara. Sipas rezultateve të hulumtimeve të deritanishme në zonën e maleve të Sharrit jetojnë dreri, dhia e egër, derri i egër, ariu, kaprolli, rrëqebulli, pastaj ujku, macja e egër, dhelpra, kunadhja gushëbardhë, kunadhja e artë, lepuri, ketri, baldosa, vidra, gjer etj. Ornitofauma e maleve të Sharrit, është gjithashtu mjaft e pasur. Në këto zona jeton gjeli i egër, sorra galica, parosi i dëborës, lauresha e brigjeve, pipiti i ujit, trishtili i zi, krahdylli, mëllënja qafore, qukapiku i zi, shqiponja e artë (e maleve), huta, skifter i drurëve dhe shumë specie tjera. Ndërsa prej specieve të kafshëve rëndësi të veçantë kanë të gjitha kafshët që janë në numër të vogël si rrëqebulli (në pyjet rreth Shtërpcës dhe Prevallës), dreri malor (nga Piribregu), gjeli i egër (në Orman dhe livadhet e Cerevi), ariu etj

Shumica e specieve të kafshëve janë me ligj të mbrojtura qoftë në tërësi (ndalimi i vrasjeve dhe kapja), qoftë pjesërisht (me leje periodike për gjuetinë e numrit të caktuar të specieve të veçanta të kafshëve). Duke pasur parasysh botën shtazore për mbajtjen ekuilibrit ekologjikë në kuadër të luginës së Sirinukut dhe rrëzë maleve të tij në periudhën e planifikuar të gjitha speciet e mbrojtura do të kontrollohen nga organizatat përgjegjëse (shoqata e gjuetarëve) dhe individët. Për më tepër, duke pasur parasysh rëndësinë e specieve të kafshëve, e posaçërisht të atyre të rralla për rritjen e vlerës së përgjithshme turistike të luginës së Sirinikut dhe maleve të Sharrit, Oshlakut, Koxhës Ballkanit në njëzet vitet e ardhshme në mënyrë të planifikuar dhe do të rritet numri i specieve të veçanta. Aktivitetet për të rritur numrin e popullsinë e specieve të veçanta të kafshëve janë të nevojshme sepse në zonat e maleve të Sharrit deri vonë, për shembull, nuk ka pas më shumë së 135 drerë, 467dhi të egra, 32 arinj, 10 rrëqebull, 119 derre të egra. Nëse dihet që komuna e Shtërpcës gjenden në më pak së një të katërtën e shpateve veriore dhe degëve të maleve të Sharrit në kuadër të Kosovës, është e qartë se në këto rajon është një numër shumë i vogël (i rrallë) i specieve të vlefshme. Me mbrojtjen e planifikuar dhe mbarështimin e llojeve të caktuara do të ndërpritet procesi i zhdukjes së pakthyeshme të specieve të caktuara siç është ka ndodhur së voni me drerin e egër për të cilin B.S. Naumov (1965) thotë së "ekzistojnë indikacione që në territorin e Kosovës dhe dreri i egër është autokton".

Mbrojtja e florës dhe e faunës do të realizohet në mënyrë të planifikuar në bazë të programeve konkrete të mbrojtjes dhe mbarështimit të specieve të caktuara, të prodhuara

nga institucionet e specializuara shkencore dhe profesionale. Realizimi dhe përcjellja (kontrolli) e realizimit të këtyre programeve do të jetë nën kompetencat e institucioneve përgjegjëse të republikës si dhe kompanisë publike "Parku Nacional – Malet e Sharrit" me seli në Shtërpcë.

Plani i mbrojtës së mjedisit në këtë plan hapësinor është projektuar në bazë të studimeve të mëposhtme kërkimore dhe programeve:


- Justifikimi i shpalljes së pjesës së Maleve të Sharrit në Kosovë si Park Kombëtar, Instituti Rajonal për Mbrojtjen e Natyrës, Prishtinë,1982.
- Komuna e Shtërpcës – lugina e Sirinikut karakteristika e mjedisit, Botim i veçantë, libri 37 / dhe Instituti Gjeografik ,,Jovan Cvijić,, SANU, Beograd, viti 1990.
- Komuna e Shtërpcës – lugina e Sirinikut, Zhvillimi socio – ekonomik, organizimi dhe shfrytëzimi i hapësirës, Botim i vecantë, libri 37 / dhe Instituti Gjeografik ,,Jovan Cvijić,, SANU, Beograd, viti 1991.
- Programi i zhvillimi të turizmit të komunës së Shtërpcës, Instituti për arkitekturë dhe urbanizëm, Beograd, viti 1991.

Studimet e cekura dhe programi janë pjesë e bazës së dokumentacioneve që janë pjesë përbërëse e këtij Plani zhvillimor për komunën e Shtërpcës. Përveç kësaj, janë shfrytëzuar dhe hartuar deri më tani dokumentet relevante në lidhje me komunën e Shtërpcës:

- Zgjidhja e menaxhimit të ujit Ibër-Lepenc,
- Baza e ujit në Kosovë,
- Menaxhimi i pyjeve në kuadër të komunës së Shtërpcës.

Së fundi, si baza juridike – ligjore për projektimin e planit për mbrojtjen e mjedisit në këtë Plan hapësinor janë përdorur në mënyrë të veçantë:

- Ligji për Parkun Nacional të Maleve të Sharrit (1986) dhe
- Ligji për mbrojtjen e pjesëve të larta të maleve të Sharrit, Oshljakut, Koxhës Ballkanit dhe Sharrit, si dhe për mbrojtjen e rezervateve natyrore.



Hart 10. Zoodiverziteti në komunën e Shtërpcës

Parku nacional dhe rezervatet natyrore

Kur është fjala për pjesën e larta të maleve të cekura me ligj është shpallur "Parku Nacional i Maleve të Sharrit". Me këtë ligj (1986) janë përcaktuar kufijtë e Parkut Nacional si në vijim: kufiri i Parkut Nacional në pjesën jugore dhe juglindore përputhen me kufijtë administrativ në mes të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës, dhe kalon nëpër majat më të larta të maleve të Sharrit, duke filluar nga maja e Lubotenit (2.496 m), mbi Kullën (2.314 m), Livadicën (2.491 m), Jezercit (2.604 m) deri në kufi me komunën e Prizrenit. Nga këtu kufiri i Parkut Nacional është në kufi në mes të komunës së Prizrenit dhe Republikës së Maqedonisë dhe rrëzë kodrës së maleve të Sharrit mbi Bistrën (2.640 m), Maja e zezë (2.491 m), Kobilica (2.526 m) deri Kara Nikole (2.106 m). Kufiri vazhdon tutje në drejtim juglindor dhe shtrihet te kufiri në mes republikave dhe pastaj kufiri i Parkut Nacional kthehet në veriperëndim deri te lartësia 1.626 m. Kjo kuotë lakon në lindje mbi fshatin Manastirica dhe arrin në lartësinë 1.071 m nga ku tutje shkon te lartësia 1.310 m.

Kufiri i Parkut pastaj lakon në veriperëndim deri te lartësia 1.4365 (Javorovica), dhe prej aty në lindje deri te lartësia 1.765 m (Mlake) dhe nga aty vazhdon në veriperëndim deri te lartësia 1.271 m, duke u shtrirë mbi Fshatin e Epërm (Gornje Selo), ku kufiri i Parkut në vazhdim përbëhet nga rruga Prizren – Brezovicë deri të kështjella e Mbretit në lartësi prej 1.120 m.

Nga kjo kuotë kuturi shtrihet në perëndim mbi fshatin e Virgjëreshës së Shenjtë me izohipsë prej 1.212 m deri te lartësia 1.130 m nga ku në perëndim mbi kuotën 931 arrin në kuotën 1.507 m. Nga kjo kuotë lakon në verilindje deri te kuota 1.656 m duke përshirë Golem Bor nga ana perëndimore dhe arrin në veri në kuotën 1.509 m, e nga aty shtrihet në verilindjen dhe arrin në kuotën 1.598 m (Granizon) dhe vazhdon tutje në veri deri te lartësia 1.931 m dhe deri te lartësia 1.710 m, ku nga aty në veriperëndim deri te lartësia 1.456 m (Rusenica), pastaj, kufiri shtrihet deri te lartësia 841 m, duke përshirë manastirin e Teodorit të shenjtë, kufiri pastaj lakon në lindje në lartësi 1.498 m mbi fshatin Delovcë, dhe lëshohet në lindje te guri Bolovan, duke përfshirë Carevën dhe Bukoshën në lidhje deri në lartësi prej 1.654m nga kjo lartësi kufiri shtrihet në drejtim të juglindjes ku, përsëri hyn në komunën e Shtërpcës dhe arrin në lartësi 1.441 m mbi fshatin Bitia e Epërme, Popovci dhe Bitia e Poshtme. Nga këtu kufiri lakon në jug dhe arrin në lartësi 1.276 m (Çuka), dhe pastaj kufiri lëshohet mbi Orliç deri në lartësi 1.150 m, pastaj në këndin e drejt ngritën në lartësi prej 1.516 m (Borça e Vogël), dhe pastaj lakon në perëndim deri në lartësi 1.440 m (Livadhet Botërore), dhe pastaj lëshohet në jug ku prenë lumin Lepenc dhe ngritet në kokën e Begut deri te izohipsa 1.600 m. Nga aty kufiri lakon në lindje mbi fshatin në Sefcë dhe arrin lartësinë prej 1.312 m, nga aty tutje shkon në verilindje dhe arrin lartësinë duke prerë rrugën Brezovic – Prizren 1.232 m (Burli), lakon në juglindje deri te lartësia 1.453 m, ku vazhdon tutje në veriperëndim deri te lartësia 1.485 m, dhe tutje në drejtim të njëjtë deri te lartësia 1.541m, dhe tutje vazhdon në lindje deri te Maja e Zezë (Crni Vrh) (1.562 m) dhe lartësi 1.712m, duke përfshirë Tupanin, Baçillen dhe lakon në jugperëndim deri te pika fillestare e përshkrimi të kufirit Luboteni ku edhe përfundon.

Me kufij, pra, në kuadër të komunës së Shtërpcës janë përshirë sipërfaqet mbi vendbanimin Berevca, Vërbeshtica, Sevca, jazhinca, Brezovica, Shtërpca, Gotovusha, Drajkoci, Firaja dhe Brodi. Asnjë nga vendbanimet e përmendura nuk është i përfshirë me kufirin e Parkut Nacional. Kufiri i përmendur i Parkut Nacional "Malet e Sharrit" është përcaktuar në vitin 1986. Propozimi i tij është tërësisht në përputhje me rezultatet e hulumtimit deri tek të cilat është arritur në kuadër të projektit shkencor për luginën e Sirinikut (komuna e Shtërpcës) gjatë viteve 1989 – 1991, dhe në kuadër të projektit shkencor për Luginën e Mesme (pjesa e komunës së Prizrenit), Opolës (më parë në kuadër të komunës së Dragashit) dhe Gorës (më parë në kufirin e Dragashit), realizimi i të cilit është planifikuar në periudhën e viteve 1991 – 1993. Me projektet e përmendura më pare, janë përfshirë pjesët e maleve të Sharrit. Në bazë të rezultateve të hulumtimeve të deritanishme mund të përfundohet që me Ligjin për parkun nacional Malet e Sharrit nga viti 1986 nuk janë përfshirë objektet mjaft të rëndësishme natyrore dhe lokalitetet në kuadër të komunës së Dragashit (sot Gora dhe Opola), të cilët do të propozohen për ruajte në bazë të rezultateve të përmendura në hulumtim. Në projektin shkencor të përmendur për luginën e Sirinikut, është konstatuar se:

- në territorin e komunës së Shtërpcës ka, përveç zonave të mbrojtura, edhe disa lokalitete dhe objekte natyrore që do të ishte e dobishme të mbrohen me ligj;
- në kuadër të kufirit të Parkut Nacional Malet e Sharrit në luginën e Sirinikut (komuna e Shtërpcës) është e domosdoshme të vërtetohen më detajisht duke pasur parasysh që ky kufi (1986) është përcaktuar në hartë me raportin 1:100.000 (eventualisht 1:50.000) që nënkupton në hartë më pak detaje;
- që kufiri është përcaktuar përafërsisht (prej lartësisë në lartësi apo sipas izohipsës etj) pa marr parasysh gjendjen reale në hapësirë;
- që në brendi të kufijve parkut Nacional nuk ishte përfshirë lokaliteti Qershia e Rexhës, i cili paraprakisht ka qenë i trajtuar me planin urbanistik gjeneral si pjesë e rajonit të ndërtuar urban.

Në bazë të konstatimeve paraprake rreth këtij Plani Hapësinor të komunë së Shtërpcës miratohet, me ligj, kufiri i parkut nacional Malet e Sharrit si i përkohshëm duke potencuar nevojën që kufiri të determinohet në bazë të rezultateve të programeve shkencore të cekura si Malet e Sharrit të vitit 1993.

Duke pasur parasysh se me këtë Plani Hapësinor komuna e Shtërpcës, po ashtu, përkohësisht aprovon kufijtë e zonën së mbrojtur rreth Parkut Nacional Malet e Sharrit dhe atë: nga kufiri i parkut Nacional në lartësi prej 1.442 m në malin Zhar në juglindje e deri të lartësia 1.238, në malin e njëjtë, dhe pastaj tutje në lindje të fshatit Çuturin dhe vendbanimit Berevca dhe Shtërpca në lartësi 1.037m, pastaj lartësi 1.149 m dhe deri në lartësi 1.228 (Koka) dhe lartësi 1.531 m (Kososhinjë) ku bashkohet me kufirin e Parkut Nacional Malet e Sharrit (paraqitja e hartës është në raport prej 1:25.000). kur është fjala për ndarjen e zonave me shkallë të ndryshme të mbrojtjes së Parkut Nacional Malet e Sharrit, me këtë Plan Hapësinor të komunës së Shtërpcës ka ndër-kritere dhe atë:

Zona e parë e mbrojtur është zona e fenomeneve themelore natyrore me kufizime të mëdha për përdorim dhe me shkallë më të lartë të mbrojtjes. Kjo zonë përfshinë hapësirën e mjediseve burimore me interes të veçantë për zonën e Parkut Nacional Malet e Sharrit. Brenda kësaj zone janë rezervatet strikte natyrore të cilat deri tash ishin të mbrojtur me ligj (Popovo prase, livadhet e Carevës – Gini vode, liqeni i Jazhincës, liqeni i Livadicës, rezervatet e pyjeve të shtëpia e Stojkut), si dhe rezervatet të cilët me këtë Plan propozohen për mbrojtje (malet e bungut nën Oshlak, mali i ahut te Prevalla, malet e rrobullit mbi Gini vodën, mali i Molikës mbi Gini vodën, Ostrovicë).

- Zona e dyte e mbrojtur është zonë mbrojtëse e drejtuar për pushim aktiv dhe rekreacion të banorëve (pikat për piknikë, shtigjet malore shëtitëse), si dhe për zhvillimin e aktiviteteve dimërore sportive me inkurajim të zhvillimit të aktiviteteve turistike. Konkretisht në kuadër të zonës së dytë mbrojtëse në Parkun Nacional Malet e Sharrit në këtë plan hapësinor të komunës së Shtërpcës miratojmë që hapësira të shfrytëzohet për aktivitete dhe veprime në vazhdim:

- Rregullimi i shtigjeve shëtitëse me pika të shënuara për pushimin e turistëve;
- Pushimoret e rregulluara;
- Shtigjet skijimore të rregulluara për turist

- Sistemi i rregulluar për transportin e turistëve (veçanërisht të skitarëve) nga pjesët e ulëta në ato më të larta të maleve të Sharrit, Oshlakut dhe maleve tjera
- Lëvizja e organizuar dhe e kontrolluar e kullotjes së kafshëve, para së gjithash nga vendbanimet që janë në zonën kadastrale në kuadër të parkut Nacional, pastaj nga vendbanimet tjera në përputhje me planin dhe programin e shfrytëzimit dhe mbrojtjes së zonave për kullotje në këtë zonë
- Pyllëzimi i organizuar dhe i kontrolluar me shfrytëzimin e masës drunore në përputhje, me planet dhe programet për mbrojtje të miratuar më parë, si dhe shfrytëzimi i pyjeve
- Shfrytëzimi i organizuar dhe i kontrolluar i specieve pyjore dhe bimore të kullotave me interes për ushqimin dhe mjekimin e njerëzve, do të definohet nga planet e caktuara dhe programeve për përdorim dhe mbrojte të këtyre bimëve, në pakon me ligjin për mbrojtjen e tyre
- Mbarështimi i organizuar dhe i kontrolluar i kafshëve të veçanta në përputhje me ligjin për mbrojtjen e tyre dhe me programe dhe plane përkatëse
- Në kuadër të kësaj zonë është i ndaluar ndërtimi i objekteve banesore dhe objekteve tjera për banim të përkohshëm apo përhershëm, ose për banim të turistëve gjatë qëndrimit të tyre në Parkun Nacional, si dhe i objekteve tjera për zhvillimin e veprimtarive afariste, përveç sistemit për transportin e turistëve nga vendet e ulët në të larta
- Zona e tretë mbrojtëse, apo zona për përdorim të përzier të shkallës së tretë mbrojtëse përfshinë hapësirat tjera të Parkut Nacional të Maleve të Sharrit, e kjo nënkupton hapësirat të cilat në kuadër të komunës së Shtërpcës karakterizohen me sipërfaqe malore dhe bimore (kryesisht për këmbësorë).

Në këtë zonë shfrytëzimi, rregullimi dhe mbrojtja janë të ngjashme me shfrytëzimin, rregullimin dhe mbrojtjen e hapësirës në kuadër të zonës tjetër, pasi që në zonën e tretë është lejuar si në vijim:

- Shfrytëzimi i organizuar dhe i kontrolluar i tokës bujqësore në përputhje me nevojat e banorëve të cilët kanë parcela në këtë zonë të mbrojtur në përputhje me planet dhe programet mbrojtëse dhe për shfrytëzimin e tokës në kuadër të Parkut Nacional
- Pyllëzimi i organizuar dhe i kontrolluar me shfrytëzimin e masës drunore në përputhje me programet për mbrojtje në këtë zonë, si dhe si dhe në përputhje me nevojat e arsyeshme të banorëve të komunës së Shtërpcës me masën drunore, si lëndë e parë për përpunim dhe ngrohje
- Gjuetia e organizuar dhe e kontrolluar për specie të veçanta shtazore dhe atë në hapësirat ku nuk është e paraparë lëvizja e turistëve.
- Shfrytëzimi i planifikuar i lokacioneve të veçanta dhe i zonave për ndërtimin e objekteve për nevojat e zhvillimit të turizmit (hotele, apartamente, shtëpi për vikend me qira për turistët, restorante, objekte sportive dhe objekte tjera përcjellëse duke përfshirë rrugët e asfaltuara, trafostacionet dhe të ngjashme)

Në zonën e tretë mbrojtëse miratojmë zhvillimin intensiv të turizmit dhe rekreacionit në lokacionet: Qershia e Rexhës dhe Shtëpia e Stojkut deri në vitin 2010, si dhe livadhi i Palenskës pas asaj. Për lokalitetet dhe zonat e përmendura përcaktohen me (këtë Plan

hapësinor) nevojat për hartimin e planave detaje urbanistike duke respektuar Ligjin për Parkun Nacional, Ligji për mbrojtjen e natyrës dhe Planin hapësinor të komunës së Shtërpcës.

Përfundimisht, në zonën mbrojtëse rreth Parkut Nacional shfrytëzimi, rregullimi dhe mbrojtja e hapësirës në periudhën e planifikuar do të jetë në përputhje me vendimet dhe programet e planit që lanë të bëjnë me sipërfaqen totale të Parkut Nacional Malet e Sharrit në lidhje me të gjitha nevojat e banorëve për zhvillim, duke marr parasysh së në zonën mbrojtëse gjenden vendbanimet Shtërpca, Berevca, Brezovica, Vërbeshtiva, Jazhinca dhe Sevca, si dhe pjesët e vendbanimeve te Gotovushes, Drajkocit, Firajës dhe Brodit.

Për vendbanimet e përmendura në kuadër të zonës së mbrojtur rreth Parkut Nacional Malet e Sharrit, miratohet nevoja për drejtim të planifikuar të zhvillimi të tyre dhe atë në bazë të:

- Planit gjeneral urbanistik për tërësinë hapësinore të Shtërpcës – Berevcës – Brezovicës – Jazhincë
- Rregullimi urbanistik i bazës së vendbanimit Sevcë
- Rregullimi urbanistik i bazës së vendbanimit Vërbeshticë.

Këto drejtime të planeve janë në drejtim me rekomandimet nga dokumenti rreth "Justifikimi publik i shpalljes së pjesës së maleve të Sharrit në Kosovë në Park Nacional" nga viti 1982, me të cilin theksohet nevojat që "Planet zhvillimore të Parkut Nacional të ardhshëm Malet e Sharrit, në drejtim të vendbanimet brenda kufijve të parkut, duhet të marrin parasysh nevojat e zhvillimit të këtyre vendbanimeve, në veçanti nevojën për zgjerimin e tyre, rregullimin dhe kompletimin me pajisje të përshtatshme urbane"

Kur është fjala për veprimtaritë ekonomikë, në të njëjtin dokument ceket se në kuadër të parkut nacional. Si dhe në zonën mbrojtëse rreth parkut, mund edhe tutje të zhvillohen (në përputhje me nevojat e banorëve) bujqësia, pylltaria, ekonomia e vogël dhe turizmi, dhe industria, por "kapacitetet industriale, me rregullore nuk duhet të vendosen në kufijtë e Parkut Nacional. Përjashtime bëjnë disa kapacitete më të vogla industriale në kuadër të ekonomive të vogla që nuk ndotin ambientin, dhe që me pranin e tyre nuk do të ndikojnë në arritjen e qëllimeve themelore të Parkut Nacional Malet e Sharrit".

Me këtë Plan hapësinor komuna e Shtërpcës nuk planifikon ndërtimin e asnjë objekti industrial brenda kufijve të Parkut Nacional. Planifikon vetëm mbajtjen e kapaciteteve më të vogla industrial në vendbanimin e Shtërpcës dhe ndërtimin e objekteve të reje por të industrisë e cila nuk emeton ndotjen e ujit, ajrit dhe forma tjera të ndotjes. Gjithashtu, në pjesën e Parkut Nacional planifikon të ndërtoj qendrën e re skijimore që është e rëndësisë së madhe jo vetëm për zhvillimin ekonomik të komunës por edhe të rajonit (detalisht është përshkuar në pjesën e planifikimit të këtij dokumenti).

Kur është fjala për rrugën regjionale Doganoviq – Shtërpcë – Prevallë – Prizren miratohet edhe me këtë Plan ekzistimi i saj dhe modernizimi në periudhën e planifikuar deri në vitin 2022.

Së fundmi, si përfundim, theksohet që ky Plan hapësinor i komunës së Shtërpcës i cili në periudhën e planifikuar do të punoj për nevojat e konstituimit, organizmit dhe funksionimit të Parkut Nacional Malet e Sharrit. Në këtë aspekt me Planin hapësinor të komunës së Shtërpcës në mënyrë të planifikuar definohet mbrojtja, rregullimi dhe

shfrytëzimi i hapësirës vetëm në pjesën lindore të Parkut Naiconal, ndërsa në një apo dy vitet e ardhshme, "do të jetë e nevojshme të hartohet plani zhvillimor i Planit hapësinor për tërë territorin e ardhshëm të Parkut Nacional". Në kuadër të hartimit të Planit hapësinor të komunës së Shtërpcës, si dhe Programit për zhvillimin e turizmit në këtë komunë, pastaj edhe hartimi i Planit gjeneral urbanistik Shtërpcë – Berevcë – Brezovicë – Jazhincë dhe i planeve detalje për lokacionet turistike Qershia e Rexhes dhe Shtëpia e Stojkut, subjektet e shfrytëzimit të hapësirës dhe veprimtarive natyrore në sipërfaqen e Parkut Nacional dhe zonat e tij mbrojtje duhet të angazhohen me qëllim të harmonizimit të qëllimeve dhe interesave për shfrytëzimin ardhshëm, rregullimin dhe mbrojtjen e hapësirën së Parkut Nacional.

Përveç Parkut Nacional me ligj janë të mbrojtura edhe pjesët e komunës së Shtërpcës dhe atë në nivelin strikt të rezervateve natyrore:

- Popovo prase në Oshlak
- Livadhet e Carevës – Gini mode, nën Jezercin në Sharr dhe atë nga Prevala deri te liqeni i Jazhincës
- Pylli Pinus peuce – Rododendron ferrugineum te Shtëpia e Stojkut
- Pylli Pinus peuce – Acer ledreichii te Shtëpia e Stojkut
- Liqeni i Jazhincës
- Liqeni i Livadicës

Karakteristikat themelore të këtyre rezervave natyrore strikte do i përmendim në vijim të tekstit.

Pjesa lindore e Oshlakut – kompleksi Popovo prase mbi Prevallën

Në shpatet jugore dhe juglindore (lindore) të Popove prase (pjesa e fundit lindore e Oshlakut gjenden mirë të ruajtura dhe të mjaftë të shtrira malet/pyjet e rrobullit (Pinus – heldelchii), me përbërje të ndryshme. Në shpatat e ekspozuara në jug janë bashkësitë përbërëse Seslerio – Pinetum heldrelchii M. Janket dhe R. Bog., ndërsa në shpatet e ekspozuara në lindje, pakë të lagështa dhe me hije, përbërjet e bashkësisë Luzulo maximae – Pinetum heldrelchii M. Jank. Prandaj, është e qartë se bëhet fjalë për kompleks pyjor mjaft ekologjik dhe fitocenologjik (vegjetativ) interesante.

Vendi i zjarreve ekzistues i malit të rrobullit (shpatat në lindje) tregojnë procesin e vazhdimësisë për të ripërtërirë pyjet e rrobullit, kështu që edhe ky vend zjarri është vend me interes të veçantë shkencor dhe praktik (në lidhje me procesin natyrorë të ripërtëritjes së komplekseve pyjore të shkatërruara nga zjarri, ku ky është një shembull interesant i zjarreve në pyjet e rrobullit).

Diverziteti vegjetativ – florës së këtij kompleksi shihet nga përbërja florisitke e një mali të rrobullit të bashkësisë Seslerio – Pinetum heldreishi dhe menjëherë mbi Prevallën, në naze të këtyre regjistrimeve fitocenologjike:

Oshlak (maleve të Sharrit)

Lartësia mbidetare 1.700 m

Ekspozimi jugor

Baza gjeologjike e gurit gëlqeror.

Pjerrtësia e terrenit 30%.

Pylli i robullit (Seslerio – Pinetum heldreishii), i dendur, përbërë 80%, gjatësia e lisit deri 20 m, trashësia mesatare 40 cm – në katin e parë; në katin e dytë përbërja është 60%, lartësia 10 m. Trashësia mesatare 20 cm.

- Kati i I i lisave
- Pinus heldrelshii 4.4
- Kati i II i lisave
- Pinus heldreishii 3.3
- Kati i III i shkurreve (lartësia deri 3 m, përbërja rreth 40%)
- Pinus heldreishii 2.2
- Juniperus intermedia 1.1
- Kati i IV i bimëve tokësore (mbulesa 90% - e shumë bujshme e pajisur me florë mjaft të pasur) me rreth katër-dhjetë specie.

Duke pasur parasysh afërsinë e rrugës automobilistike (që kalon nëpër Prevallë, duke shkuar për Prizren), të gjitha pyjet e rrobullit mund lehtë të vizitohet (ekskursione në këmbë, ekskursione profesionale, turist), në mënyrë që ky rezervat të ketë një vlerë jo të vogël turistike dhe edukative. Shumica e pyjeve të rrobullit në Kosovë (dhe po ashtu të molikës), është vështirë të arrihen, kështu që qasja e lehtë tek pyjet e rrobullit në lokacionin Popovo prase paraqet një kualitet dhe lehtësi të madhe.

Kompleksi i pyjeve në malet e Sharrit në lindje të Prevallës, nga vendi Gini vode dhe livadhet e Carevës, dhe deri te vargmali kryesor i maleve të Sharrit (duke përfshirë liqenin e Jezercit)

Ky territor për nga bashkësitë e ndryshme pyjore paraqet, nga aspekti ekologjik, vegjetative dhe fitocenologjik, një nga pjesët më interesante dhe më të rëndësishme të Maleve të Sharrit. Në të njëjtën kohë është një nga rezervatet më interesante në këto male.

Duhet theksuar që kjo është pjesa e vetme e maleve të Sharrit (në kuptim të ngushtë), pa degët e tij, ku vegjetacioni fillestar të malit, edhe pse në brezin e ngushtë, është ruajtur deri tek kufiri natyral i pyllit. Po ashtu, pjesë unike në të cilën është shprehur një numër i madh i bashkësive. Përveç kompleksit të pyjeve të ahut, që gjithashtu janë prezent dhe mjaft mirë të zhvilluar në tërë malet e Sharrit për nga interesat e veçanta të pyjeve të përziera të pishave. Askund më në malet e Sharrit dhe në degët e tij nuk ka aq shumë pyje të përzier të pishave, në përbërjen e të cilave marrin pjese tri specie alpine/malore të tyre Pinus: Pinus helderichii, P. Peuce i P. Silvestris. Është fat që në këtë pjesë përveç silikatit paraqitet edhe guri gëlqeror, që ka mundësuar të formohen përbërjet e rrobullit të llojit kacifil (Pinetum heldreichii calcicolum M. Jank)., të përfaqësuara më bashkësi Seslerio – Pinetum heldreichii M. Jank. EtR. Bog. Në fakt kjo lëvizje fillo me një masiv gëlqeror, diku në nivelin e rrugës nga Prevalla në Brezovicë, dhe atë në masivin, sidomos në shpatet e eksponuara në jug, është zhvilluar vegjetacioni i rrobullit i llojit kacifil (bashkësitë e përmendura). Në gurët gëlqeror, në lartësitë më të mëdha mbidetare, vazhdon silikati; kufiri i gurit gëlqeror është i rrethuar me masën e shkëmbinjve të silikatit. Përroi që rrjedh në drejtim të këtij masivi humbet duke u zhytur në kalimet nga silikati në terrenin e gurëve gëlqeror (nga aty "gine vode")

Prezenca e ujit sipërfaqësor, menjëherë nën kokën e gurit gëlqeror, ka shkaktuar krijimin pak a shumë të terrenit moçalik, mbi të cilin është zhvilluar pylli i rrobullit i bashkësisë Ajugo – Pinetum peucis M. Janket R. Bog. (që në fakt edhe është bashkësia ekstreme hidrofile e pyjeve të rrobullit). Vet ky variant i pyjeve më të lagështa të rrobullit i tipit Ajugo – Pinetum peucis geumetnosum coccinei, meriton vëmendje më të veçantë. Por jo vetëm kaq, këtu në bazë të ekspozimit jugor dhe terreni i hapur, është i përfaqësuar rrobulli (Pinus heldreichii), dhe atë me numër të madh, mirë të zhvilluar dhe lisa të gjatë, pa marrë parasysh sipërfaqen e lagësht të silikatit. Kjo ka rëndësi të veçantë ekologjike në lidhje me të kuptuarit e ekologjisë dhe biologjisë të kësaj specie sonë shumë interesante të pishës së lartë endemike ballkanike të rrobullit, të moshës terciare.

Megjithatë, duke pasur parasysh terrenin e hapur dhe tokën moçalike, këtu është prezentë edhe pisha e bardh (Opinus silvestris), e cili së bashku me rrobullin dhe molikën ndërtojnë bashkësi mjaft interesante të pyjeve të përziera (tipa Pino – Pinetum peucis mixtum M. J a n k.).

Këto pyje të përziera hidrofile molika – rrobulli – pisha e bardh zënë relativisht sipërfaqe të vogël. Për dallim të tyre, bashkësia tipike Ajugo – Pinetum piucis shtrihet deri në pjesën e epërme të kufirit malor, në drejtim të liqenit të Jazhincës.

Kështu, përveç brezit të ngushtë, pak a shumë kompakt të pyjeve me pisha (kryesisht rrobullit dhe molikës, dhe pjesërisht pishës së bardhë), me bashkësi të ndryshme dhe nën-bashkësi në gurët gëlqeror dhe silikatit, nga koka gëlqerore në afërsi të rrugës dhe deri te kufiri i epërm i pyllit, në këtë rezervat kompleks duke përfshirë edhe kompleksin e pyjeve të ahut (në pjesët më të ulët, nën pyjet e rrobullit dhe molikës: dhe ato janë përbërjet e bashkësisë Fagetum montanum silicicolum në disa vende mund të mbetjeve të bashkësisë Abieto – Fagetum).

Dy komplekse më të vogla të pyjeve të rrobullit tek shtëpia e Stojkut

Kompleksi më i vogël i pyjeve të rrobullit tek shtëpia e Stojkut, në shpatet veriore të maleve të Sharrit, përball Brezovës, paraqet në fakt bashkësinë Rhododendro – Pinetum peucis M. Jank, et R. Bog. Për shumë çka, kjo bashkësi është me karakter të madh, sidomos pasi që bëhet fjalë për kombinim fitocenologjik të dy llojeve relikte dhe endemike: Pinus peuce i Rhododendron ferruginea. Lloji i fundit është për nga interesi i veçantë, për shkak të vargmaleve të kësaj specie në Evropë dhe në praninë mjaftë të rrallë të tij, si dhe vet llojet e Rhododendron ferruginea, në gadishullin Ballkanik

Liqeni i Jazhincës

Liqeni i Jazhincës gjendet në 2.128 metra të lartësisë spsolute dhe atë në rrethin e burimi të lumit të Thatë (Suva reka). Në nivelin më të lartë të ujit thellësia e liqenit është 11 metra, gjatësia rreth 150 metra dhe gjerësia rreth 87 metra. Vija e rregullt është e gjatë 500 metra, sipërfaqja deri 10.620 m². Vëllimi i liqenit është rreth 45.100 m³, ndërsa temperatura e ujit gjatë verës është rreth 1º C. Tejdukshmëria e liqenit është e plotë.

Liqeni i Livadicës

Ky është edhe një objekt hidrologjik, gjeomorfologjik dhe glacial i formuar në pirgun pas shkrirjes së akullnajës,. I gjatë është 220 metra, i gjerë 125 metra. Gjatësia e bregut është 683 metra, ndërsa thellësia më e madhe është 6,7 metra. Sipërfaqja e liqenit është 20.580 m², dhe vëllimi 74.715 m³. Uji është i kthjellët, i pastër dhe me ngjyrë gjelbër – kaltër. Në kohën e

nivelit më të madh të liqenit uji rrjedh mbi sipërfaqe. Liqeni gjendet në 2.173 metra të lartësisë apsolute dhe i përket burimit të lumit të Kalugjerës. Prvec vlerave natyrore të cekura dhe me ligj të mbrojtura në malet e Sharrit ekzistojnë edhe disa tjera, po ashtu, lokacione të vlefshme mbrojtja e të cilave propozohet edhe me këtë plan. Kështu, në zonën më të gjerë të rezervateve natyrore "Popovo prase: dhe "Gini vode – livadhet e Carevës" gjenden, gjithashtu, pyje mjaft të vlefshme, të cilat kur të mbrohen, me të tjerat të përmendura do të paraqisnin kompleksin e përgjithshëm natyror në pjesën jugperëndimore të komunës së Shtërpcës. Duke cekur regjistrimet fitocenologjike të disa përbërjeve të rëndësishme të pyjeve:

Pylli i ahut (Fegetum montanum silicicolum), te Prevalla

Lartësia mbidetare 1.500 m.
Sipërfaqja gjeologjike nga silikati
Ekspozimi veriperëndimor
Pjerrtësia e terrenit 15 shkallë
Pyll i dendur i ahut

- Kati i I, lisat (përbërja 90%, lartësia e lisit nga 25 deri 30 m, trashësia mesatare 40 deri 50 cm)
- Fagus moesiaca 3.3

- Kati II, lisat (lartësia 10 deri 15 m, trashësia mesatare e lisit 10 deri 20 cm).
- Fagus moesiaca 2.2

- Kati i III, bimët sipërfaqësore (mbulimi i terrenit 50%) me 26 specie.

Pylli i rrobullit (ky variant me Lonicera hxlosteum dhe Carum grecum) vargu gëlqeror – mbi luginën e lokacionit Gini vode.

Lartësia mbidetare 1.700 m.
Sipërfaqja gjeologjike nga silikati
Ekspozimi juglindor
Pjerrtësia e terrenit 45 shkallë.
Relativisht mjaft i dendur pyll i rrobullit

- Kati i I, lisat (përbërja 80%, lartësia e lisit 20 m, trashësia mesatare e lisit 35 cm).
- Pinus heldrelshii 4.4

- Kati i II, shkurret (përbërja 40%, lartësia deri 3m).
- Pinus heldreichii 2.2
- Juniperus intermedia 1.1

- Kati III sprat, bimët sipërfaqësore (mbulimi i terrenit 60%) me 22 specie.

Pylli i molikës (Ajugo – Pinetum pucis), në vargun mbi lokacionin Gini modem mbi pyllin emëparshëm të rrobullit

Lartësia mbidetare 1.800 m.
Sipërfaqja gjeologjike nga silikati
Ekspozimi veriperëndimor
Pjerrtësia e terrenit 25 shkallë.
Pyll i dendur i molikës

- Kati i I, lisat (përbërja 90%, lartësia deri 20 m, trashësia 30 cm.)
- Kati i II, kaçubet (përbërja rreth 30%, lartësia deri 2 m)
- Juniperus intermedia +
- Pinus peuce +
- Kati i III, bimët sipërfaqësore (përbërja 70%) me 19 specie.

Përveç zonës së Prevallës, edhe Ostrovica ka nevojë për vëmendje, zona e sipërme malore mbi pyjet e ahut deri te majat më të larta


Masivi i Ostrovicës është veçanërisht interesant sepse bëhet fjalë për sipërfaqe gjeologjike nga serpentina. Për këtë duhet theksuar që sipërfaqja gjeologjike nga terpentina shtrihet deri në majat më të larta duke i ndërtuar, kështu që është ofruar edhe mundësia që në viset e larta malore të zhvillohet vegjetacioni në serpentnë. Me fjalë tjera, në serpentinë është i zhvilluar vegjetacioni i pyjeve të rrobullit (Pinetum heldreichii serpentini colum M. J a n k.) që i përkasin bashkësisë Ptilotricho – Bruckenthallo – Pinetum heldreichii M. J a n k. Pyjet e rrobullit në serpentinë janë fenomen i rëndësisë së veçantë, pyjet e rrobullit në serpentinë në Ostrovicë janë rast i veçantë i vegjetacionit jo vetëm në komunën e Shtërpcës por edhe në tërë gadishullin Ballkanik. Prandaj, është e qartë se këtu bëhet fjalë për ndarjen e rezervateve të mbrojtura rreptësisht. Mirëpo, këtu nuk është fjala vetëm për pyjet e rrobullit. Në serpentinën e Ostrovicës, në pjesët më të larta të saj deri te majat e larta gjendet vegjetacione i viseve malore të larta të pishës krivula (Pinus mugo), e cila i përket Ptilotricho – Bruckenthallo – Pinetum mughi M. J a n k, et R. B o g (ose bashkësia e grupit Pinetum mughi serpentinicolum M. J a n k.). Sipas hulumtimeve të deritanishme do të ishte e nevojshme të mbrohen këto bashkësi të pishave, që nga aspekti shkencor dhe praktik janë shumë të rëndësishme. Domethënë, edhe pisha krivula në bashkësinë e serpentinës janë raritet në gadishullin Ballkanik. Që të arrihet efekti i plotë, këtu do të duhet të mbrohet i tërë kompleksi i bashkësisë terpentine të rrobullit, bashkësitë terpentine të krivulave, si dhe sipërfaqet e kullotave në mes tyre. Në këtë mënyrë, do të kishim nën mbrojtje një kompleks serpentinë të tërë të vegjetacioni me shumë pak lloje të bashkësive malore dhe të viseve të larta malore (kullotat dhe krivulat), me përbërje të ndryshme dhe të rëndësishme të fitocenolozës. Me mbrojtjen e këtij vegjetacioni kompleks do të mbronin një sërë lloje terpentine dhe të rëndësishme tjera, që është shumë me rëndësi. Përveç rezervateve të propozuar më parë, propozohet që me ligj të mbrohet druri i dushkut Quercus robur në afërsi të vendbanimit Izhancë.

Për tërë sipërfaqen e luginës së Sirinukt është karakteristikë që si përgjatë Lepencit , ashtu edhe gjatë degës së Lepencit në luginë shfaqet verri (Alnus glutinosa) dhe shelgu (Salix spp.). lisi i bungut nuk është i hasur. Është një surprizë e madhe që në rrjedhën e poshtme të lumit të Izhancës në lartës prej 710 metra gjendet lisi i bungut (Quercus robur). Ai gjendet në anën e majtë, i ngritur një metër përmbi ose në nivelin e ulët të ujit. Karakteristikat e vendeve ku ndodhet lisi i mbetur i bungut janë shumë më larg prej atyre që mund të quhen normale për paraqitjen e këtij lloji. Bregu dhe shtrati i lumit është shkëmbor, plot me guralecë me mungesë të materialit të imët. Në bregun e lumit mbështeten anët shkëmbore të pjerrëta të luginës së lumit. Aluviale të rrafshëta nuk ka. Është e dukshme lidhja e drejtpërdrejtë e sistemit të rrënjëve të bungut me bazë gëlqerore. Lisi i bungut është pothuajse i lidhur drejtpërdrejt në hapësirë me bashkësinë e shkozës së zezë dhe bungut, që rritet në anën jugperëndimore të Shtumanin (974 m), vargu i të cilit e përbënë pjese e pellgut ujëmbledhës në anën e majtë të pellgut të lumit të Izhancës. Nuk është e njohur që deri më

sot është vërtetuar pjesëmarrja e lisit të bungut në këtë sipërfaqe të mjedisit termofil. Lisi është i vjetër, i mbështjellur me zgavrën e djegur, me diametër rreth 80 cm, sporulatës.

Ne mendojmë se kjo mbetje tregon prezencën e pyjeve të dushkut në luginën e Sirinikut, ku së pari si vlerë shkencore dhe tregues për karakterin e vegjetacionit të dikurshëm. Prandaj ne jemi të lirë që t'u propozojmë organeve të komunës se Shtërpcës që me bashkëpunim me menaxhmentit të pyjeve të organizojmë mbrojtjen e këtij druri.

Së fundmi, në hulumtimet shkencore të luginës së Sirinikut , u gjet së në luginën lindore të Oshlakut gjendet lokaliteti me hapje të shpellave që mendohet se janë hyrjet për në shpellë, vlera e së cilës do të përcaktohet pas disa detaleve speleologjike, hidrologjike dhe hulumtimeve tjera të ngjashme. Dhe ky objekt natyrorë është e rëndësishme të mbrohet më parë deri te tretmani i plotë dhe detaj shkencor i tij.



Harta.11. Zonave të mbrojtura brenda Parkut Nacional "Mali Sharr".


Fatkeqësitë natyrore-tërmetet

Në fatkeqësitë natyrore përfshihen: vërshimet, pirgjet e borës, bora e madhe, erërat e forta, breshëri, akulli, thatësira, dukuritë masive të sëmundjeve infektive të njerëzit, kafshët dhe bimët dhe fatkeqësitë tjera të shkaktuara nga natyra.

Me fatkeqësi tjera nënkuptohen aksidentet rrugore, ajrore dhe të transportit hekurudhor, zjarret, fatkeqësitë në miniera, rrënime i digave dhe fatkeqësitë tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga veprimtaria dhe sjellja e njeriut, gjendjet e jashtëzakonshme, temperaturat e larta, kolapsi teknik i sistemeve energjetike për furnizim me energji elektrike, teknologjisë së telekomunikimit dhe informacionit, aktet terroristike dhe mënyrat tjera të kërcënimit masiv. Territori i komunës së Shtërpcës vazhdimisht ballafaqohet me fatkeqësi natyrore dhe artificiale, kështu që Drejtoria për shërbime publike dhe emergjencë përgjegjëse për menaxhimin e këtyre situatave emergjente si:

- Zjarret ,
- Vërshimet,
- Tërmetet,
- Fatkeqësitë tjera natyrore.

  Një nga fatkeqësitë më sfiduese natyrore në tërmet.



Harta.12. Seizmikciteti i Shtërpcës

Bujqësia

Viset malore janë tradicionalisht, para së gjithash, shfrytëzuar për blegtori, dhe në mas më të vogël për prodhimin e kulturave bujqësore. Ky konstatim vlen edhe për komunën e Shtërpcës duke marr parasysh se territori i saj gjendet në lartësi prej 640 deri 2.597 m, dhe që në të ka kullota dhe livadhe si dhe sipërfaqe të pemishteve , pjellore dhe të punueshme.

Në komunën e Shtërpcës për prodhime bujqësore (sipas të dhënave të drejtorisë së Gjeodezisë) shfrytëzohen gjithsej 13.649,7 ha. Pjesa e këtyre sipërfaqeve pjellore është rreth 56,9 %, në kuadër të komunës 55,2%. Nga këto sipërfaqe sektori publik shfrytëzon 7.019,0 ha (51,4 %), ndërsa privat 6.633,7 ha (48,6 %). Sektori publik ka 7.012,4 ha sipërfaqes blegtorale (63,8 %), ndërsa privat 3.972,8 ha (36,2 %). Sipërfaqet tjera bujqësore janë mjaft të vogla të papërfillshme (6,5 ha ose 0,2 %), derisa në sektorin privat 2.667,5 ha të këtyre sipërfaqeve (99,8 %).

Industria

Gjendja e tanishme e industrisë në komunën e Shtërpcës është mjaft e pafavorshme. Si kompleksi më i rëndësishëm industrial ishte fabrike e pjesëve mekanike „Ivo Lola Ribar“ që ka prodhuar makina për përpunimin e metalit. Krahas kësaj në këtë fabrikë janë prodhuar edhe lidhëset për piano, si dhe trupat ndriçues. Pastaj, ekziston edhe “Pilana” e cila viteve të fundit punon si kompani e pavarur. Në fabrikën për përpunimin e drurit “Pilana” përpunohet druri dhe pjesët e mobileve. Deri vonë kanë ekzistuar kapacitetet për prodhimin e medikamenteve “Mediteks”, por, viteve të fundit nuk ka prodhim edhe pse ekzistojnë kapacitete njerëzor, hapësirë të përshtatshme por teknologji mjaft të vjetërsuar.

Industrinë në bazë të sektorëve mund ta klasifikojmë në publike dhe private. Në sektorin privat veqojmë: N.P. „Aqua Breza“ në Brezovocë dhe N.P. “Luboteni” në Bitinë e Poshtme që merren me nxjerrjen dhe përpunimin e ujit mineral.

Ndërmarrjet publike, sipas analizave, në kohët e fundit kane regjistruar një rënie të dukshme ekonomike, deri sa ato private, sidomos ato prodhuese ndikojnë në zhvillimin ekonomik.

Në këtë zonë ekzistojnë kushtet edhe për zhvillimin më të madh se tanishëm të industrisë. Këtu industria do të mund të zhvillohet si veprimtari suplementare për aktivitete tjera ekonomike.

Turizmi

Komuna e Shtërpcës karakterizohet me kushte mjaft të vlefshëm natyrore për zhvillimin e turizmit. Malet e Sharrit me lartësi deri në 2.600 m dhe me shpata jashtëzakonisht të favorshme veriore për zhvillimin e turizmit dimëror dhe veror, është vlerë e cila deri më sot është shfrytëzuar shumë pak. Shpatat e buta të thepisura në dimër dhe shpati i gjelbër të përshtatshme për rekreacion gjatë verës me vlerë turistike gjeomorfologjike (majat e larta të Sharrit, shpatat e thepisura, luginat me origjinë glaciale/akullnajore) dhe hidrologjike (burime të shumta dhe prroje që janë aktive gjatë verës) si dukuri hyn në lokacionet më të rëndësishme turistike në Kosovë. Nga pikëpamja e nevojave të komunës së Shtërpcës për zhvillim social – ekonomik sigurisht që në të ardhmen duhet të aktivizohet hapësira më e madhe për qëllime turistike.

Sot për nevojat e turizmit në komunën e Shtërpcës shfrytëzohen hapësirat e vogla: hotelet, restorantet, vendpushimet dhe objektet tjera përcjellëse turistike, duke përfshirë edhe dhjetëra kilometra të rrugës së asfaltuar nga Brezovica deri te hoteli "Molika" nuk zënë më shume së rreth 15 ha. Përveç këtyre, në mënyrë periodike për nevojat e rekreative në verë, e veçanërisht, dimrit shfrytëzohen shtigjet skijimore dhe ato për shëtitje jo më shumë se 10 – 15 ha. Në sipërfaqen e përgjithshme të komunës së Shtërpcës, pjesa e këtyre hapësirave, pra, është vetëm rreth 0,12 %. Këto zona të cekura, pra, në të ardhmen mund të zgjerohen edhe për 10 apo më shumë herë (sepse këso lloj terrene ka mjaft) dhe atë pa rrezik për pengimin e zhvillimit të veprimtarive tjera ekonomike – afariste duke përfshirë edhe pylltarinë dhe bujqësinë (blegtorinë).

Shtatë ashensor aktual mbi hotelin "Molika" nuk paraqesin "ngarkesë" në hapësirë për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave; pjesërisht trasat e tyre kalon edhe nëpër shkëmbinjtë shterp, kanale dhe urina, të cilat janë plotësisht jo pjellore dhe në këtë mënyrë shfrytëzohen për qëllime të "prodhimit". Analizat e deritanishme të kushteve gjeomorfologjike dhe biogjeografike për zhvillimin e turizmit në Sharr tregojnë për ekzistencës e kushteve të favorshme për zhvillimin e kësaj veprimtarie në jugperëndim të hotelit "Molika" deri te livadhet e Bistrës dhe Carevës, në një anë, dhe deri në verilindje dhe në lindje të hotelit në drejtim të Lubotenit, Shtërpcës dhe Gotovushës, në anën tjetër. Këtu para, së gjithash, mendojmë për potencialet natyrore për nevojat e turizmit dimëror. Mirëpo, përveç këtyre terreneve, për zhvillimin e turizmit janë të favorshme edhe pjesët e tjera të komunës, sidomos në pjesën e burimit të Lepencit (mbi Sevcën). Në skicën në aneks është paraqitur shpërndarja hapësinore e objekteve të planifikuara turistike të akomodimit, ashensori dhe pika që do të trajtohen si komplekse turistike me të gjitha kapacitetet e nevojshme për qëllime akomodimi, siç ishte cekur më parë, për qëndrimin e turistëve me mundësi më të mira ekonomike. Paraqitja e shpërndarjes së pikave kryesore turistike në malet e Sharrit (nga Shtërpca prej rreth 850 m dhe Brezovica në rreth 910 m deri te 2.580 kreshta e këtij mali) në lidhje me Shtërpcës, si qendër e komunës, dhe në rrugën regjionale Prizren – Prevall – Shtërpcë – Ferizaj, qartë tregoj në rëndësinë turistike të kompleksit "Treshnja" (Qershia) për zhvillimin e përgjithshëm të turizmit në komunën e Shtërpcës. Pozita qendrore e këtij kompleksi turistik në krahasim me komplekse tjera turistike "Brezovica" dhe "Shtëpia e Stojkut" si dhe "Livadhet e Carevës" dhe "Shtërpca" theksojnë rëndësinë e jashtëzakonshme për zhvillimin e më tutjeshëm të turizmit (veror dhe dimëror) në komunën e Shtërpcës dhe në Kosovë. Lokacioni „Tršenja" (Qershia), si dhe të gjitha lokacionet e planifikuara të ndërtohen dhe të organizohen si komplekse të qendrës turistike të lidhur njëri me tjetrin dhe të cilët me atraktivitetin e tyre mund të afrojnë (verës dhe dimrit) numrin më të madh të turistëve nga jashtë.

Rrjeti rrugor

Në territorin e komunës së Shtërpcës, rrjeti i rrugëve të kategorizuara, regjionale dhe rrugore që lidhin qendrën e vendbanimeve me rrugën regjionale, shtrihet në gjetësi totale prej 70 km. Nga këto, 54 km ose 77% janë rrjet bashkëkohor. Komuna është pa rrugë magjistrale.


Rruga regjionale që kalon nëpër territorin e komunës në drejtim të jugperëndimit – verilindjes është me një shtrirje bashkëkohore dhe lidh komunën e Prizrenit, në jugperëndim dhe me rrugën magjistrale Prishtinë – Ferizaj – Shkup, në lindje. Në territorin e komunës rruga regjionale është e gjatë 25 km, me gjerësi prej 6-7 m.

Rrugët lokale lidhin vendbanimet me rrugën regjionale, apo qendrën turistike me rrugën regjionale. Këto rrugë janë rrugë me ose pa shtresë bashkëkohore. Gjerësia e rrugëve lokale me shtresë bashkëkohore është 3-5 m.

Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në komunë bëhet nga "NJKP' (Novo Javno Komunalno Preduzeće/Kompania e Re Publike Komunale). Në bazë të të dhënave të fituara "NJKP" 80 % të vendbanimeve janë të mbuluar me shërbime komunale. Nga 16 vendbanime në komunën e Shtërpcës, vetëm 3 fshatra nuk janë të mbuluar me shërbime komunale (Sushica, Izhanca dhe Kashtanjeva), për shkak të terrenit të pakalueshëm. Pajisjet komunale janë të shpërndar në mënyrë të barabartë në 13 fshatra. Për grumbullimin e mbeturinave janë në dispozicion kontejnerët 1,1 m^3, të cilët janë të shpërndarë pranë institucioneve publike dhe shportat të cilat i posedon gati çdo shtëpi. Në vendbanimet të cilat nuk janë të mbuluar me shërbime komunale, deponimi i mbeturinave bëhet ne deponi të egra.


Komuna jonë nuk posedon deponi në të cilat do të mund të deponoj mbeturinat, por mbeturinat i transporton në Gërlicë dhe Gjilan.



Harta13. . Menaxhimi i mbeturinave në komunën e Shtërpcës

Sistemi i kanalizimi të ujërave të ndotura

Në komunën e Shtërpcës **12,5** % e vendbanimit është i mbuluar më rrjetin publik të kanalizimit, **25** % është në procesin e ndërtimit, **6,25** % është pjesërisht i mbuluar dhe **ž,25** % nuk është i mbuluar me rrjetin e kanalizimit. Në territorin e komunës së Shtërpcës nuk ekziston rrjeti kryesor i kanalizimit.



Harta.14 Infrastruktura e kanalizimit

Trafiku dhe transporti

Tradicionalisht në Komunën e Shtërpcës lëvizja është kryer kryesisht në formën jo të motrizuar dhe në një masme lëvizje të motorizuar. Mirpo në vitet e fundit Komuna e Shtërpcës ka ndërruar që është kryesisht e motorizuar dhe pak jo e motorizuar, por ende jo transport hekurudhor ose forma tjera. Komuna e Shtërpcës sot numëron mjaftë mjete motorrike duke përllogaritur edhe ato që hyjnë dhe dalin çdo ditë në nëpër territor të

komunës. Përmirësimi i rrjetit rrugor nuk ka avancuar proporcionalisht me rritjen e presionit të automjeteve ndaj rrjetit rrugor.

Diskutimi i qarkullimit/trafikut është tejet i lidhur edhe me çështjen e transportit dhe cilësisë së transportit publik në Shtërpc. Sistemi i qarkullimit dhe transportit në Shtërpc vuan disa problematika:

Qarkullimi vuan mungesën e rrjedhshmërisë kryesisht për shkak të një rrjeti rrugor që nuk është projektuar për të akomoduar një presion qarkullues të këtij niveli. Kuptohet që mungesa e hierarkisë së rrjetit rrugor dhe niveli i lartë i rrugëve me fund janë një pjesë e shkaqeve që krijojnë trafik në Shtërpc.

Mungesa e disiplinimit të qarkullimit vjen për shkak të mungesës së planifikimit të rregullave të qarta në qarkullim. Rrjeti qarkullues nuk është i larmishëm. Parkimi është një temë që influencon tepër qarkullimin në Shtërpcës.

Zhvillimi i Popullatës

Brenda secilit vendbanim është llogaritur popullata, sipërfaqja e ndërtuar dhe intensiteti bruto i popullatës. Në mënyrë që të korrektohet intensiteti bruto i popullatës për këto vendbanime, në llogaritjen e sipërfaqes janë zbritur sipërfaqet e shërbimeve .

Dhënat e Popullatës

Duke u nisur nga komponenti irrjedhave demografike, grupi punues për demografinë dhe çështjet sociale ka analizuar gjendjen e tanishme dhe atë të mundshme në të ardhmen. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1981 – 1989 ekzistojnë të dhënat e sakta për numrin e banorëve të komunës së Shtërpcës. Gjithashtu, gjatë profilit dhe analizës së gjendjes janë shfrytëzuar edhe burimet tjera siq janë IMG, OSCE, UNHCR si dhe parashikimet profesionale, ku grupi punues ka supozuar dhe ka marr të dhënat më relevante të paraqitura në tabela. Nga numri i përgjithshëm i banorëve 36,7 % e përbëjnë të rinjtë të moshës 0-19, derisa banorët mbi 60 vjet zë një pjesë të vogël, rreth 11,5 % të banorëve të përgjithshëm.

Mosha		Përqindja
Mosha	(0-19 vjet)	36,7 %
Mosha	(20-39 vjet)	30,9 %
Mosha	(39-59 vjet)	20,9 %
Mosha	(mbi 60 vjet)	11,5 %

Tabela nr. 14. Struktura e popullsisë sipas moshës

Nr. vendbanimeve	Emërtimi i vendbanimit	Nr. i banorëve
1	Berevca	810
2	Brezovica	620
3	Brod	1.850
4	Viça	320
5	Vërbeshtica	820
6	Bitia e E.	540
7	Gotovusha	950
8	Bitia e P	830
9	Drajkoci	270
10	Izhanca	200
11	Jazhinca	700
12	Kashtanjeva	400
13	Sevca	1.400
14	Sushica	180
15	Firaja	1.240
16	Shtërpca	2.770
Totali		13.900

Tabela nr. 15. Regjistrimi i numrit të banorëve në vendbanime

14. PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I SHTËRPCËS

Komuna e Shtërpcës aktualisht ka një PZHK e cila është e punuar sipas Ligjit të vjetër të Planifikimit poashtu për këtë komunë kanë ekzistuar disa plane të niveleve më të ulta apo të pjesëshme si Plani Hapësinor i Parkut Nacional "Mali Sharr" i cili përfshinë një pjesë të territorit të Shtërpcës, pastaj Master Plani për qendrën turistike në Brezovicë, mundë të themi se kanë munguar edhe disa Plane tjera të niveleve më të ulëta si PRRH apo edhe studime fizibilitetit për zonat turistike dhe zona tjera me rendesi për komunën dhe me gjerë. Poashtu edhe kontroli i dobët i zhvillimeve në terren ka çuar në një zhvillim të pabalancuar hapësinor dhe një keqshfrytëzim të tokës. Plani i ri synon të jëtë një dokument pune që të koordinojë veprimatritë urbanizuese të këtij rajoni si dhe të udhëheqë veprimtarinë e investimeve publike në këtë rajon.

Vizioni,objektivat dhe prioritetet strategjike

Komuna e Shtërpcës *në rolin e një lideri rajonal me turizëm të zhvilluar, me të gjitha pasuritë natyrore, bujqësi të zhvilluar dhe me tendenca të traditës dhe rrjedhave moderne,me cilësi dhe mjedis të qëndrueshëm për të gjitha komunitetet.*

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE

Në vitin 2015 është miratuar Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm që përfshin 17 Qëllime të Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ). Duke u bazuar në parimin e "lënë askush prapa", Agjenda e re thekson një qasje holistike për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm për të gjithë. Më poshtë, gjeni grafikën ku janë listuar të gjithë 16 QZHQ- të, të cilat janë përvetësuar si qëllime të përgjithshme të zhvillimit të Shtërpcës nëpërmjet PZHK-së do të zbatohen sipas mundësive si një hap drejt krijimit të mundësive për bashkëpunim ndërkombëtar dhe koordinim të donacioneve.

1. Jo Varfërisë	•Elimino varfërinë në të gjitha format e tij kudo.
2. Elimino Urinë	•Eliminim i urisë, ngritja e cilësisë së ushqyerit dhe promovim i bujqësisë së qëndrueshme.
3. Shëndet i mirë	•Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe mirëqenies së njerëzve të gjitha moshave.
4. Arsim cilësor	•Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe plotësim i drejtës për mësim gjatë gjithë jetës.
5. Barazi Gjinore	•Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave.
6. Ujë i pastër	•Sigurimi i pajisjeve dhe administrimi i qëndrueshëm i ujësjellësve dhe kanalizimeve për të gjithë.
7. Energji e përballueshme	•Sigurimi i energjisë së qëndrueshme e moderne dhe me çmim të përballueshëm.
8. Zhvillim ekonomik	•Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme përmes punësimit në kushte humane dhe të denja, për të gjithë.
9. Industrisë, Inovacionit dhe Infrastrukturës	•Ndërtimi i infrastrukturës rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe e inovacionit.
10. Redukto pabarazitë	•Zvogëlimi i pabarazisë ndërmjet të Qytetit dhe zonave rurale, si dhe në mes të zonave rurale.
11. Qytete të qëndrueshme	•Gjilani, qytet/ vendbanim gjithëpërfshirës, i parrezikshëm, rezistues dhe i qëndrueshëm;
12. Konsumim i përgjegjshëm	•Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.
13. Ndryshimi klimatik	•Lufta kundër ndryshimeve klimatike dhe efekteve të tij, me aktiviteteve të planifikuara dhe me efekte lokale.
14. Jeta në Tokë	•Shfrytëzim i qëndrueshëm i pyjeve dhe ndalimi i degradimit të tokës dhe humbja e biodiversitetit.
15. Institucione efektive	•Zhvillim gjithëpërfshirës, qasje në drejtësi për të gjithë dhe institucione efektive dhe të përgjegjshme.
16. Partneritet për Qëllimet	•Forcimi i zbatimit dhe rivitalizimi i partneritetit për zhvillim të qëndrueshëm.

Tabela .16. Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm që përfshin 17 Qëllime të Zhvillimit të Qëndrueshëm

6. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E VEÇANTA

Qëllimet e veçanta të cilat do prezantohen në fushat tematike të PZhK-së, të mbështetur në hulumtimin e gjerë dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese, dhe paraqesin sintetizim të qëllimeve të prezantuara nga drejtoritë komunale, institucionet tjera publike lokale dhe qendrore, shoqërisë civile, si dhe "16 Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030".

Objektivat e propozuara janë specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe të lidhura për afatet kohore që synohet për tu arritur brenda një periudhë kohore specifike.




Figura.5. Zbërthimi i Objektivave sipas konceptit SMART

Qëllimet dhe objektivat tematike

1. ZHVILLIMI EKONOMIK			
Qëllimi 1: Zhvillimi i zonave industriale, ekonomike të biznesit, korridoreve zhvillimore ekonomike.			
Objektiva 1.1: Krijimi dhe zhvillimi i infrastrukturës të zonës ekonomike te Shtërpcës dhe Gotovushës		Objektiva 1.2: Krijimi dhe zhvillimi i infrastrukturës të zonave ekonomike në korridorin e rrugës rajonale.	
Qëllimi 2: Modernizimi i bujqësisë dhe procesimi i produkteve bujqësore			
Objektiva 2.1: Menaxhimi adekuat i tokave bujqësore dhe pyjeve përmes përcaktimit të kufijve të zonave bujqësore dhe pyjore deri në vitin 2021	Objektiva 2.1: Zhvillimi I blegtorisë, pemëtarisë dhe perimekulturave në etapat 2020-2022, 2023-2024, 2025-2028	Objektiva 2.2: Ngritja e kapaciteteve të prodhuesve për kultivimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, në veçanti grave në bujqësi etapat 2019-2021, 2022-2024, 2025-2027	Objektiva 2.3: Sigurimi I infrastrukturës për grumbullimin, ruajtjes dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore në etapat 2019-2021, 2022-2024, 2025-2027

Qëllimi 3: Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në Shtërpcë	
Objektiva 3.1: Promovimi i pakos së integruar të turizmit (përfshirë natyrën dhe trashëgiminë natyrore të parkut kombëtar Mali Sharr, qendrën e vjetër dhe të re të skijimit në funksion të zhvillimit ekonomik) deri në vitin në vitin 2024.	Objektiva 3.2: Në bashkpunim me nivelin qendror ndërtimin e qendrës së re të skijimit 2026.

2. INFRASTRUKTURA TEKNIKE			
Qëllimi 1: Administrimi i qëndrueshëm i ujësjellësve dhe kanalizimeve			
Objektiva 1.1: Mbulueshmëria e 100% i territorit të komunës me rrjet të ujësjellësit të fshatrave deri në vitin 2023	Objektiva 1.2: Përmirësimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit në qytet – zvogëlimi i humbjeve deri në 100 % deri në vitin 2021;	Objektiva 1.3: Mbulueshmëria e 100% i territorit të komunës me rrjet të kanalizimit të fshatrave deri në vitin 2025	Objektiva 1.4: Shkyçjet e lidhjeve ilegale në ujësjellës deri në vitin 2020
Objektiva 1.5: Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza 2026		Objektiva 1.6: Përmirësimi i mirëmbajtjes dhe funksionalizimit të rrjetit ekzistues atmosferik në qytzë ndarja e ujërave të zeza dhe atmosferike deri në vitin 2022	
Qëllimi 2: Sigurimi i energjisë së qëndrueshme e moderne			
Objektiva 2.1: Shtrirja nëntokësore e rrjetit elektrik dhe të TI –së në 70% të zonave urbane deri në vitin 2022	Objektiva 2.2: Ndërrimi i pajisjeve të vjetra elektro-energjetike deri në vitin 2026	Objektiva 2.3: Përmirësimi i rrjetit ekzistues dhe furnizimi cilësor me energji elektrike në gjithë territorin e komunës me theks të veçantë zonën turistike.	Objektiva 2.4: Përmirësimi dhe rritja e efiçencës energjetike në objektet publike 90% deri në vitin 2025 dhe 70% deri në vitin 2030 ndërsa për objektet private 60% deri në vitin 2025
Objektiva 2.5: Hulumtimi i mundësive për ndërtimin e sistemit të ngrohjes të bazuar në energjinë solare deri në vitin 2021			
Qëllimi 3: Ofrimi i shërbimeve moderne të telekomunikimit			
Objektiva 3.1: Zhvillimi i teknologjisë dhe pajisjeve për shërbime të telekomunikimit 4G dhe 5G LTE deri në vitin 2025	Objektiva 3.2: Mbulueshmëria e 100% i territorit të komunës me rrjet optik kabllore deri në vitin 2022	Objektiva 3.3: Zhvillimi i një infrastrukturë për një rrejt të përbashkët për shërbime të telekomunikimit deri në vitin 2022	
Qëllimi 4: Krijimi i një mjedisi të pastër pa mbeturina			
Objektiva 4.1: Përfshirja e fshatrave/vendbanimeve të mbetura në sistemin e menaxhimit të mbeturinave deri në fund të 2021	Objektiva 4.2: Ndërtimi i stacionit transfer të mbeturinave deri në 2020	Objektiva 4.3: Eleminimi i gjitha deponive të egra 2021	

Objektiva 4.5: Ndërtimi i deponisë dhe impiantit për dekompostim të mbeturinave të biomasës deri në vitin 2030

3. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI		
Qëllimi 1: Zhvillimi I infrastrukturës dhe transportit të qëndrueshëm		
Objektiva 1.1: Modernizimi i rrugëve ndërlidhëse deri në vitin 2024	Objektiva 1.2: Ndërtimi i rrugëve të qytetit për zonat e reja të banimit sipas PRRH-ve të cilat do të hartohen deri në vitin 2027	Objektiva 1.3: Optimalizimi i rrugëve unazore (tranzitore) ekzistuese deri në vitin 2024
Qëllimi 2: Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe sigurimi i trasnportit publik		
Objektiva 2.1: Përmirësimi i transportit publik urbano- rural dhe sigurimi i transportit urban dhe deri në zonat turistike Brezovicë dhe qendren e re te skijimit deri në vitin 2023	Objektiva 2.2: Zhvillimi dhe zgjerimi i rrjetit të transportit të rregullt publik për të gjitha vendbanimet me mbi 450 banorë deri në vitin 2024	Objektiva 2.3: Ndërtimi i stacionit të autobusëve dhe sigurimi lokacioneve për venndalesa të autobusëve deri deri në vitin 2026
Qëllimi 3: Promovimi i lëvizshmërisë rekreative		
Objektiva 3.1: Në bashkpunim dhe bashkfinancim me nivelin qendror ndërtimi i teleferigut Përvall Brezovicë deri në vitin 2025	Objektiva 3.2: Ndërlidhja e zonave turistike përmes shtigjeve për çiklistë dhe kalërim gjatë verës deri në vitin 2027	

4. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE			
Qëllimi 1: Sigurimi i shërbimeve cilësore shëndetësore dhe mirëqenies sociale			
Objektiva 1.1: Përmirësimi i infrastrukturës dhe sigurimi i hapësirave dhe ndërtesave të reja për shërbim social deri në vitin 2024	**Objektiva 1.2:** Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore për 30% deri ne vitin 2022	**Objektiva 1.3:** Përmirësimi i infrastrukturës dhe sigurimi i hapësirave dhe ndërtesave të reja shëndetësore deri në vitin 2026	**Objektiva 1.4:** Përmbushja e kërkesave për banim social (në vazhdimësi)
Qëllimi 2: Ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor			
Objektiva 2.1: Ndërtimi i çerdheve dhe kopshteve të fëmijëve për disa vendbanimet rurale me mbi 2000 banorë deri në vitin 2024			
Qëllimi 3: Sigurimi i infrastrukturës së administratës efikase për shërbime administrative sa më afër banorëve			

Objektiva 3.1: Rinovimi i ndërtesës komunale deri në vitin 2021	**Objektiva 3.2:** Ndërtimi i zyrave të gjendjes civile në nënqendrat e planifikuara deri në vitin 2025

Qëllimi 4: Sigurimi i infrastrukturës sociale adekuate dhe mirëmbajtja e saj		
Objektiva 4.2: Krijimi i kushteve dhe sigurimi i infrastrukturës për sport dhe rekreacion në gjithë territorin e komunës (në vazhdimësi)	**Objektiva 4.3:** Përmirësimi i hapësirave ekzistuese dhe sigurimi i hapësirave të reja për sport dhe rekreacion nëpër shkolla deri në vitin 2026	**Objektiva 4.4:** Shtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në zonën urbane dhe nën-qendrat e komunës (në vazhdimësi)
Objektiva 5.5: Sigurimi i hapësirës për zgjerim të varrezave sipas asaj që është parapar në hartë deri në vitin 2025 dhe planifikimi/ lejimi i hapësirave për objekte të reja të religjionit (në vazhdimësi)		

6. MBROJTJA E MJEDISIT DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI		
Qëllimi 1: Parandalimi i ndotjes së ujërave		
Objektiva 1.1: Ndarja e rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferik në qytet në të gjitha vendbanimet me mbi 1500 banorë deri në vitin 2026	Objektiva 1.2: Hapja dhe rregullimin e shtretërve të Moravës, Mirushës, Stanishorkës deri në vitin 2024	Objektiva 1.3: Eliminimi i deponivë ilegale deri në vitin 2024
Qëllimi 2: Parandalimi i ndotjes së ajrit		
Objektiva 2.1: Planifikimi i hapësirave të gjelbra të reja në qytet deri në vitin 2021 dhe zhvillimi i hapësirave të gjelbra (në vazhdimësi)	Objektiva 2.2: Hartimi i Planit Lokal të Veprimit të Cilësisë së Ajrit deri në vitin 2021	Objektiva 2.3: Kufizimi i emetimit të substancave ajrore të dëmshme ose toksike nga veprimtaritë industriale deri në vitin 2023

Qëllimi 3: Parandalimi i rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera			
Objektiva 3.1: Ndërtimin e pendave për mbrojtje nga erozioni në shtretërit e përroskave dhe përrenjve dhe përmirësimin e argjinaturave mbrojtëse deri në vitin 2024	Objektiva 3.2: Ripyllëzim të 140ha për sipërfaqet pyjore përgjatë zonave erozive dhe shpatijet e diellosura, mbjellja e drunjtëve shtatlartë gjethembajtëse përgjatë perimetrit të zonave industriale deri në vitin 2022	Objektiva 3.3: Pastrimin e kanaleve të ujitjes dhe të kanalizimit atmosferik ekzistues deri në vitin 2022	Objektiva 3.4: Sigurim i qasjes së automjeteve të zjarrfikësve deri të zonë banimi dhe vendosja e hidrantëve në qytet dhe vendbanime në komunë deri në vitin 2026

7. ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE, KULTURORE DHE TURISTIKE

Qëllimi 1: Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe zhvillim i qëndrueshëm i trashëgimisë kulturore		
Objektiva 1.1: Restaurimi i tërësishëm i objekteve të trashëgimisë 2022	**Objektiva 1.2:** Ndërtimi i një objektit të Muzeut të Qytetit deri në vitin 2025	
Objektiva 1.5: Hartimi i Planit 25-vjeçar të Konservimit të Trashëgimisë Arkitekturale deri në vitin 2021		
Qëllimi 2: Zhvillim i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore		
Objektiva 2.1: Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmbajtjeve të zonave turistik në trekëndëshin në Brezovicë.	**Objektiva 2.2:** Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmbajtjeve të zonave për turizëm rural duke shfrytëzuar potencialet si kombinim i tokave pjellore rreth Lepencit dhe pjesëve kodrinore malore/ kombinim edhe me produktet blegtorale dhe përmbajtjet tjera deri në vitin 2023	**Objektiva 2.3:** Projekte për kampanja informuaes deri në vitin 2023.

8. VENDBANIMET		
Qëllimi 1: Zhvillimi i qytetit në vendbanim kompakt i balancuar		
Objektiva 1.1: Parandalimi i zgjerimit të pakontrolluar të qytetit jashtë kufirit urban deri në vitin 2020	**Objektiva 1.2:** Definimi i zonave për infrastrukturë publike dhe sociale për të gjitha zonat e reja të zhvillimit të ardhshëm në qytet deri në vitin 2024	**Objektiva 1.3:** Promovimi i shfrytëzimeve në pajtueshmëri (komerciale, rekreative, etj.) në lagjet ekzistuese dhe të rejat për të plotësuar nevojat e banorëve ekzistues dhe të ardhshëm deri në vitin 2020
Qëllimi 2: Mbrojtja e karakterit rural hapësinor dhe Planifikim për rritje të ekuilibruar të vendbanimeve rurale		
Objektiva 2.1: Promovimi i modelit ekzistues të zhvillimit rural duke përcaktuar zonat për zgjerim për të gjithë vendbanimet rurale deri në vitin 2020	**Objektiva 2.2:** Parandalimi i fragmentimit të tokave bujqësore me përcaktim të zonave bujqësore dhe pyjore deri në vitin 2020	**Objektiva 2.3:** Zvogëlimi i pabarazisë së shpërndarjes së infrastrukturës dhe shërbimeve publike ndërmjet Qytetit dhe vendbanimeve rurale, si dhe në mes të vendbanimeve rurale deri në vitin 2026

10. BANIMI
Qëllimi 1: Sigurimi i banimit për të plotësuar nevojat e banorëve të tanishëm dhe të ardhshëm

Objektiva 1.1: Sigurimi i tokës për të akomoduar fond ndërtimor prej 10000 mijë njësive të reja banimore në zonën urbane dhe 2500 njësive të reja banimi në zonën rurale deri në vitin 2020	**Objektiva 1.2:** Planifikimi për plotësimi i parcelave të pa-shfrytëzuara dhe inkurajimi i dendësimit ose rizhvillimit të tokës dhe ndërtesave në qytet dhe vendbanime rurale deri në vitin deri në vitin 2020	**Objektiva 1.2:** Hartimi i Hartës Zonale të Komunës deri në vitin 2020 dhe hartimi i Planeve Rregulluese të Hollësishme për zonën urbane deri në vitin 2024
Qëllimi 2: Sigurimi i banimit të përballueshëm		
Objektiva 1.1: Sigurimi që çdo 5 % nga numri i përgjithshëm i njësive të reja të banimit për vit të jenë me çmim të përballueshëm (në vazhdimësi)		

12. SHFRYTËZIMI I TOKËS		
Qëllimi 2: Shfrytëzim efikas i tokës dhe resurseve		
Objektiva 1.1: Përcaktimi i zonave të mbrojtura jashtë kufijve të zonave për zgjerim deri në vitin 2020	**Objektiva 1.2:** Përcaktimi i zonave për revitalizimit urban dhe shfrytëzimit të përzier të tokës deri në vitin 2022	**Objektiva 1.2:** Përcaktimi i zonave të banimit ndaras nga zonat me shfrytëzim jo të përshtatshëm me banimin deri në vitin 2023

7. HISTORIKU I PLANEVE DHE ANALIZË E SITUATËS EKZISTUESE NË FUSHËN E MJEDISIT DHE TË PLANIFIKIMIT

Në kuadër të planeve në Komunën e Shtërpcës ka patur disa studime në fushën e mjedisit dhe dhe planifikimit hapësinorë si: Plani Hapësinor Parkut Nacional "Mali Sharr", Master Plani për qendrën turistike Brezovic. Janë bërë edhe studime në fushën e Florës dhe Vegjetcionit si dhe studime tjera për faunën dhe studime për karakteristikat gjeologjike të Malit Sharr nga ekipe të ndryshme nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës të Universiteti të Prishtinës, nga Institute të ndryshme për hulumtime shkencore etj.

Duhet then se koha pas luftës dhe administrimi jo adekuat i Parkut Nacional dhe hapësirave tjera në territorin e komunës së Shtërpcës kohëve të fundit kanë filluar edhe ndërtime pa kontrollë dhe ndërtime të cilat nuk janë kompatibil me mjedisin.

Ky proces krijoi premisën e influencimit të zhvillimit nga interesi individual privat në krahasim me „interesit kolektiv" sidomos kur ky interes në thelb përbënte interesin e askujt.

Ndërsa parcelizimi apo fragmentarizimi i tokës vetvetiu çoi dhe në fragmentarizimin e intersave për zhvillimi cili stimuloi modelin sipas të cilit synohet të maksimalizohet përfitimi prej secilës parcele pa marrë në konsideratë bashkëpunimin ndërmjet këtyre parcelave.

7.1 Problematika të Zhvillimit dhe Planifikimit komunal në Shtërpcës

Zhvillimi komunal

Komuna e Shtërpcës sot vuan një seri problemesh që rrjedhin nga një mungesë planifikimi konsistent ndër vite. Komuna e Shtërpcës vuan një zhvillim të pabalancuar hapësinor. Me të vërtë nuk është arritur që të koordinohen politika për zhvillimin e vendbanimeve komunale por edhe në rajon. Për këtë shkak se politikat urbanizuese kanë qenë jo efikase. Nëse Komuna e Shtërpcës ka përjetuar një intensifikim të pjesës ekzistuese të disa vendbanimeve, Komuna ka përjetuar dhe fenomenin e shpërnguljeve të mdha. Zhvillimi i pjesëve të mëdha të kësaj komune ka qenë spontan.

Në vitet e fundit disa vendbanime në Komunën e Shtërpcës kan humbur përmbajtjet e vendbanimeve funksionale. Për shkak se zhvillimet kanë theksuar vetëm dimensionin ndërtimor, është humbur në sigurimin e hapsirave të nevojshme për funksione publike. Githashtu kjo ka ndikuar për keq edhe në organizimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike.


Vetë sektori i ndërtimit përballet me vështirësitë e veta. Në këtë kuadër mungon raporti dhe partneriteti midis sektorit privat dhe atij publik në realizimin e projekteve të konsoliduara, të qëndrueshme dhe cilësore që do bëntë të mundur realizimin e projekteve në kompleksitetin e tyre si dhe do rriste siguronë e realizimit të projekteve.

7.2 Projeksionet sipas Vendbanimeve

Komuna e Shtërpcës është ndarë për efekt administrimi në 15 zona kadastrale dhe 16 Venbanime me sipërfaqe pre 247.60 km^2. Nga pikpamja e trendeve demografike vetëm Sevca, Shtërpca, Firaja dhe Brodi kanë shenuar trende pozitive viteve të fundit dhe dendësiae popullatës është edhe në kto vendbanime mesatare, vlenë të ceket edhe një shpërndarje jo balancuar e popullësisë në komunën e Shtërpcës.

PZHK-ja ka paraqitur shpërndarjen sipas numrit të popullsisë për secilin vendbanim duke u kujdesur që në të ardhmen të krijohet një „linje“ e shpërndarjes së popullatës në konceptin policentrik.

Duke marr parasysh disa parametra edhe demografik edhe fizik, ekonomik por edhe mjedisor jan propozuar kufijt e rij ndërtimor për të gjitha vendbanimet.



Harta.15. Vendbanimet e Shterpcë

Tab.17. Krahasimi i kufinjve ndërtimor ekzistues dhe të plkanifikuar

Emri i Fshatrave	Kufijt e Ekzistues ndërtimor në *ha*	Kufijt e planifikuar ndërtimor Në *ha*
Brod	58.18	97.1
Viça	15.28	25.85
Drajkoc	63.11	121.11
Berefci	23.3	27.12
Gotovusha	29.03	28.79
Vërbeshtica	89.41	108.97
Shtërpca	93.94	101.88
Sevcë	56.17	66.19
Kashtanjeva	18.26	14.51
Izhanci	15.01	5.15
Sushiqi	6.15	10.34
Bitija e Epërme	44.01	32.96
Bitija e Poshtme	23.59	20.56
Jazhinca	35.18	41.88
Totali	**570.62**	**702.41**


Nga shënimet e lartë shkruara shifet qartë se në kuptimin e zgjërimit të zonës ndërtimore për 10+ vite janë paraparë 702.41 ha që do të thotë një tregues për zënjen e tokës prej 131.79 ha dhe shtrirja është e planifikuar me PZHK drejtë tokës me plleshmër më të dobët.

7.3 Zhvillimi Ekonomik

Zhvillimet dramatike sidomos me luften në Kosovë por edhe ato politike e social-ekonomike të pas luftës, reflektohen në tendencat zhvillimore të vendit në të gjitha drejtimet:

Aktualisht nga analiza të kryera nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për komunën e Shtërpcës dhe Grupi punues për zhvillim ekonomik u konsiderua se fusha kryesore e cila mundë të zvogloj numrin e migrimeve nga Shtërpcës por edhe krijoj kushte për të punuar dhe jetuar është planifikimi i zonave të zhvillimit ekonomik të shprehura në PZHK me harten e turizmit, bujqësisë transportit, pasurive minerare dhe aspekteve e potencialeve tjera të zhvillimit.

Disa mundësi të planifikuara të zhvillimit ekonomik janë prezantuar në harten e më poshtme marrë nga PZHK e Shtërpcës.



Harta.16. Shtrirja hapësinore e bizneseve dhe zhvillimi ekonomik

7.4 Koncepti i zhvillimit hapësinor

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor i komunës së Shtërpcës është mjaft i bazuar duke filluar nga profili, vlerësimi i gjendjës, analiza, Vizioni, Qëllimet, Objektivat, si dhe ka marr parasysh dhe ka reflektuar dokumente dhe strategji planifikimi të nivelit komunal dhe qendror.

Komuna e Shtërpcës në bashkëpunim me të gjithë aktorët në fushën e planifikimit ka pas për qëllim që ky Koncept i Zhvillimit Hapësinor të jetë i strukturuar mirë, dhe të përmbajë të dhëna të mjaftueshme që të mund të kuptohet si i vetëm. Në ketë drejtim Ekipi i angazhuar nga komuna e Shtërpcës si dhe kompania "INSI" dhe ekipet tjera të angazhuara jashtë komunës kanë punuar bazuar në kërkesat e parapara me ligj, udhëzime administrative, normave teknike, si dhe struktura e përmbajtjet si nyejt,korridoret dhe përmbajtjet tjera e bëjnë këtë koncept lehtë dhe i kuptueshëm.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor krijon bazën e zhvillimit dhe të shfrytëzimit të tokës gjatë procesit të vendim marrjes dhe do të shfrytëzohet gjatë hartimit të kushteve zhvillimore të Hartës Zonale të Komunës të Shtërpcës.

Shtërpca duhet të rritet në mënyrë të qëndrueshme, duke planifikuar zhvillim të zonave të banimit, industriale, rekreative turistike (qendrat e Skijimit) që të jenë pozitive për mjedisin, ekonominë dhe mirëqenien e popullsisë, sot dhe në të ardhmen. PZhK duhet të siguroj zhvillim të balancuar ashtu që zhvillimet ekonomike nuk janë në konflikt (kanë efekte negative) me fushat tjera siç janë: mjedisi, shëndeti dhe siguria e popullatës.

Komunës së Shtërpcës i nevojitet rritje dhe zhvillim mirë i planifikuar, duke krijuar kushte për zhvillim të jetë **zhvillim i qëndrueshëm.**

SKENARËT E PROPOZUAR HAPËSINOR

Përgatitja e skenarëve hapësinor është një metodë e planifikimit strategjik, me qëllim të analizimit të zhvillimeve të mundshme në të ardhmen. Këtu përfshihen situatat e ardhshme alternative dhe drejtimet që mund të ndihmojnë në realizim. Skenarët bazohen në pasojat hipotetike të vendimeve dhe veprimeve të mundshme për vetëdijesimin lidhur me proceset kauzale.

Përveç se paraqiten mundësitë e shfaqjes së një situate hipotetike në të ardhmen, janë paraqitur edhe variacione dhe alternativa.

Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Shtërpcës e kanë analizuar nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor konceptin e PZHK-së së përmes Skenarit, si bazë e mundshme të zhvillimit hapësinor të vendbanimeve.

Në kuadër të skenarëve të propozuar, nën supozimin e një mjedisi me zhvillim jostabil, janë marr parasysh aspektet pozitive dhe negative për zhvillim. Prandaj, duhet të analizohen faktorët relevantë, të cilët kanë ndikim kryesor në zhvillim.

SKENARI I - SKENARI I CILI KA ELEMENTE NGA PZHK E KALUAR

Skenari është analizuar në rrafshin hapësinor, politik dhe social dhe është diskutuar me shoqërinë civile, dhe duke marr parasysh gjendjen faktike në komunë dhe zhvillimet që kanë ndodhur në territorin e komunës së Shtërpcës por dhe të gjitha implikimet hapësinore që reflektojnë gjendjen në aspektin ekonomik, social dhe mjedisor, si:

- Zhvillimi është i ndarë në mes qytetit të Shtërpcës dhe fshatrave më të mëdhenj të komunës

- Fshatrat e mëdha i furnizojnë fshatrat e tjera me shërbime institucionale, infrastrukturë teknike, publike dhe sociale
- Qendra e re e skijimit.

Ky model është i bazuar në konkluzionet nga analiza faktike në planet hapësinore të veprimit, si dhe i tregon bazat kualitative në lidhje me zhvillimet hapësinore të komunës. Pikat kryesore në vijim nga bazat e modelit të zhvillimit hapësinor:

Qytetza e Shtërpcës është qendër komunale, me funksione të përqendruara në qytet. Shumica e tokës për banim dhe për shfrytëzim komercial, gjithashtu është e përqendruar në qytezë.

Fshatrat të cilat janë identifikuar të zhvillohen si qendra policentrite dytësore janë: Sevca dhe Brodi.

Këto qendrat dytësore janë përzgjedhur me qëllim të furnizimit të fshatrave përreth me infrastrukturë publike dhe private në bazë të këtyre kritereve:

- Partneritetit urbano– rural, numri i popullsisë, institucionet dhe infrastruktura ekzistuese, potencialet zhvillimore, shtrirja gjeografike, dhe trendët e rritjes, etj.

Disa funksione bazike publike shoqërore, si për shembull, shkollat e mesme, qendrat e mjekësisë familjare dhe zyrat komunale janë të vendosura aty. Për ta përforcuar rritjen e qendrave dytësore, gjithashtu atyre iu është ofruar tokë ndërtimore për banim dhe përdorim komercial.

Sjellja e natyrës në qendër të qytetit.

Për ta përmirësuar klimën lokale në Shtërpc dhe për ta lidhur pjesën e brendshme të qytetit me fshatrat përreth, janë propozuar korridore të gjelbra përmes qytetit rreth lumit Lepenc. Kjo është e mundur, e zbatueshme, sepse korridoret komunikojnë me lumenjtë që rrjedhin përmes zonës urbane. Në këto raste, këto zgjidhje do të shërbejnë gjithashtu për qëllim të mbrojtjes nga ndotja e ujit të lumenjve.


Mbrojtja e trashëgimisë natyrore

Për shkak të vlerave të mdha që kanë malet e Shtërpcës pjesa më e madhe e tyre janë pjesë e parkut nacional "Mali Sharr". Këto pjesë të komunës janë zona parësore për mbrojtjen e natyrës dhe për rivitalizim natyror. Lumenjtë që kalojnë përgjatë komunës kanë të definuar zonat mbrojtëse të tyre.

Mundësia e hyrjes në tërë komunën

Rruga rajonale kalojnë përmes zonave më të dendura banuese të komunës dhe formojnë shtyllën kurrizore të sistemit rrugor. Qendrat dytësore, janë të lidhura me këtë sistem kryesor. Rruga lokale që kalon përgjatë luginës së Lepencit, ka përfituar prioritet të lartë. Për ta përmirësuar rrjedhën e trafikut përreth Shtërpcës dhe për ta ndihmuar brendinë e qytetit nga trafiku, janë propozuar disa rrugë alternative.

Një rrjet i zhvilluar i rrugëve dhe i transportit publik do ta rrisë mundësinë e lëvizjes së lirë të banorëve për t'i ndihmuar fshatrat dhe për ta ngritur linjën vepruese për institucione shoqërore, siç janë shkollat dhe kujdesi shëndetësor. Sistemi kryesor rrugor duhet të plotësohet me rrjetin e rrugëve lokale.



Harta .17. Skenari i parë i propozuar

SKENARI 2 - SKENARI I ZHVILLIMIT MONOCENTRIK HAPËSINOR

Ky skenar propozon zhvillimin e qendrës urbane të Shtërpcës duke e krijuar një tërësi urban si zhvillim monocentrik, d.m.th qendra komunale duhet te orientohet e ndërtohet fuqishëm me të gjitha elementet e strukturës urbane komplete. Ajo do të siguroj mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet që i përgjigjen urbanizimit të qëndrueshëm, Në ketë kohë, në nivel global më shumë se gjysma e botës jeton në zonën urbane, është shumë normale zhvillimi i një skenari të tillë edhe për komunën e Shtërpcës.

Ky skenarë përmban edhe përmbajtjet zhvillimore të komunës si zonat për **Rekreacion dhe turizmi** dy zona si qendra të skijimit njëra ekzistuese ajo e Brezovicës, kurse tjetra e propozuar, si dhe Parku Nacional "Mali Sharr" janë me rëndësi të veçantë dhe janë propozuar të zhvillohen qendra për turizëm dhe rekreacion jo vetëm për komunën e Shtërpcës por edhe për Kosovën dhe më gjerë.

Këto qendra trajtohen si përmbajtje të konceptit kryesorë, sidomos për turizëm rekreativ-sportiv dhe malor.

Si përmbajtje tjera që janë pjesë me rëndësi për konceptin janë: Zonat e Mbrojtura, korridori zhvillimor dhe agroturizmi.

Për **NYJET** si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky skenar bazohet në zhvillimin monocentrik me vetëm një nyje kryesore e konsideron të rëndësishme, qytetin e Shtërpcës, ky skenar propozon zhvillimin e qendrës urbane të Shtërpcës, duke e krijuar një tërësi urban si zhvillim monocentrik, ndërsa nyejt tjera ekzistues nuk do trajtohen me prioritet por do mbahen në kufijtë aktual.


Për **KORRIDORET** si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky s**kenar** bazohet aksin që fillon në Shtërpc dhe vazhdon përgjat rrugës rajonale në drejtim të Brodit, kurse në anën tjetër vazhdon nga Shtërpca në drejtim të qendrës turistike të Përvallës dhe Prizerenit. Është një korridor zhvillimorë mjaft i rëndësishëm gjithashtu, kemi edhe tendenca korridoresh në të gjitha drejtimet të qendrës turistike Brezovicë.

Në lidhje me **PLOTËSIMIN DHE DENDËSIMIN**, Skenari 2 ofron vetëm plotësimin dhe dendësimin vetëm në zonën (monocentrike) urbane, të definuar si më lartë si pjesë kryesore e konceptit, por plotësim dhe dendësim do të ketë edhe në zonat tjera rurale.

Në lidhje me **MBAJTJEN NËN KONTROLL**, Skenari 2 synon mbajtjen në kontroll të gjithë kufijve të definuar ndërtimor qoftë zonës urbane qoftë vendbanimeve rurale, e sidomos në zonat rurale ku jetojnë një përqindje më e vogël e banorëve, duke mos lejuar shtrirje të reja, dhe intensitet të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtim.

Në lidhje me **MBROJTJEN**, Skenari 2 mbron tokë bujqësore, mirëpo në anën tjetër synon edhe mbrojtjen e pasurive tjera qoftë nëntokësore, qoftë sipërfaqësore, për tu shfrytëzuar ose marrë masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjate.

Në lidhje me **ZONAT E RRITJES,** Skenari 2 ofron ri-zhvillim të zonave ekzistuese në intensitetet më të larta, vetëm në një zonë të rritjes edhe atë në qytetin e Shtërpcës, por edhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës pa anashkaluar edhe korridoret në drejtim të Ferizajt dhe Prizerenit.



Harta .18. Skenari i dytë i propozuar

SKENARI 3 - SKENARI I ZHVILLIMIT POLICENTRIK HAPËSINOR

Zhvillimi policentrit bazohet në koncentrim të zhvillimit në nyje të paracaktuara. Ky skenar propozon formimin e 4 nyejve kryesore, qytetin e Shtërpcës dhe tri nënqendra, dy qendra të skijimit dhe një qendër e agroturizmit, të cilat i furnizojnë fshatrat tjera me shërbime institucionale, infrastrukturë teknike dhe sociale.

Ky skenar propozon zhvillimin e qendrës urbane të Shtërpcës dhe tri nën-qendrave, duke e krijuar një tërësi urban, e cila duhet te orientohet e ndërtohet fuqishëm me të gjitha elementet e strukturës urbane komplete. Ajo do të siguroj mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet që i përgjigjen urbanizimit të qëndrueshëm. Në ketë kohë, në nivel global më shumë se gjysma e botës jeton në zonën urbane, edhe në Shtërpc diku rreth 60 % e popullsisë jetojnë në zonën urbane, është shumë normale zhvillimi i një skenari të tillë edhe për komunën e Shtërpcës, por ky skenar ofron edhe zhvillimin e tri nën-qendrave që synon sado pak një qëndrueshmëri hapësinore dhe funksionale, tri nën-qendrat janë Brodi, Vërbeshtica dhe Bitija e Poshtme.

Ky skenar përmban edhe përmbajtjet zhvillimore të komunës si zonat për rekreacion dhe turizmi Qendra e skijimit Brezovica dhe qendra e re e skijimit e propozuar, edhe Kashtanjeva propozohet si zonë për zhvillim të agroturizmit.

Për **NYJET** si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky s**kenar** bazohet në zhvillimin disa nyejve që konsideron të rëndësishme, qytetin e Shtërpcës. Ky skenar propozon zhvillimin e qendrës urbane të Shtërpcës duke e krijuar një tërësi urban, Nyje tjetër e rëndësishme është Brodi, Bitija e Poshtme dhe Vërbeshtica, ndërsa nyejt tjera ekzistues do trajtohen mjaftueshëm brenda kufijve aktual.


Për **KORRIDORET** si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky s**kenar** bazohet aksin që fillon në Shtërpc si dhe **Korridor i rëndësishëm, Korridori n**ga Shtërpca, në drejtim të Ferizajt deri te zona kadastrale e Brodit, është një korridor zhvillimorë mjaft i rëndësishëm gjithashtu, kemi edhe korridorin nga Shtërpca deri në Përvall, por edhe tendenca e korridorit në drejtim të Brezovicës qendrës së skijimit.

-Në lidhje me **PLOTËSIMIN DHE DENDËSIMIN**, Skenari 3 ofron plotësimin dhe dendësimin në zonën urbane, Brod, Vërbeshticë dhe Biti e Poshtme të definuar si më lartë si pjesë e konceptit ku synohet zhvillimi kompakt, por plotësim dhe dendësim do të ketë edhe në zonat tjera rurale.

-Në lidhje me **MBAJTJEN NËN KONTROLL**, Skenari 3 synon mbajtjen në kontroll të gjithë kufijve të definuar ndërtimor qoftë zonës urbane qoftë vendbanimeve rurale, e sidomos në zonat rurale ku jetojnë një përqindje më e vogël e banorëve, duke mos lejuar shtrirje të reja, dhe intensitet të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtim.

-Në lidhje me **MBROJTJEN**, Skenari 3 mbron tokë bujqësore, mirëpo në anën tjetër synon edhe mbrojtjen e pasurive tjera qoftë nëntokësore, qoftë sipërfaqësore, për tu shfrytëzuar ose marrë masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjate.

-Në lidhje me **ZONAT E RRITJES,** Skenari 3 ofron rizhvillim të zonave ekzistuese në intensitetet më të larta, në zonën e rritjes edhe atë në qytetin e Shtërpcës, por edhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës edhe pjesëve tjera të kësaj komune, duke e krijuar një tërësi urban, por edhe në Kashtanjevë si zonë për zhvillim të agroturizmit.




Harta. 19. Skenari i tretë i propozuar

7.5 Plani i Shfrytzimit të Tokës

PZHK-së sugjeron një koncpet për përodorimin e tokës në nivelin komunal. Plani sugjeron gjenerimin e konceptit të një kufijve të definuar. Pra sugjerohet përmbajtja e ndërtimit dhe kompaktësimi i vendbanimeve sa më shumë në kufijtë ekzistues duke ofruar edhe hapsirën për ndërtim në vendbanimet me presion zhvillimi në kuptimin e ndërtimeve. Gjithasht vrehet se sugjerohet edhe mbrojtjen dhe zhvillimin e hapsirave ekzistuese dhe definim i hapsirave për shfrytzime tjera të nevojshme me qëllim zhvillimi, mbrojtje ose edhe avancimi. Shih harten e më poshtme marr nga PZHK Plani shifet se ka synuar të identifikojë edhe disa skema zhvillimi të tokës urbane në zbatim të Planeve të niveleve më të ulta. Këto skema synojnë:


- Stimulimin e projekteve të konsoliduara që përmbajnë edhe shërbimet e nevojshme publike
- Ndërtimin e një formule menaxhimi të trajtimit të pronës
- Ndërtimin infrastrukturës së duhur për të ndërtuar partneritete midis sektorit privat dhe atij publik.



Harta.20. Destinimi i sipërfaqeve

7.6 Rrjeti Rrugor dhe Transporti Publik

PZHK-së ka propozime konkrete për rrjetin rrugor. Plani sugjeron ndërtimin e një sistemi funksional rrugor duke u propozuar fuqizim të akseve ekzistuese të niveleve të ndryshme të rrugëve dhe hapje të akseve të reja rrugore. PZHK-së sugjeron një sistemi sa më të integruar të transporti. Ky system parashikon edhe ndërtimin e një sistemi transporti publik sidomos bazuar në sistemin e autobuzëve, tramvajeve dhe teleferigut. Ky system transporti synon adresimin e flukseve tradicionale të lëvizjes. Po skema e transportit reflekton gjithashtu edhe planin e përdorimit të tokës.



Harta.21. Infrastruktura Rrugore

8. KONSIDERATA MBI ALTERNATIVAT E KONCEPTIT TË SHPËRNDARJES HAPËSINORE NË KOMUNËN E SHTËRPCËS

Gjatë hartimit të PZHK-së janë konsideruar tre skenarë potencialë hapësinor – Centrik (me një qendër zhvillimi Shtërpces), Skenari i zhvillimit koridoreve zhvillimore dhe ajë policentrik me dy pika (me shumë qendra). Skenari i Centrik bazohet në propozimin e zhvillimit të një qendre të fortë administrative dhe funksionale, por nuk është realist në atë që realizimi i tij do të kërkonte kufizimin dhe heqjen e shumicës së zhvillimeve në vendbanime me trende pozitive zhvillimi. Duke pasur parasysh përdorimin aktual të tokës dhe dendësinë në Shtërpc, ky skenar, siç thotë raporti, është i parealizueshëm. Skenari i koridoreve, reflekton tendencat ekzistuese ku zhvillimet tentojnë të jenë përgjatë rrugëve. Është fjala për skenarin e "të mos bërit asgjë". Skenari i tretë propozon ruajtjen e Shtërpcës si qendrën kryesore urbane, por duke zhvilluar gjithashtu edhe nyje të tjera urbane për të siguruar shërbime më të afërta e minimizuar udhëtimin në këto zona e madje edhe në vendet e punësimit. Në këto raporte bëhet krahasimi i këtyre skenarëve dhe vlerësimi i tyre, në bazë kriteresh të ndryshme, tregohet në figurën më poshtë.

Tab.18. Vlerësimii skenareve të PZHK-së.

Skenariet / Vlersimet	Skenari i kaluar	Centrik	policentrik Përfundimtar
Realizueshmëria ekonomike dhe institucionale	++	+ + +	++ +
Ndikimet mjedisore	+	- -	+ +
Ndikimet sociale	+	- - -	+ +
Realizueshmëria politike	+	+ +	+
Konkluzioni	I paaritshëm	I papranueshëm	I realizueshëm

Figura: Krahasim tre Skenarëve të Zhvillimit

Ky vlerësim tregon qartë se skenari i poli-centrik me katër nënqendra është i diferencuar nga të tjerët për përparësitë e tij. Megjithatë mënyra e vlersimit të skenarëve në PZHK-së jepë hapsirë për hulumtime edhe më të thella për mënyrën se si janë vlerësuar këto kritere.

Alternativa e Centrike dhe ajo poli-centrik janë pak a shumë të ngjashme për nga këndvështrimi mjedisor. Përparësia tjetër kryesore e alternativës së Centrike dhe asaj poli-centrike është se sigurimi i infrastrukturës është shumë më efektive nga pikëpamja e kostos, gjë që, sërish, është në ndihmë të mjedisit.

Tabela: 19. Krahasimi Mjedisor i Skenarëve Kriteret Centrik I korridoreve Poli-centrik

Kriteret	*Centrik*	*I Koridoreve*	*Policentrik*
Çështje të mjedisit			
Hapësira të gjelbërta ekzistuese në përgjithësi	+	- -	-
Hapësira të gjelbërta Vendbanime	- -	+	O
Trupa ujore	O	+	+
Cilësia e Ajrit	- -	- - -	+
Mikro-klima	- -	+	O
Biodiversiteti / Ekologjia	+	- -	O
Përdorimi i burimeve (ujore)	O	O	O
Turizmi	+	- - -	++
Transporti dhe automjetet	+	- - -	++
Ruajtja e trashëgimisë	+	+	++
Totali mjedisor	**-1**	**-11**	**-1**
+ mirë; - keq; O pa ndryshim			

8.1 Shkalla që PZHK-ja Ndikon në Planet e Tjera

PZHK-ja vlerësohet të ketë pasur një vështrim të plotë të planeve të ndryshme të cilat janë zhvilluar në nivel të Kosovës ose Planeve dhe Projekteve të cilat janë bërë më herët në Komunën e Shtërpcës (Plani P.N. "Mali Sharr", Master Plani i qendrës Turistike si dhe strategjive për nivelin e Shtërpcës, edhe se për nivelin komunal dhe urban kanë eksistuar draft plane të cilat nuk kanë qenë të përgatitura sipas ligjeve të Republikës së Kosovës. Kurse për zonën urbane kanë ekzistuar plane detajizuese, si dhe plani i qendrës së skijimit. Të gjitha këto plane janë marrë në shqyrtim dhe vlerësohet se gjendja në terren ka ndryshuar.

Megjithë qasjen, pak a shumë, të fragmentuar dhe diferencat institucionale në procesin e planifikimit, ekziston një aspekt rastësor pozitiv. Topografia e Shtërpcës kufizon nëmënyrë substanciale drejtimet e shtrirjes së vendbanimeve dhe të planifikimit infrastrukturor.

9. KUSHTET TJERA MJEDISORE TË KOMUNËS SË SHTËRPCËS

Disa nga aspekte Kryesore të Gjendjes Aktuale Mjedisore

Të dhënat më poshtë i referohen gjëndjes mjedisore të tanishme në komunën e Shtërpcës. Qëllimi kryesor i diskutimit të të dhënave bazë është të identifikojë gjëndjen mjedisore në ballafaqim me vizionin, prioritetet dhenefektet e dëshiruara të zhvillimit dhe implementimit të planit zhvillimor komunal të komunës së Shtërpcës. Impaktet potenciale të zhvillimit të PZHK-së mund të vlerësohen nga ndryshueshmëria e kushteve mjedisore me ose pa implementimin e Planit nëpërmjet indikatorëve të gjendur/të supozuar sasiorë ose cilësorë. Esencialisht, gjëndja mjedisore e komunën e Shtërpcës karakterizohet nga përshkrimi i receptorve mjedisore, siç kërkohet nga Direktiva e VSM, të përshkruara më poshtë:

- Popullsia dhe Shëndeti (human);
- Biodiversiteti, Flora dhe Fauna;
-Zonat e mbrojtura natyrore;
- Ajri (cilësia mjedisore dhe zhurmat);
- Faktorët kilamtikë;
- Uji;
- Toka dhe peisazhi;
- Asete materiale/Infrastruktura fizike (transporti dhe administrimi mbetjeve);
- Trashëgimia kulturore (duke përfshirë trashëgiminë arkiteturale dhe arkeologjike)

9.1 Popullsia dhe Shëndeti

Territori i komunës së Shtërpcës zë një hapësirë prej afro 247.60 km^2 dhe ka një popullsi prej gati 13,900[3] banorë dhe dendësi mesatare prej 56 banorë/km^2 dhe është thuajse totalisht rurale.

Popullsia e disa vendbanimeve sidomos ato afër rrugve vazhdon të rritet me ritme më te larta të, ndonëse në përgjithësi komuna njeh trende të ramjes së popullsisë që nga viti 1981 kur shenoj një rritje më të madhe deri më tani.

Ritmet e ramjës së popullsisë së Shtërpcës vijnë jo nga ramja natyrore e popullsisë sepse këtu kemi trende pozitive, por nga migrimet e vazhdueshme te popullsise nga zonat rurale drejt qendrave urbane të medha.

Për shkak të kushteve të jetesës vërehet se familjet e reja, përgjithësisht, tentojnë të vendosen në disa vendbanime si Shtërpcë, Ferizaj, Kaçanik etj., gjë që kërkon përmirësime të rëndesishme infrastrukturore në to, më shumë energji, ujë, rrugë, shkolla, kopështe.

9.2 Shëndeti

Ndikimet në shëndetin e banorëve relevante për VSM, janë ato të cilat lindin si pasojë e bashkëveprimit me receptorët mjedisorë (komponente mjedisore të tilla si ajëri, uji apo tokë nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial nëpërmjet transportit në ujë dhe kontaktit më njerëzit. Kapaciteti mjedisor i komunës do të thotë, para së gjithash, ruajtja në nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisorë. Dëndësia e popullsisë në disa vendbanime, zhvillimi pa plan i tyre, ulja e hapsirave publike rekreative dhe sidomos të gjelbërta sjell pa dyshim uljen e cilësisë së jetës, perkeqesimin e parametrave mjedisorë të pranuar si

[3] ASK

standarde, shpenzime të larta të shoqërisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime me të larta për mbrojtjen e shëndetit.
Ne komunën e Shtërpcës, shërbimi shëndetësor parësor ofrohet nëpërmjet QKMF dhe QMF.

9.3 Çeshtje Ekzistuese Mjedisore të Lidhura me Popullsine dhe Shëndetin

Një gamë çështjesh, si më poshtë, janë identifikuar që janë të lidhura për shëndetin në tërësi:

- Zonat e mbrojtura natyrore brenda PN "Mali Pharr".
- Mbrojtja e Vegjetacioneve autoktone,
- Mbrojtja e zonave të llojeve bimore endemike;
- Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit;
- Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në vendbanimet me densitet të lartë;
- Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave;
- Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga shërbime dhe facilitetet të tjera komunale në disa vendbanime të komunës ;
- Raportet ndërtimore me siperfaqet e gjelbërta duhet të parashikojnë densitetin e popullsisë;
- Sipërfaqet aktuale të gjelbërta dhe parqet duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen;
- Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore të pellgut.
- Ndertimi/rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujrave te zeza si dhe manaxhimi i mbetjeve.

9.4 Mjedisi Fizik

Veçori Natyrore Kryesore të Komunës dhe Zonat që Ndikohen

Sa i përket shtrirjes së komunës së Shtërpcës dhe vendbanimeve të saja dhe disa prej informatave kryesore gjeografike kemi folur më lartë.

Me zgjerimin e disa vendbanimeve janë të njohura edhe disa përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Zhvillime dhe ndërtimet edhe në disa zona sensivitet mjedisor, gjeomorfologjik dhe gjeologjik.zhvillimet dhe Ndërtimet në këto zona janë potencialisht të kërcënuara. Një pjesë e mirë e habitateve janë po ashtu të kërcenuara për pasojë të ndryshimit të sipërfaqeve të gjelbërta.

Ky ndryshim në përdorimin e tokës ilustrohet në disa nga shifrat që mundë të jenë në dispozicion edhe se të pakta, ku tregohet shfrytzimi i tokës në vitet e më hershme dhe tani (shih tabelen e shfrytëzimit të tokës). Shumfishimi i disa zonave ndërtimi ka ndodhur në kurriz të toke bujqësore, të zhdukjes disa pyjeve me pemë me gjethe, dhe ka shkaktuar zvogëlimin e një tërsie pejsazhesh e gjelbrimi.

9.5 Zonimi i territorit të komunës së Shtërpcës

Bazuar në veçanti si koha e zhvillimit, tipologjia e vendbanimeve,arkitekturat, popullsitë, infrastrukturat shoqëruese, gjeomorfologjitë dhe sidomos çështjet mjedisore që mund të paraqesin komunën e Shtërpcës me PZHK jan trajtuar si më poshtë:
Zonat e ndërtimit në vendbanime:

- Zonat e zhvilluara me ndërtim:

PZHK me kujdes ka identifikuar dhe trajtuar zonat ku është duke u zhvilluar ndërtimi sot nëpër vendbanime siç shihet edhe nga harta e vendbanimeve në PZHK.

- Zonat e pazhvilluara me ndërtim:

PZHK-ja me kujdes ka identifikuar dhe trajtuar duke u bazuar në trendet demografike, informatat e plleshmëris së tokës pasurive nën e mbitoksore dhe informatat mjedisore edhe zonat ku mundë ndërtohet në të ardhmen nëpër vendbanime siç shihet edhe nga harta e vendbanimeve të planifikuara në PZHK.

- Zonat turistike

PZHK ka identifikuar zonat turistike për të gjithë llojet e turizmit të mundëshëm në komunën e Shtërpcës së prezantuar në harten e turizmit.

Zona të Mbrojtura

PZHK-ja ka evidentuar gjithashtu zonën ku përfshihen zonat karakteristike me vlera të trashëgimis kulturore - historike, peisazhike, mjedisore e turistike të Komunës. Në këto zona nuk mund të jepen leje ndërtimi për objekte e struktura, të cilat cënojnë identitetin e zonës. Objektet ekzistuese të zonës mund të restaurohen vetëm në kushte të cilat i japin institucionet kompetente, duke mos cënuar identitetin e tyre (Zonat e veçanta te mbrojtur, PN Mali Sharr gjegjësisht Zonat e Mbrojtura brenda Parkut, dhe disa zona që shpellën të interesit komunal me PZHK).

Zona Industiale dhe zonat për zhvillime industriale

Përgjithësisht zona industrial planifikohet të jetë ndërkomunale dhe do zhvillohet afër Shtërpcës në një teren me cilësi jo të plleshme të tokës dhe që nuk bie në konflikt me interesa tjera socio-ekonomike dhe mjedisore dhe zhvillimet industriale që janë identifikuar dhe trajtuar me PZHK dhe propozuar masat mjedisore.

Pyllzimi, Zhvillimi i Pyjeve, Zonat e Gjelbërta dhe të Pushimit

Zhvillimet në Shtërpcës nuk është shoqëruar edhe me zhvillimin e pyjeve, pyje të reja, krijimin e zonave rekreative. Në të vërtetë, shumë nga zonat pyjore, hapsirave të blerta dhe hapësirat rekreative janë cenuar deri te shkalla e zhdukjes si pasojë prerjeve ilegale, djegjeve, zhvillimeve tjera dhe neglizhencës. Hapësira pyjore dhe masat janë planifikuar në PZHK. Deri tanishumë pak është bërë për zonat lokale rekreative apo hapësirat ku mund "të dilet për të pushuar" në vendbanime. Kohët e fundit bërë përpjekje për të përmirësuar gjendjen në komunë dhe rifituar hapësirat pyjore,zhvillim të pyjeve ekzistuese dhe hapsira tjera të blerta në vendbanime. Në PZHK dy objektiva janë esenciale:

(I) Rritja e hapsirave të gjelberta dhe

(II) Sigurimi i koridoreve jeshilë që do të zhvillohen të bashkëshoqëruara me ndërtimin e rrugve të reja dhe atyre ekzistuese,korsive për këmbësorët dhe bicikletat dhe tampon zonave te zhvillimet industriale dhe tjera të ndjeshme.

Çështje Mjedisore që Lidhen me Mjedisin Fizik

- Zhvillimi i hapsirave të rrezikshme nga erozioni të prezantuara në PZHK me harten e erozionit (erozioni i fortë) duhet të ndalohet rreptesisht në të gjitha planet në vazhdim
- Zhvillimi i zonës industriale duhet të bëhet në territorin e përcaktuar, i pa përzier me hasirat e banimit;
- zhvillimet industriale duhet të zhvillohen sipas standardeve mjedisore të përcaktuara vetëm pas rivlerësimeve mjedisore;
- Zhvillimi i Pyjeve, hapsirave të gjelbërta, shiritave gjelbrues dhe tampon zonave duhet të konsiderohet në çdo plan e sidomos në planet rregulluese dhe projekte duke vlerësuar raportet e ndërtimit.

Biodiversiteti, Flora dhe Fauna

Kjo zonë karakterizohet me vlera të veçanta floristike, faunistike, fitocenologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike dhe hidrologjike. Specifikat më të rëndësishme të zonës janë bashkësitë pyjore të rrobullit, arnenit, pishës së bardhë, hormoqit, panjës malore, ahut, rododendrës, bashkësitë shkurrore dhe barishtore të maleve të larta në silikate, liqeni akullnor i Jazhincës (gjatësia 120 m, gjerësia 90 m dhe thellësia 11 m) etj. Zona e Bistrës, përveç me llojet e rralla drunore, veçohet edhe me shumëllojshmërinë e bimëve endemike barishtore, nga të cilët më të rëndësishme janë: drabë e Korabit (Draba korabensis -st. end.); potentillë e Doerflerit (Potentilla doerfleri - st. end.); karafil i Sharrit (Dianthus scardicus - st. end.); karafil me balluke (Dinathus superbus); fiteumë jo e qartë (Phyteuma confusiumi); nartecë e Sharrit (Narthecium scardicum); zambaku shqiptar (Lilium albanicum); etj. Zona është e pasur edhe me lloje të shumta të faunës (kafshëve të egra dhe shpendëve), në kuadër të cilëve veçohen: dhia e egër (Rupicapra rupicapra), ariu i murrmë (Ursus arctos), ujku (Canis lupus), kaprolli (Capreolus capreolus), macja e egër (Felis sylvestris), vjedulla (Meles meles), pulegra e madhe (Tetrao urogallus), shqiponja e përhimët (Aquila chrysaetos), shqiponja minjngrënëse (Buteo buteo), huti pyjor (Bubo bubo) etj.

Tipet e Habitateve

Disa nga habitatet në komunën e Shtërpcës janë të klasifikuara të mbrojtura në nivel qendror dhe lokal (disa zona të identifikuara me PZHK). Ato klasifikohen si më poshtë:

- Pyjet dhe zonat e e mbrojtura natyrorë;
- Liqenjt
- Lumenjt
- Livadhet të zonave të larta alpike dhe subalpike
- Kullosat
- Agroekosistemet etj

Çështje Mjedisore të Lidhura me Biodiversitetin, Florën e Faunën

Ka mjaft kërcënime potenciale në manaxhimin e biodiversitetit, florës dhe faunës të komunës së Shtërpcës. Çështjet në vijim janë identifikuar për zhvillim të mëtejm:

- Ekosistemtet ujore (Lumi Lepenc) janë të fragmentuara, të degraduara dhe, siç janë, kanë humbur habitate për specie të rëndësishme të faunës (mikrozoobentosit dhe makrozoobentosit). Gjendja e tanishme nuk siguron dot nivele të pranueshme të habitateve natyrorë;
- Rritja e volumeve të ujit sipërfaqsor për pasojë ndërtimeve dhe deponimittë mbetjeve të ngurta në zonat e vendbanimeve. Kjo mund të rritë përmbytjet dhe/ose erozionin duke shkaktuar humbje direkte të habitateve;
- Masa për të ruajtur biodiversitetin duke i marrë në konsideratë, në fazat e herëshme, në plane të reja zhvillimi;
- Kordinimi me njësi të tjera të qeverisë qendrore me qëllim sigurimin e një brezi të gjelbërt rrugme magjistrale dhe rajonale.

Përdorimi i Tokës dhe Peisazhi

Planifikimi i Përdorimit të Tokës dhe Çështje të Sigurimit të Shërbimeve

Për të vlerësuar tokën si burim natyror i pa rinovueshëm dhe rolin që ka në hapsira banimi fillimisht po japin definicionin dhe funksionet bazë të saj. Toka përcaktohet si pjesa e sipërme e kores tokësore, veçanërisht komplekse, që luan rol të rëndësishëm në mjedis në zhvillimin social dhe ekonomik të cilat janë vitale për jetën. Direktiva kuadër e tokës (BE) identifikon shtatë funksione bazë të saj të cilat janë:

- Prodhimi i biomasës, përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë;
- Mbajtjen, filtrimin dhe transformimin e ushqyesve, substancave dhe ujit;
- Mbajtëse e biodiversitetit;
- Mjedis fizik dhe kulturor për njerëzit dhe aktivitetet humane;
- Burim materialesh;
- Si depozitë karboni;
- Arkiv për trashëgiminë gjeologjike dhe arkeologjike.

Shumë nga zhvillimet e fundit në komunën e Shtërpcës nuk kanë bërë një përdorim të efektshëm të tokës. Shumë nga zhvillimet e paplanifikuara nëpër vendbanime, mund të thuhet se i kanë përkeqësuar problemet e infrastrukturës dhe kanë çuar në degradim mjedisor. Shumë nga kanalizimet e furnizimit me ujë dhe të ujërave të ndotura tashmë gjenden në tokë me pronsi private, për të cilat të drejtat e kalimit e përdorimit nuk janë plotësisht të përcaktuara, duke e kufizuar kështu mundësinë e hyrjes për mirëmbajtje.

Gjithashtu, pa ndonjë plan, apo edhe vlerësim të resurseve, janë aprovuar shumë projekte të reja. Nuk është e qartë se a është bërë vlerësimi i furnizimit të mjaftueshëm me ujë dhe energji i këtyre zhvillimeve të reja.

Komuna duhet të siguroj infrastrukturën dhe shërbimet për vendbanimet. E kombinuar me një kërkes për infrastruktur dhe mobilizim më të dobët të resurseve financiare, kushtet mjedisore në komuna vazhdojnë të jenë një problem.

Si truall ndërtimi toka në territorin e komunës merr një rëndësi të posaçme; për efekt të mungesës së fondeve dhe planifikimeve, për gjatë 20 vjetëve të fundit, toka pronë publike është zvogëluar dhe prona private po dominon. Ritmet e çmimit të sipërfaqeve të konsideruara si truall kanë qënë të larta. Statuti privat dhe çmimi vështirëson sot komunën e Shtërpcës të gjëjë hapsira për vepra publike. Kjo do të vazhdojë edhe më tutje duke kufizuar shpesh implementimin e PZHK-së në vepra pubilike (rrugë, lulishte, parqe).

Çështje Mjedisore që Lidhen me Përdorimin e Tokës

- Përdorimi i tokës për ndërtim është në rritje dhe raporti ndërtim/sipërfaqe e gjelbërt është i disfavorshem duke krahasuar me normat europiane për etnitete me specifika të njejta;
- Planifikimi i zonave ndërtimore nuk duhet të prekë sipërfaqe të gjelbërta veç në raste të jashtezakonshme dhe duke i rikompensuar ato;

Duke pasur parasysh keto specifika, ne kapitullin 6 paraqiten masa te pershatshme per shtimin e siperfaqeve te gjelbra. Per me teper, ne seksionin 6.4 paraqiten kriteret mjedisore qe kufizojne zhvillimin e ndërtimeve, qe perfshijne kriteret e forta mjedisore-shendetsore, kriteret e trashegimise kulturore, kriteret peisazhike dhe ato inxhinierike dhe te infrastruktures.

Rreziqet Natyrore në Mjedisin Fizik

Rreziqet Natyrore

Komuna e Shtërpcës rrezikohet nga tërmetet. Mbështetur në hartat e rrezikut sizmik në formë probabilitare, komuna përfshihet në zonën, ku lëkundjet e truallit që janë me intensitet 7-8 ballë (PGA=0.2 g).

Rrëshqitjet e tokës janë fenomen i pranishëm në komunën e Shtërpcës.

Me rritjen e ndërtimit dhe degradimit të pyjeve, rreziku i përmbytjeve do të rritet shumë.

Kjo gjë përshkruhet mëposhtë ne seksionin mbi Menaxhimin e Mbeturinave të Lëngshme dhe Ujërave të Shiut.

Adaptimi dhe Zvogëlimii Rrezikut të Katastrofave, përmirësimi i informacionit dhe reagimi për zbutjen e efekteve të çdo katastrofe natyrore duhet parë me prioritet edhe atë në funksion të:

- Menaxhimit të Rrezikut të katastrofës;
- Forcimit të shërbimeve hidrometeorologjike;
- Caktimit të kodeve të ndërtimit për aktivitetin sizmik;
- Sigurimin e individeve dhe bizneseve nga katastrofat natyrore.

Mjedisi i Ndërtuar dhe Kultura

Megjithëse Komuna e Shtërpcës është si komunë administrative jo fort e vjeter e disa nga vendbanimet e saj datojnë që nga lashtësia dhe prezantojnë vlera që janë të mbrojtura për nivelin e Kosovës. Kisha e Shën Nikollës, Kisha e Shën Gjergjit, Kisha e Teodorit të Shenjtë, Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë, dhe disa godina tjera të rëndësishme kulturore që duhen ruajtur.

Cilësia e ajrit

Mungesa e objekteve të industrisë së rëndë dhe veprimeve tjera industriale në Shtërpcës ka pasur një efekt pozitiv për sa i takon cilësisë së ajrit. Edhe zhvillimet ekonomike dhe sociale pas luftës veçanerisht rritja e numrit te automjeteve dhe veprimtarive ndërtuese kanë shkaktuar një ndotje të ajrit në Komunë. Në mënyre te permbledhur po rendisim disa subfaktorë të cilat kanë ndikim në cilësin e ajrit në komunën e Shtërpcës:

- Rritja e lartë dhe përdorimi i çdokohshëm i makinave private
- Shumica e këtyre automjeteve janë më shumë se 15 vjeçare dhe nuk janë në përputhje me Euro I apo II;
- Një pjesë e madhe e tyre punojnë me naftë;
- Nga të gjitha rrugët që kalojnë nëpër territor të kmunës së Shtërpcës, vetëm një pjesë e tyre është e asfaltuar, pjesa tjetër ose ka kualitet të dobët ose është e pa asfaltuar.
- Djegiet e mbeturinave në deponitë e egra,
- Djegjet e pyjeve dhe mbetjeve të biomasës.

Një tjeter problem qe lidhet me cilesin e ajrit është edhe cilesia e karburanteve qe perdorin automjetet. Shumë gjeneratorë me naftë që përdoren për të kompensuar ndërprerjet e energjisë janë gjithashtu kontribues në këtë cilësi të dobët të ajrit, mbasi punojne me nafte te cilesise se dobet. Megjithate lidhur me keta te fundit, ndikimi i tyre ne cilesin e ajrit të komunës së Shtërpcës, perfshire zhurmat, është minimal.

Zhurma dhe Kundërmimi

Nje tjeter problem mjedisor me te cilin po ballafaqohet gjithnje e me shume Komuna e Shtërpcës është zhurma duke e pas parasysh se këtu gjenden zona të mbrojtura të shtazëve në të cilat zhurma ndikon negativisht në to, duke shkaktuar stres dhe si përfundim ndrrim të habitateve. Nga monitorimet e bera gjate periudhes së më hershme, ka rezultuar qe niveli i zhurmave ka tendence të lehte rritje në akset rrugore Rruga regjionale Shtërpc-Prizeren e që kalon mes e për mes gjithë territorit të komunës, është njëra nder rrugët më të ngarkuara të komunës së Shtërpcës.

Rruga e cila të qonë në brezovicë te qendra e skijimit është rrugë e rendit të tret sa i përket qështjes së ngarkesë dhe aspektit të ndotjes, pasi që në vitet e fundit shumica kjo rrugë është më e frekuentuar.

Qendra e skijimit në Brezovicë vet prania e faktorit njeri dhe zhurmat që bëhen gjat aktivitetit në këto zona gjatë sezonit të skijimit por edhe gjatë vikendeve shkaktohen zhurma menivele të pa pranueshme për zhtazët të cilat jetojn në këto zona. Vlerësohet që në të ardhmen të caktohen zonat e ndjeshme të zhurmës sidomos në zonën e PN Mali Sharr.

Përpos ktyre akseve kemi edhe disa pika të ndotjes nëpër vendbanime. Megjithate zhurma eshte ne te gjitha rastet pertej vlerave limit qe percakton Udhezimin “Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara” dhe Limitet e Pergjitheshme per Nivelin e Zhurmave te OBSH.

Nivelet më të larta të zhurmës janë akset, jo vetem ne qender te kryeqytetit por ato janë prezente diten dhe naten ne te gjitha akset rrugore kryesore te qytetit dhe zonat rreth tyre. Nje tjeter dukuri per tu ven ne dukje eshte niveli konstatnt i zhurmes gjate 24 ne zonen

e urbane e cila eshte njeheresh edhe zone residenciale ku limiti i nivelit te zhurmes ne oret e nates nuk duhet te kaloje 45 dBA, ndaj vlerave mbi 60 dBA.

Burimet Ujore

Burimet Ujore dhe Furnizimi me Uje

Komuna e Shtërpcës ka burime të mjaftueshme ujore për t‟iu përgjigjur kërkesave aktuale dhe në perspektive. Komuna furnizohet, nga disa burime uji. Një pjesë e sistemittë furnizimit me ujë është i vjetër dhe punon nën kapacitetin e projektuar, ndërkohë që ka dhe shumë humbje ne rrjet, nuk disponohet informacion i plote i lidhjeve ilegale per perdorim shtepiak dhe ujitje. Ka te dhena qe ne disa puse te ceket, uji nentokesor eshte i ndotur. Gjithesesi shifra e humbjeve mendohet te jete e larte.

Monitorimi i cilësisë së ujit në lumenjtë kryhet nga disa institucione MMPH,AKMM dhe institucione tjera. Cilesia e ujit te pishem, perfshire aspektin bakterologjik monitorohet nga Ministria e Shendetesise, permes Drejtorive të Shendetësisë.

Ndërmarrja regjonale e Ujësjellësit është gjithashtu përgjegjës edhe për furnizimin me ujë tëfshatrave të Shtërpcës. Në këto fshatra vetëm një pjesë e banoreve kanë kontratë me Ndërmarrjen kurse disa të tjerë shfrytëzojnë burime individuale. Kjo ndodh kryesisht për arsye se:

- rrjeti nuk e furnizon të gjitha vendbanimet, shumë shtëpi kanë sistem privat të furnizimit me ujë me puse private, ose u mungon furnizimi me ujë;
- përdoruesit furnizohen, por me lidhje ilegale, shpesh ngaqë ndërtimi i shtëpisë është bërë në mënyrë informale;
- sistemi i furnizimit me ujë është i vjetër.

Për sa kohë furnizimi me ujë i Shtërpcës vazhdon të jetë me ndërprerje, do te vazhdoje te jete prezent rreziku për shëndetin per shkak te ndotjes kryesisht bakteriale te ujit. Klorifikimi kryhet në impiantin e trajtimit te ujit ose depozitat e ujit te pishem dhe ne pergjithesi uji karakterizohet nga teprice klori si mase preventive per te parandaluar ndotjen bakteriale. Ka patur raste, sidomos ne stinen e nxhete, te semundjeve gastro-enterike, por mungojne evidencat qe te mund te percaktojne lidhjen ndermjet ujit te ndotur dhe semundjes.

Ne vendbanimet e mdha të Shtërpcës në pergjithesi eshte ritur konsumi i ujit te konfeksionuar si mase per te shmangur mundesin e kontaminimit edhe nga uji i depozitave nepermjet te cilave furnizohen shumica e objekteve.

Çështje Mjedisore që Lidhen me Ujin e Pijshëm

- Ka raste kur cilësia e ujit kompromentohet kryesisht nga ndotjet që pëson në linjat e transmetimit (ndotja nga ujrat e e zeza, per shkak te intersektimeve te shumta te tubacioneve te ujit te pishem me ato te ujrave te zeza);
- Përdorimi për qëllime të tjera veç përdorimit familjar, është i madh duke ulur sasitë e nevojshme për popullsinë;
- Burimet ujore nëntokësore, sidomos ato deri në 20 m thellësi janë të rrezikuara nga ndotja sipërfqësore për shkak të përshkueshmerisë së larte të shtresave mbrojtëse.

Menaxhimi i mbetjeve
Grumbullimi i Mbetjeve të Ngurta

Menaxhimi i mbeturinave në komunë bëhet nga "NJKP' (Novo Javno Komunalno Preduzeće/Kompania e Re Publike Komunale). Në bazë të të dhënave të fituara "NJKP" 80 % të vendbanimeve janë të mbuluar me shërbime komunale. Nga 16 vendbanime në komunën e Shtërpcës, vetëm 3 fshatra nuk janë të mbuluar me shërbime komunale (Sushica, Izhanca dhe Kashtanjeva), për shkak të terrenit të pakalueshëm. Pajisjet komunale janë të shpërndar në mënyrë të barabartë në 13 fshatra. Për grumbullimin e mbeturinave janë në dispozicion kontejnerët 1,1 m^3, të cilët janë të shpërndarë pranë institucioneve publike dhe shportat të cilat i posedon gati çdo shtëpi. Në vendbanimet të cilat nuk janë të mbuluar me shërbime komunale, deponimi i mbeturinave bëhet ne deponi të egra.

Komuna jonë nuk posedon deponi në të cilat do të mund të deponoj mbeturinat, por mbeturinat i transporton në Gërlicë dhe Gjilan.

Menaxhimi i Mbetjeve të Lëngëta dhe Kullimi i Ujërave të Shirave

Sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura në Shtërpcës është si vijon:

1. Rrjeti i kanalizimit në fshatin Gotovushë –Ky fshat ka të ndertuar rrjetin e kanalizimit të ujrave të zeza ndrsa trajtimi I tyre nuk bëhtë derdhja bëhet në lumen Lepenc.
2. Rrjeti i kanalizimit në fshatin Bitij e Eperme –Ky fshat ka të ndertuar rrjetin e kanalizimit të ujrave të zeza ndrsa trajtimi I tyre nuk bëhtë dhe derdhet në lumin Lepencë.
3. Rrjeti i kanalizimit në fshatin Berefc –Ky fshat ka të ndertuar rrjetin e kanalizimit të ujrave të zeza ndrsa trajtimi i tyre nuk bëhtë dhe derdhet në lumin Lepenc.
4. Rrjeti I kanalizimit në fshatin Drajkofc –Ky fshat ka të ndertuar rrjetin e kanalizimit të ujrave të zeza ndrsa trajtimi i tyre nuk bëhtë dhe më pastaj kalon dhe derdhet në lumin e Lepencë.
5. Rrjeti I kanalizimit në Shtërpcë – Qyteti i Shtërpcës ka të ndertuar rrjetin e kanalizimit të ujrave të zeza ndrsa trajtimi I tyre nuk bëhet fare dhe më pastaj kalon përmesë kësaj grope kalon në sistemin e largimit (filtrimit) dhe derdhet në lumin e Lepenc.

Kështu shumë nga vendbanimet në Komunës së Shtërpcës nuk kanë menaxhim efektiv të ujërave të ndotura. Janë ndërtime të paligjshme që derdhen drejt e në lumenj, të cilët shpesh janë standardit dhe rrjedhin, duke shkaktuar ndotjen e ujërave sipërfaqësorë dhe nentokesore.

Mungesa e trajtimit të ujrave te ndotura përbën ndoshta rrezikun të madh mjedisor për Shtërpcën dhe sigurisht shkakton ndotje të madhe.

Duhet vënë në dukje se MMPH ka parapa impiant regjional për trajtimin e ujrave të zeza konfiguracioni i terrenit të Shtërpcës nuk paraqet ndonjë përpasi në ketë funksion përpos në segmente të caktuara .

Furnizimi me Energji

Furnizimi me energji bëhet nga KEK-u. Ndërprerjet e vazhduara të energjisë elektrike kane qenë shqetesuese vite më parë edhe se me trend të zvogluar por prapë paraqesin një shqetsim. Kjo sillte dhe vazhdon të siejell si pasojë përdorimin e gjeneratorëve me naftë, që rendonte ndotjen e ajrit dhe që po vazhdon kohë pas kohe.

Aktivitetet Ekonomike dhe Sociale

Aktualisht nga analiza të kryera nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për komunën e Shtërpcës dhe Grupi punues për zhvillim ekonomik u konsiderua se fusha kryesore e cila mundë të zvogloj numrin e migrimeve nga Shtërpcës por edhe krijoj kushte për të punuar dhe jetuar është planifikimi i zonave të zhvillimit ekonomik të shprehura në PZHK me harten e turizmit, bujqësisë transportit, pasurive minerare dhe aspekteve e potencialeve tjera të zhvillimit.

Disa mundësi të planifikuara të zhvillimit ekonomik janë prezantuar në harten e më poshtme marrë nga PZHK e Shtërpcës.

Nuk ka ndonjë studim të drejtpërdrejtë që të lidhë kushtet e mjedisit me aktivitetin ekonomik të Shtërpcës. Megjithatë, nuk rezulton që aktualisht aktivitet industriale të cilat janë kryesisht të karakterit nxierrës të mineraleve me intensitet të dhe vllim të ulët, nxierrje e zhavorit ,prodhim të asfaltit, betonit, parafabrikateve etj të kenë krijuar çrregullim mjedisor.

Avansimi drejt stabilizimit në furnizimin me energji elektrike gjithashtu, ka minimizuar edhe perdorimin e gjeneratoreve industrial, te cilet emetonin sasi të konsiderushme gaze ndotese, duke ju shtuar shkarkimeve te po se njejtes natyre nga transporti.

Legjislacioni aktual per investitoret vendas dhe te huaj, ne vecanti ai mjedisor, qe ne pergjithesi eshte i perafruar me ate të BE, parashikojne të gjitha procedurat dhe masat për të siguruar që investimet për zhvillimin social ekonomik nëkomunën e Shtërpcës ashtu si dhe në gjithe vendin, të mos demtoje apo demtojn mjedisin.

10. ANALIZA SWOT

Më poshtë paraqiten problemet më të rëndësishme mjedisore, zonat mjedisore dhe faktorët avantazhues, përkeqësues, kërcënues dhe mundesi per permiresim.

Zonat me Probleme Mjedisore

Ky seksion bën një përmbledhje të analizës së mësipërme të kushteve mjedisore në Shtërpcës dhe vë në dukje:

- Zonat që vuajnë nga një degradim i thellë mjedisor apo që po kalojnë një shok mjedisor;
- Zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, të cilave mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve, në se nuk u ofrohet një mbrojtje më e mirë mjedisore; dhe
- Përmbledhje të natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në mjedis, nisur nga përshkrimet e bëra në këtë kapitull.

Diskutim i grupeve të faktorve në analizën SWOT.

a) Zonat që vuajnë nga degradim i thellë mjedisor

Të gjithë lumenjtë dhe proskat, vuajnë degradim dhe ndotje mjedisore të shkaktuar nga depozitimi i vazhdueshëm i mbetjeve të ujërave të ndotura dhe i lëndëve të ngurta. Pastrimi i lumejve të Shtërpcës kërkon një menaxhim më të mirë të mbetjeve të ngurta, sidomos në vendbanimet e mëdha, si dhe sigurimin e kolektorëve të duhur gjatë rrugës.

Në se nuk kontrollohet rritja e numrit të automjeteve dhe nuk ndërmerren masa për të përmirësuar rrugët, standardet e karburanteve dhe të shkarkimeve, atëherë rritja eparashikuar me katër herë më shumëe mjeteve do të ketë pasoja në cilësinë e ajrit. Masat e ndërmarra nga Qeveria për reduktimin e makinave të vjetra nëpërmjet taksimeve dhe renia e ritmit të ndërtimeve kanë dhënë efekte pozitive në ndotjen e ajërit, por jane të pamjaftushme përtë siguruar cilesi te ajrit dhe nivel te zhurmave brenda standardeve.

b) Zonat që kanë nevojë për Mbrojtje Mjedisore

Ndërkohë që zona e mbrojtura ne PN "Mali Sharr" dhe zonat e Veçanta të mbrojtura, dhe zonat e tjera duhet të mbrohen, në hapësirat e gjelbra të PN "Mali Sharr" ka pasur ndërtime dhe vazhdohet të ketë ndërtime edhe se të intezitetit të ulët por pa kritere të caktuara për zonën. Komuna dhe institucionet përgjegjëse përkëto zona duhet të marrin në konsiderat sugjerimet e PZHK-së për zonat me vlera të larta natyrore.

Duhen marrë vendime në lidhje me përdorimin e ardhshëm të tokës në zonat e parapara për vikende si dhe zonat tjera të pazhvilluara rreth vendbanimeve konform kufijve të propozuar ndërtimor.

Mjedisi i ndërtuar është një fushë tjetër shqetësuese. Monumentet kryesore të rëndësisë së Kosovës në Shtërpc do të vazhdojnë të ruhen, por ndërkohë duhen të merren vendimet në lidhje me atë se sa nga trashëgimia e ndërtimit në Shtërpc, e krijuar në periudha të ndryshme gjatë shekujve, do të ruhet. Këto vendime duhen marrë sa me pare, pasi komuna po transformohet me shpejtësi dhe mbushja e zonave të ndërtimeve tradicionale me godina mund të demtoje ose shkatërrojë vlerat e këtyre zonave.

Ajo që është e rëndësishme është se pjesa më e madhe e degradimit mjedisor të komunës nuk është i pariparueshëm. Problemet mjedisore të identifikuara të menaxhimit të

mbetjeve, të ngurta apo të lëngëta, si dhe ndotja e ajrit janë të trajtueshme në se investimet kryhen në kohe dhe ne mënyrë efektive. Me ketë planë janë trajtuar: **I**) furnizimin me ujë; **II**) menaxhimin e ujërave të ndotura komunale; **III**) trafikun; dhe eshte në proces manaxhimi i integruar i mbetjeve. Ekzistojnë ndërkohë edhe legjislacioni dhe politikat përkatëse të cilat po zhvillohen me qëllim që t"u përgjigjen problemeve mjedisore. Potencialisht eksizton problem i ndotjes dhe i rënies së nivelit të ujërave nëntokësore për shkak të lumenjve të ndotur dhe pompimit të ujërave nëntokësore. Efekti i kësaj ndotjeje dhe i zvogëlimit të ujërave nëntokësore mund të jetë i vështirë për t"u parashikuar dhe riparuar.

Ka disa fusha të tjera shqetësuese, të cilat në se vazhdon procesi i zhvillimit në këto ritme, do të shkaktojnë probleme madhore. Siç u përmend më lart, duhet bërë një debat dhe duhen marrë vendimet në lidhje me çfarë do të ruhet nga trashëgimia e ndërtimit për pos kësaj që është trajtuar me ketë planë. Kur një ndërtesë është shembur, apo një zonë është transformuar, atëherë është shumë e vështire dhe e kushtueshme që të kthehesh në gjendjen e parë.

Vazhdimi i shtrirjes në zonat kodrinore rrethuese të vendbanimeve është ndoshta shqetësimi mjedisor më i rëndësishëm. Në mënyrë të veçantë, zhvillimi i cili po ndodh në rrethinë të disa vendbanimeve por jo vetem, ndikonne aspektin biologjik, ate peizazhistik. dhe mund të sjellë rritje të rrjedhjeve, gjë e cila mund të përshpejtojë proceset natyrore të erozionit dhe të shkaktojë rrëshqitje të tokës ose përmbytje. Erozioni i pjesës së sipërme të tokës mund të kthehet në problem për kodrat e ulëta që rrethojnë vendbanimet e Shtërpcës. Sigurisht, në se zhduken pemët dhe pyjet, shtresat e tokës janë të prirura ndaj erozionit, dhe ky proces është i pakthyeshëm.

Shkalla e ndikimit mjedisor të shkarkimeve të lëngta nga aktivitete socio ekonomike në Shtërpcës dhe rreth saj nuk njihet. Megjithatë, kryesisht duhet trajtuar ndikimi i ketyre shkarkimeve në cilësinë e ujërave të lumejve.

Nuk rezulton të ketë studime që të lidhin në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndikimin e cilesise se mjedisi; behet fjale kryesisht per cilesin e ajrit, ujit te pishem, zhurmat,por jo vetem, në shëndetin e banoreve.

Në raportete Nivelit qendror ofrohen në formë të përgjithësuar informata të sektorit shëndetësor në Kosovë, duke vënë në dukje çështje si siguria e ujit të pijshëm dhe siguria rrugore si shqetësime madhore, por në këto raporte nuk trajtohet në mënyrë specifike Shtërpcës, ndërkohë që vë në pah edhe natyrën kontradiktore të disa prej treguesve shëndetësorë. Kto raporte që kanë edhe dimensionin mjedisor mundë shfrytzohen për të rekomanduar që Qeveria e Kosovës dhe ajo komunale duhet të kalojnë nga ndërhyrjet me karakter kurativ në mjedis dhe shëndetësi, në ato me karakter parandalues. Raporti tregon se stili i jetës.

Agrumente të Analizës SWOT

Pikat e forta

Në komunën e Shtërpcës ekzistojnë hulumtime të natyrave dhe fushave të ndryshme të cilat janë berë edhe në të kaluarën edhe tani ka një inventarizim bukur të mirë të florës dhe faunës, identifikim të problemeve mjedisore, ka analiza për ekosisteme ka strategji të zhvillimit ekonomik, plane dhe projektetë zhvillimit komunal dhe mbrojtje të mjedisit sidhe këtë dokument VSM) i cili analizon në mënyrë sistematike ndikemet potenciale mjedisore nga aplikimi i Planit zhvillimor komunal. Duke qenë komun me një turizë bukur mirë të

zhvilluar, kjo komunë është në avantazh për shkak të qendrave të skijoimit por edhe vetë si komunë si zona ekonomike dhe sociale me potenciale të konsiderushme të zhvillimit ekonomik, turistik, kumunikimet (rruga Regjionale Prizren-Kaçanik). Si pikë tjetër është edhe ndërtimi i qendrë së re të skijimit. Pika të forta janë edhe prezenca e kapaciteteve të zhvilluara intelektuale, kapacitetet rionore. Kemi edhe për çdo ditë e më shumë instalimin e teknologjive inovative dhe reduktim të dukshëm të industrive ndotëse. Legjislacioni mjedisor është drejt perafrimit me ate te Bashkimit Europian.

Pikat e dobëta

Si zonë kodrinoro malore Komuna e Shtërpcës vazhdon të ballafaqohet me zbrazje të disa vendbanimeve dhe presion zhvillimi në disa vendbanime, zbrazja e ktyre vendbanimeve dhe ndikimi i presionit të rritjes dhe zhvillimit në disa vendbanime tjera determinohen kryesisht me mungesën e vëndeve të punës, papunësisë dhe kulturës së jetesës, faktorë që duhen të manaxhohen.

Në planin administrues niveli i ulët i aftësive në segmente të administratës lokale ngadalëson kapacitetet manaxheriale. Probleme me pronën private të traullit, privatizimet, prania e hot spoteve mjedisorë si ajo te miniera dhe në pikat tjera, mungesa e zbatimit korrekt të legjislacionit, veçanesrisht atij mjedisor, krahas zhvillimeve të pa kontrolluara gjate dy dekadeve te fundit, janë pjesë e pikave të dobëta në këtë analizë. Pika të dobta vazhdojnë të mbeten mangesite në trajtimin e treshëgimis kulturore,të ndërtuar dhe natyrore, infrastrukturës, veçanerisht në furnizimin me uje të pishem, kanalizimi i ujrave të zeza, mungesa e pastrimit të ujërave të zeza, manaxhimi i dobet i mbetjeve komunale, etj.

Mundësitë

Bazuar mbi potencialet turistike (dy qendrat turistike) si dhe mbeshtetjen e mundëshme të donatorve dhe qeverise, është e mundur që komuna të vazhdoj të hartoje dhe zbatoje plane, programe dhe inisjativa të tjera për zhvillimin e studjuar të pjesëve të trajtuar me ketë plan zhvillimor komunal dhe trajtuara si zona për shfrytzime të ndryshme, trajtimin e hapësirave të zgjeruarandërtimore të parapara me planë, hapsirave pyjore,peisazheve atyre rekreative dhe permiresimin e treguesve mjedisorë. Në planin e zhvillimit komunal është e mundur të rritet ndjeshëm aplikimi i Ligjeve dhe Vendimeve të Kuvendit komunl në favor të mjedisit dhe shëndoshjes së financave publike komunale. Me qëllim të rritjes së hapsirave publike rekreative është e rekomanduar inkurajimi i biznesit privat në hapsirat rekreative (parqe, salla lojrash, fusha sporti, sipërfaqe për femijët). Rritja e cilësisë së transportit publik është një mundesi që duhet të zhvillohet.

Kërcënimet

Mos trajtimi i hot spoteve mjedisore, mos trajtimi i zonave të mbrojtura mundë të shkaktoj kërcnime serioze mjedisore dhe shëndetsore në komunën e Shtërpcës.

Humbje e vlerave natyrore, rekreative, shkencore dhe turistike, vendbanime të tëra të mbesin pa asnjë banor, kostoja e shërbimeve të ngritet deri në shkallën që shkakton trazira sociale dhe ekonomike.Problemi i pronësisë së tokes sidomos mungesat e pronave komunale për zhvillime përbejnë një grup problemesh shqetësuese ndikimi i të cilëve do të vazhdojë gjatë. Nës bazohemi në faktin se blerja e sipërfaqeve për lulishte, parqe, hapesira shlodhëse kërkon finacime të mëdha dhe ne kontekstin e buxheteve jo të mëdha të Shtërpcës përbejnë nje tjetër kërcënim.

ANALIZA SWOT E VSM-së PËR PZHK TË SHTËRPCËS

Pikat e forta Me PZHK jan trajtuar të gjitha problemet dhe sfidat mjedisore Projekti (PZHK) i mirë në nivelin makro - Plani zhvillimor Komunal; Pozicion i përshtatshëm fiziogjeografik, turizëm i zhvilluar dhe burime natyrore të mjaftueshme; Interesim ne rritje i qytetarve, autoriteteve shteterore dhe shoqerise civile per mjedisin Legjslacion mjedisor dhe planifikimit hapsinor i zhvilluar dhe permiresuar; Reduktim i dukshëm i industrive që ndikojnë ne ndotjen mjedisore Teknologji inovative në procese industriale dhe ndërtime; Fonde të konsiderushme nga Qeveria,donatorët dhe nga sistem i përmirësuar i të hyrave vetanake, komunikim i përmirsuar përmes transportit rrugor.	**Pikat e dobëta** Mungesa e informative për thellim të analizave për zhvillimet e planifikuara me PZHK Ndërtimet informale edhe në vikend zona; Përqindje e lartë e papunësisë; Zona me dendesi tëulëtnë numrin më të madh të vendbanimeve Siperfaqe e vogel e rrugeve Zona me ndotje të konsiderueshme akustike dhe (për shkak të sensibilitetit që kanë zonat embrojtura ndaj zhurmës). Nivel i ulët i aftësive manazheriale në segmente të caktuar të qeverisjes lokale dhe motivim i ulët në segment të caktuar të administratës publike; Zvogëlimi i hapësirave të gjelbërta dhe hapësirave të tjera publike; Mungesë e kulturës sa I përket banimit kolektiv dhe më të dendur sidomos te popullsia e cila ka lëviz ne vendbanime më të mdha të komunës e të ardhur nga zonat më pak të zhvilluara; Mungesa e koordinimit me komunat për rreth; Infrastruklturë jo shume e zhvilluar dhe e paintegruar (jo shumefunksionale); Mungesa dhe/ose kosto e lartë për disponimin e sipërfaqeve të lira për zhvillimin e parqeve industriale dhe mungesa e infrastrukturës së zhvilluar; Manaxhim i dobet i mbetjeve Mos trajtimi I hot spoteve mjedisore Menaxhim jo i mirë i turizmit; Mungesa e koherencës midis aksioneve të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor, donacioneve dhe departamenteve universitare/studiove profesioniste etj.
Mundësitë Planifikimi i masave për mbrojtje dhe zhvillim të mjedisit Vullnet I donatorve dhe qeveris për trajtim të pikave të nxehta mjedisore Zhvillimi i kapaciteteve manaxhuese të politikave, planeve dhe	**Kërcënimet** Humbja e ekosistemeve me vlera të larta natyrore Rrezikim i shëndetit të populates Prishje e balancit mjedisor

programeve në nivel komunal; Krijimi i një Forumi qytetar gjithë përfshirës për cilësi jete më të mirë si nje njësi për oponencë dhe edukim mjedisor; Rritja e efektshmërisë së zbatimit të Ligjeve dhe detyrimeve financiare te popullsisë dhe biznesit në raport me taksat komunale.; Bashkëveprim i kordinuar me komunat tjera dhe shtetin fqinjë Maqedoninë për aspektin mjedisor; Përfshirja e ekipeve të kualifikuara në zbatimin e planeve dhe hartimin e projekteve të rendësishme në kuadër të PZHK-së; Ndërtimi i impjantit regjional dhe trajtimi I përkohëshëm në pikat e fundit të derdhjeve të ujit të përdorur. Përmirësimi i shërbimeve në transportin publik; Përfshirja e biznesit privat në hapsirat pyjore,të gjelbra dhe rekreative (parqe, salla lojrash, sipërfaqe për femijët).	Shkatrrim i resurseve toksore,ujore dhe resurseve tjera Shkatrrim i ekosistenmeve,biodiversitetit,florës dhe faunës Shkatrrim I trashegimisë kulturore dhe natyrore Konflikte në lidhje me çështjet e pronësisë; Pakësimi i hapsirave publike për shkak të presionit . Ulje e ndjeshme e biodiversitetit;

11. PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QE KUFIZOJNE ZHVILLIMIN KOMUNAL

Ky kapitull paraqet parimet per planifikimin hapesinor te qendrueshem, objektivat strategjike dhe veprime operacionale ne kuader te hartimit te PZHK-së. Me tej paraqiten edhe kriteret mjedisore qe kufizojne zhvillimin Komunal në vendbanime të ndryshme të komunës aktuara te qytetit.

Parimet e Pergjithshme për Planifikim Hapesinor

Parimet e përgjithshme për planifikimin hapesinor jane nje teresi rregullash te bazuara mbi eksperiencat nderkombetare, te cilat shkurtimisht mund te permblidhen ne dhjete pika si meposhte:

1. Nxitja e zhvillimit te qëndrueshëm;
2. Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
3. Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejzazhore, të florës e faunës;
4. Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve;
5. Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;
6. Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan" ose „përdoruesi paguan";
7. Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira per mbrojtjen e mjedisit;
8. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe pergatitjen e sheshit;
9. Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe aksesi i publikut në informacion; dhe
10. Bashkëpunim ndërkombëtar.

Ne kuader te hartimit te PZHK-së parimet e mesiperme përkthehen në përparesitë e meposhtme (siç jane paraqitur edhe në këtë material):

- Densifikim përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës nëpër vendbanime në në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes së disa vendbanimeve përtej kufijve të planifikuar.
- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më të efektshëm të tokës.
- Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve– aksesi nëpër vendbanime dhe komuna fqinje është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit.
- Rehabilitimi i tokës bujqësore
- Rizhvillimi i pyjeve kzistuese, pyllzime të reja.
- Ruajtja e trashëgimisë kulturo – historike dhe natyrore të Shtërpcës për të ruajtur stilin dhe peisazhin e Shtërpcës së vjetër.
- Ruajta e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime.
- Zgjerimi i zonav të banimit atje ku kushtet janë të favorshme.

11.1 Objektiva Strategjike

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në nivelin komunal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë idefinuar si:

- Zhvillimi i mëtejshëm i vlerave, ku të gjithë aktorët e kryera të drejtën e tyre për të ditur, për t'u dëgjuar, për t'u dëgjuar dhe për të ndikuar në vendimet që ndikojnë në jetën dhe tendencat e tij. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e intensiv dhe ndryshimet në strukturën socio-ekonomik, përfshijnë zhvillimin e barabartë në kuadër të komunës;
- Për të krijuar kushte për një rritje të përhershme në punësim, eliminimin e varfërisë, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e vdekshmërisë së fëmijëve në bazë të standardeve që do të ofrojnë qëllimet themelore të ndryshimit në strukturën sociale-ekonomike, zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe nivelit të jetës dhe forcimin e rolit të sektorit privat në socio-zhvillimin ekonomik;
- Rritja e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (krijimi i sigurisë për edukim themelor, siguri sociale dhe fizike, siguri të mjedisit etj);
- Zhvillimi i një partneriteti global për zhvillim.

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilesisë së jetes në komunë (rritja e sigurise, shtim i mundesive për menyre aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojne në përmbushjen e objektivave strategjike te planit.

Nder të tjera, PZHK-ja perpiqet të zbatoje disa parime dhe modele zhvillimi të pranuara gjeresisht, si psh. Komuna e Shtërpcës komunë policentrike, ku qytetari gjen sherbimet prane vendbanimit të tij dhe nuk ka nevoje të udhetoje për të siguruar sherbimet veç në qendërën administrative.

PZHK-ja parashikon zhvillimin e Komunës si një e tërë me vendbanime, lagjet, e deri tek zonat e vogla të banimit. Në kete faze, duke qenë plan i zhvillimit komunal, do jepen kufijt, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standartet e parashikuara për tërë komunën që nënkupton edhe refleksion në çdo vendbanim, dhe më pas puna do vijoje me planet rregulluese urbane të detajojnë zhvillimin për çdo zonë banimi. Plani do perpiqet të perfshije konceptin e formules së menaxhimit të prones në menyre adekuate pa dallime të pronarve gjatë destinimeve në zona ndërtimi gjelbrim etj.

PZHK-ja parasheh nje zhvillim me miqësor me mjedisin, duke synuar që zhvillimet e reja të infrastrukturës, zonat industriale, etj., nuk i cenojn korridoret e qarkullimit të shtazëve ose janë marrë masa të duhura për qarkullim natyrorë të shtazëve dhe llojeve bimore nga një habitat në tjetrin, pyllzimin, ripyllëzimin, krijimin e disa shiritave të gjelbër, tampn zonave, parqeve dhe shume mundesi te rritjes se siperfaqeve te gjelbra brenda vendbanimeve. Në ketë aspekt mund të përmendim. Parashikohet krijimi i një mundsie qarkullimin me bicikleta pergjate disa rrugëve e sidomos në disa vendbanime të mëdha. Nje

sfide e vecante mbetet zbatimi në praktike i këtyre synimeve të PZHK-së; për pyllëzim, rypyllëzim, shirita të gjelbër, tampon zona, dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe permiresimi i treguesve mjedisore të komunës.

Gjithashtu plani synon të integroje dhe përmirësoje situaten aktuale komunale, si psh. zgjerimi i vendbanimeve në drejtimin më të favorshëm në kuptimin e shtrirjes në tokë me plleshmëri të dobëtdhe me perdorim të perzier.

Një tjeter aspekt mjedisor i Planit eshte rehabilitmi i pikave te nxehta mjedisore, nderrmarje që krijon mundesi për shtimin e siperfaqeve të gjelbra, për çlodhje dhe argetim.

Ne menyre të përmbledhur objektivat për mbrojtien e mjedisit në kuadrin e Planit mund të përmblidhen si meposhte:

1. Krijimi i njëkomune të qendrueshëme dhe të shëndetshme
2. Identifikimi dhe krijimi i habitetve të reja, dhe korridoreve te gjelber
3. Permiresimi i cilesise së ajrit, perfshire reduktimin e zhurmave
4. Kursimi i, energjise dhe paksimi i emisioneve të gazeve serrë
5. Cilesia e ujrave siperfaqesore në përputhje me kerkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktives Kuader për Ujin të BE-së
6. Pakesimi i sasise se mbetjeve dhe manaxhimi i integruar i tyre
7. Reduktimi i intesnsitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësor dhe qarkullimit me bicikleta
8. Shtimi dhe mbrojtia e vlerave kulturore, perfshire arkeologjike dhe arkitekturore
9. Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik
10. Mbrojtia e mjedisit natyror në pyjet dhe kodrat e Shtërpcës
11. Riperdorimi i disa tokave të ndotura në vend te tokave te reja

11.2 Veprime Operacionale ne Mbeshtetje te Objektivave Strategjike

Veprime operacionale per shtimin e hapesirave te gjelbra në Shtërpcës:

1. Krijimi i projekteve për zbatim në zonat e mbrojtura të rekognozuara në komunën e Shtërpcës siç janë: Zonat e mbrojtura PN"Mali Sharr", Pyjet e ahut, shkozës pyjet halore,
2. Pyllëzimi dhe ripyllzimi i zonave të parapara me PZHK
3. Krijimi i parqeve të reja nëpër dhe për reth vendbanimeve
4. Krijimi i koridoreve te reja ekologjike sipas Planit te ri dhe zonave të Shtërpcës Zgjatimi dhe permiresimi i kushteve ekologjike në koridorin pergjate lumejve;
5. Krijimi I lulishteve dhe kopshteve në Shtërpcës, etj;
   7. Kthimi i zonave te degraduara ne siperfaqe te gjelbra;
   8. Gjelberimi i kopshteve te shtepive private;
   10. Gjelberimi me peme dhe shkurre dekorative pergjate rrugeve dhe trotuareve;
   11. Ngritja e barrierave të dendura me gjelberim si perde që ndajn rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjate rrugeve me trafik të dendur me qellim te shumefishte (rritje gjelberimi, permiresim cilesise se ajrit permes filtrimit te pluhurave, si edhe rritje e sigurise rrugore).

Veprime operacionale për përmiresimin e sistemit të transportit dhe shtimit tëpërmbajtjeve:

1. Ndertimi i një rrjeti rrugor që lidhin Shtërpcës me rajonin;

2. Permiresim i gjendjes së rrugeve ekzistuese dhe zgjerim sipas mundesise;
3. Krijim i rrjetit të plote rrugor nëvendbanmet e mëdha me përmbajtje edhe për biciklistet dhe kembesoret;
4. Permiresim i sistemit, orareve dhe cilesise se autobuzeve;
5. Permiresimi I projektimit te rrugeve me parashikimin e trotuareve te plota dhe shiritave/korsive per bicikletat sipas standarteve europiane te rrugeve;

11.3 Kriteret Mjedisore qe Kufizojne Zhvillimin Komunal

Me poshte paraqiten disa kritere mjedisore që duhet të kufizojne zhvillimin komunal, të grupuara në kater kategori kryesore, perkatesisht (1) kriteret e forta mjedisore-shendetsore, (2) kritere te trashegimise kulturore, (3) kritere peisazhike dhe (4) kritere inxhinierike dhe te infrastruktures.

Kritere të Forta Mjedisore-Shendetesore

Keto kategori kriteresh percaktojne zonat e perjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë (I) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. Parqet nacionale), (II) zona të rrezikshme për zhvillim, dhe (III) zona të ndotura të njohura si "hot-spote" mjedisore (psh. mbetje kimike).

(**I**) Zonat me vlera të veçanta mjedisore përfshijnë:

- Zonat e mbrojtura në PN "Mali Sharr";
-Zona me vlera të larta floristike dhe vegjetative (Bimet endemike dhe asociacionet endemike si ai *Rhododendron – Pinetum peucis*
-Zonat me llojeve organike të cilat janë në "listën e kuqe" të Evropës;
- Kalaja mbi Brezovicën - Çajlia, Brezovicë
- Zona përgjat lumit Lepenc

Nuk lejohen ndertimet në zonat e mesiperme që bartin vlera të veçanta mjedisore.

(**II**) Zonat e rrezikshme për zhvillim përfshijnë:

- Shtrterit e lumejve dhe pjeset buferike rreth tyre (lumi i Lepencit)
- Zonat me pjerresi më të madhe së 15 apo 20%

Nuk lejohen ndertimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmbytjeve (qofte dhe shume të rralla), mund te shkaktojne erosion të brigjeve, si dhe të cenojnë rregjimin hidrogjeologjik te sistemit ujor.

Ne menyre të ngjashme, nuk lejohen ndertimet ne zonat me pjerresi të madhe pasi në mjedis argjilor keto ndërtime mund të shkaktojne (ose përkeqesojnë) situatë erodive të kodrave dhe janë një rrezik publik i përhershëm. Në ketë fazë të Planit Zhvillimor Komunal është vështirë të përcaktohen me detaje këto zona, por gjate hartimit të këtij plani është punuar një planë me pjerrëtësi dhe gjatë zhvillimeve të ardhëshme mundë të superpunohet me informata tjera dhe të shfrytzohet si bazë për plane rregulluese dhe projekte tjera.

(**III**)Zona të ndotura të njohura si "hot-spote" mjedisore (psh. mbetje kimike) perfshijne:

- Deponia e e egra pëgjat lumenjve dhe kanalizimet që derdhen drejt per drejt ne lumenj.
- Thertore
- Nderrmarja e riparimit të automjeteve

Këto zona duhet të jenë objekte të studimeve për vlersimin e situates mjedisore mbi bazen e te cilit do te mund te gjykohet mbi nivelin e ndotjes së ujit dhe tokes dhe masat eventuale qe duhen nderrmare për rehabilitimim.

Kritere të Trashegimise Kulturore

Komuna e Shtërpcës ka objekte të trashegimise kulturore që duhen ruajtur për vlerat e tyre kulturoredhe potencialin turistik në të cilat nuk duhet të lejohet zhvillimi i pakontrolluar.

Vlerat e trashegimisë kulturore duhen të konsiderohen rast pas rasti me qellim rinovimin e objekteve në funksion të vlerës së tyre tradicionale, zhvillimin eqendrueshëm në përputhje me funksionin e tyre kryesor.

Zona arkeologjike e Kalase së Brezovicës Çajlia, Brezovicë duhet ruajtur si zone me vlera arkeologjike dhe turistike. Sugjerohet vijimi i kërkimeve arkeologjike dhe zhvillimi në respekt të funksionit kryesor kulturor. Duhet që zona arkeologjike e Kalaja mbi Brezovicën - Çajlia, Brezovicë të bëhet e vizitueshme nga publiku (zone kembesore) dhe mundesisht të krijohen elemente turistike që rrisin vlerat e kalasë, psh. muze, dyqane suveniresh, dyqane tradicionale dhe të veçanta, zona sherbimi, etj.

Objekti kulturor Trashëgimia kulturore të rëndësisë së veçantë:

Kalaja mbi Brezovicën - Çajlia, Brezovicë, Kisha e Shën Nikollës e shekullit XVI- Gotovushë, Kisha e Shën Nikollës e shekullit- Shtërpcë, Trashëgimia kulturore me rëndësi të madhe: Pllaka e gurit me varrëzën të Kisha e Shën Gjergjit-Bitia e Epërme, Kisha e Teodorit të Shenjtë nga shekulli XVI- Bitia e Poshtme

Trashëgimia kulturore e evidentuar Varreza e fshatit „Crkvisha“, Vërbeshticë

Kisha e Shën Ilijës- Vërbeshticë, Kisha e Shën Arangjelit nga shekulli XVI dhe XVII- Sevcë, Kisha e Shën Nikollës nga shekulli XVI- Sevcë, Kisha e Shën Premtit nga shekulli XVI, Jazhincë, Xhamia e fshatit- Bitia e Epërme, Kisha e Shën Premtit- Berevcë, Kisha e Shpëtimtarit të Shenjtë- Gotovushë, Kisha e Shën Virëgjëreshës së Shenjtë- Gotovushë, Kisha e Shën Mladenci- Drajkoc, Kulla e Imbrahim Mulës nga shekulli XIX, Firajë

Sugjerohet zhvillimi në respekt të funksionit kryesor kulturor. Duhet që Manatiri tëë bëhet e vizitueshme nga publiku

Lista e monumenteve te kultures do duhet rishikuar dhe lehtesuar ndjeshem. Disa prej monumenteve te kultures jane cenuar, tjetersuar apo zhdukur. Disa prej monumenteve kane qene shpallur per motive qartesisht politike dhe lista duhet avancuar.

Ka disa zona tradicionale me vlere konservimi qe mund të mbrohen. Duke pasur vlera të ndërtimit tradicional, këto zonaturistike duhet ruajtur me karakter të veçant.

Kritere Peisazhike

Komuna e Shtërpcës ka vlera të larta pejsazhike të llojeve të ndryshme si peizazhe që krijonë pyjet dhe Malet e Sharrit, livadhet alpike dhe subalpike, pyjet e Verrit të Zi përgjat lumit Lepenc dhe disa prruckave liqenjt e zonave të larta. Kriteret peisazhike jane më të vështirë për të përcaktuar pasi duhen konsideruar rast pas rasti dhe duhen caktuar në bashkepunim dhe pajtueshmeri me institucionet tjera.

Zona me vlera te larta peisazhike në të cilat nuk duhet te lejohet ndertimi perfshijne:

- Lumin e Lepenc në pjesen më të madhe të segmentit që përshkon i pasur me peizazhe atraktive.

- Peizazhet bujqësore, përgjat zonës së lumit Lepec, dhe
- Peisazhet ne në PN "Mali Sharr"

Bukuria e peizazhit është pasuri për turizmin. Për t'i mbrojtur sa më mirë, intervenimet e njeriut në pikat skenike-atraktive, duhet të minimizohen. Posaçërisht, në zonat e dedikuara për zhvillimin e turizmit.

Duke pasur parasysh se Ligji i Planifikimit ngarkon komunat me përgatitjen e planeve hapesinore, nderkohe që Shtërpcë edhe se ka përgatit ketë planë duhet që të gjejë mirekuptim dhe bashkepunim me Institucionet tjera kompetente dhe akterët tjer për nevojen e mos-lejimit te ndertimeve në keto zona, qofte duke e sanksionuar kete edhe me akt-normativ.

Kritere Inxhinierike dhe të Infrastrukturës

PZHK-ja duke trajtuar shfrytzimin e tokës, mjedisin, nfrastrukturen dhe fushat tjera si ajo e zhvillimit ekonomik dhe socialofron një mundësi të zhvillimeve të qëndrueshme nëse merr në konsideratë posaçërisht sistemin inxhinierik dhe nevojat e infrastruktures së komunës si pjesë integrale dhe i trajton në sistemin multishtresor për të menjanuar konfliktet eventuale dhe ofruar zgjidhje të qendrueshme.

Duke qenë se Transportit mbeshtet kryesisht në cilësinë e transportit publik me autobuzë dhe promovim nëpër vendbanime edhe shfrytzimin e bicikletave dhe udhtimin këmbë, PZHK-ja duhet të marre parasysh tipin e sistemit rrugor të planifikuar dhe ndertesat qe mund te ngrihen duhet te respektojne nje largesi te mjaftueshme nga sistemi rrugor, perfshi trotuaret apo korsite e bicikletave sipas rastit.

Në mënyrë të ngjashme, projekti i vendndosjes së kolektorit të ujrave të ndotura, trajtimit të përkohëshëm të ujrave të ndoturanë nivel komunal,tëvendbanimeve apo të lagjeve (sipas Planit per Ujin dhe Trajtimin e Ujrave te Ndotura brenda PZHK-së) duhet zbatuar atë që është përfshirë në PZHK-në, dhe ajo përmbajtje duhet evidentuar në sistemin GIS-it. Edhe ndërtimet e mundshme duhet të respektojnë një largesi të pranueshme. Sistemi ujësjellsit dhe kanalizimit duhet monitoruar për të parandaluar rrjedhjet, rinovuar sipas nevojes dhe futur nëntoke sipas standarteve dhe duke u shenuar problemet në sistemin GIS që shoqeron PZHK-në.

Gjithashtu, linjat e transmetimit të energjisë, dhe ato të telefonise fikse do duhet të rekonstuohen,avancohen dhe sa më shumë të futen nëntokë dhe të shenohen në sistemin GIS-it që shoqeron PZHK-ja. Natyrshem ndërtesat e reja do duhet të respektojne distance të pranueshme nga keto linja. Antenat e telefonise celulare nëpër vendbanime është mire të jenë të grupuara dhe jo të shperndara, megjithese kjo çështje është e veshtire të trajtohet në kuader te PZHK-së. Mendojme qe problemi i antenave duhet të jetë objekt i një studimi të veçantë, përfshirë ndikimin eventual në shëndetin e njeriut.

Duke pasur parasysh që mbetjet mbeshteten në sistemin e trajtimit të mbetjeve sipas hierarkise Redukto-Riperdor-Riciklo-Djegie-Vend depozitim duhet që PZHK-ja të pasqyroje ketë parim dhe të planifikoje zonat e pershtatshme për vendndodhjen e zones së riciklimit dhe mundesisht të parashikoje zona qe mund të perdorën për djegie apo pikë transiti për të ardhmen, duke konsideruar me perparesi ndikimin ne mjedis.

12. NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE

Plani Zhvillimor komunal i Shtërpcës dhe Zgjidhjet e Parashikuara për Problemet e Mjedisit

PZHK-ja është rezultat i evidentimit, vlerësimit, dhe prioritizimit të nevojave strategjike zhvillimore sociale-mjedisore të Komunës së Shtërpcës dhe komunitetit të saj nga ana e Grupit hartues të Planit Zhvillimor komunal. PZHK ka si qëllim transpozimin dhe sendërtimin e Vizionit, të këtyre objektivave dhe prioriteteve strategjike në një sistem planifikimi zhvillimor komunal. Në një proces të tillë të rëndësishëm, ky itinerar do të mbështetet nga hartimi i planeve tjera të vendbanimeve dhe zonave ndërtimore të niveleve më të ulta dhe kodeve me instrumente të veçanta zhvillimi hapësinor, sipas gjithë komponentëve të vet: ekonomikë, socialë, mjedisorë. Këta instrumente përbëjnë një ndërthurje të programeve të veprimit me nismat investuese, me qëllim orientimin e zhvillimit komunal në zonën e përfshirë në studim.

Plani merr në konsideratë dhe përgjithësisht është në përputhje me planet e ndryshme të nivelit më të lartë, si dhe në linjë edhe me shtyllat kryesore të zhvillimit të Planeve Sektoriale, Planet dhe projektet Sektoriale që hartohen edhe si rezultat i këtij plani duhet të bëjnë ose të parashikojë të përfshijë vlerësime të kostove dhe të identifikojë ose përfshijë identifikimin e masave të nevojshme që duhen ndërmarrë për implementimin e këtyre propozimeve. Propozimet për zhvillimin zonave, rrugëve etj përfshihen si në propozimet për përdorimin e tokës, ashtu edhe për ndarjen në faza, pasi duhet që të ruhen apo të gjenden sipërfaqe toke për zhvillimin e zonave, ndërtimin e rrugëve etj, për sa kohë që mundësia e aksesit shihet si mekanizmi kryesor që drejton zhvillimin.

Një qështje tjetër që PZHK trajton është edhe PN "Mali Sharr" dhe qendrat e skijimit, si dhe janë marrë masa adekuate për mbrojtjen e zonave të mbrojtura në PN "Mali Sharr".

Si rezultat, PZHK do të shërbejë edhe si një proces i cili mundëson adresimin e shumë prej problemeve mjedisore të. Kryesisht duhen investime në infrastrukturë dhe përmirësim i menaxhimit komunal me qëllim që t‟u jepet përgjigje shumë prej problemeve mjedisore të hapësirës komunale të marrë në studim, ndërsa procesi i planifikimit të zhvillimit të zonave dhe shfrytëzimit të tokës duhet zbatuar sipas këtij plani, me qëllim që të parandalohet shtrirja e mëtejshme nëpër zonat bujqësore dhe zonat me vlera tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore.

Kjo nevojë për planifikim dhe menaxhim në nivel vendbanimesh të shumta bashkërendimi dhe veprimi në mess tyre është identifikuar si çështje e rëndësishme edhe në raportet e PZHK. PZHK gjithashtu propozon masa për mbrojtjen e zonave ekzistuese të gjelbra dhe ujërave brenda dhe rreth territorit komunal dhe ka përgatitur planin e masave për zhvillimin e tyre të qëndrueshëm. Këtu përfshihen zonat e ujrave sipërfaqsore, përgjatë lumenjve, dhe
nëpër vendbanime.

Konsiderata Mjedisore në Hartimin dhe Përpunimin e Planit

Plani është punuar duke pasur në konsiderat edhe vlerësimin mjedisor në çdo fazë të zhvillimit të tij. Megjithëse nuk është qëllim kryesor për PZHK-në, outputet e fazës së parë të studimit të PZHK-së (faza e profilit komunal) përmbajnë të dhëna dhe komente të konsiderueshme mbi gjendjen dhe problemet e mjedisit në Shtërpcës. Gjatë fazave te zhvillimit të PZHK-së merren në konsideratë çështje mjedisore apo të ofrimit të shërbimeve dhe diskutojn gjendjen dhe shkakun e problemeve mjedisore në Komunë.

Gjitha zhvillimet e planifikuar të cilat kanë ndikim në mjedis janë marrë në konsiderat duke i ruajtur të gjitha komponentet mjedisorenë aspektin strategjik të zhvillimit të komunës. Gjatë planifikimit gjithmon janë ruajtur korridoret e qarkullimit të shtazëve dhe bimëve nga një ekosistem në tjetrin, janë ruajtur ekosistemet të cilat kanë një rëndësi të veçant për Komunën dhe për Kosovën, janë marr në konsiderat ruajtja e zonave të mbrojtura.

Analiza e Plotë e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të PZHK-së

Masat të cilat janë marrë për mbojtje të mjedisti gjat planifikimit nuk do të kenë efekte negative ekonomike apo shëndetësore dhe mjedisore. Për këtë arsye, është e vështirë që të matet saktësisht nga pikëpamja sasiore shkalla e ndikimit që do të ketë plani mbi mjedisin apo shëndetin. Megjithatë, prirjet e këtij ndikimi, te cilat jane edhe objekt i VSM, janë të parashikueshme. Për të siguruar vlerësimin e plotë të ndikimit të mundshëm mjedisor të planit, fillimisht është e nevojshme të përcaktohen të gjithë faktorët të cilët mund të ndikohen nga ky plan. Tabela e mëposhtme shërben si një listë e kontrollit të e kritereve mjedisore sipas të cilave është bërë vlerësimi i këtij plani. Kjo listë tregon nëse PZHK-ja e ka marrë në konsideratë problemin, e po të jetë kështu, nëse i ka dhënë përgjigje. Kolona e fundit shpjegon nepermjet shenjave si më poshte:

- Atje ku PZHK-ja i jep përgjigje të plotë problemit është vendosur treguesi √;
- Në se PZHK-ja e ka trajtuar problemin, por ka nevojë për masa të mëtejshme vendoset treguesi ?;
- Në se ka problem i cili duhet të trajtohet nga PZHK-ja, vendoset treguesi X.

Tabela:20. Konsiderata Mjedisore dhe Shëndetësore të PZHK-së			
Kriteri përkatës	A është marrë parasysh në PZHK ?	Si është trajtuar problemi në PZHK ?	Treguesi
1. Përfshirja e konsideratave mjedisore	Po	Përfshihen në seksionet e mëposhtme.	√
2. Përfshirja e konsideratave shëndetsore	Po	Përshkruhen në seksionet e mëposhtme	√
3. Marrja parasysh e objektivave ndërkombëtarë, kombëtarë dhe lokalë për mjedisin dhe shëndetin gjatë formulimit të PZHK-së	Po	Merren fort në konsideratë në procesin e hartimit të PZHK-së	√
4. Përfshirja në sintezë e Konsideratave Mjedisore	Po	Janë përfshirë në PZHK	√
5. Konsideratat mjedisore në Opsione	Po	Kjo është bërë si pjesë e procesit të VSM .	√
6. Koncepti i Planifikimit të PZHK-së			
a. Mbështetje për zhvillimin policeentrik të Shtërpcës	Po	Propozimi ndjek në mënyrë pragmatike prirjet ekzistuese dhe ato strategjike të zhvillimit komunal dhe socialo ekonomik të Shtërpcës. Problemi është që kjo rritje të bëhet mbi bazën e kritereve të forta mjedisore, dhe të mos shtrihet në tokat bujqësore dhe pyjet përreth.	√
b. Afirmon rolin e Shtërpcës në nivel të Kosovës, dhe në nivel ndërkombëtar krahas ofrimit të mundësive të turistike me qendren e re turistike	Po	Orientohen drejtimet e konfirmimit te Shtërpcës si qender dhe si pike fokale per te gjitha anet e vendit në kuptimin e zhvillimit të turizmit dhe fuqizimit të trashëgimis së Kosovës me vlerat e zonave të veçanta.	√
d. Përforcimi i kapacitetit të Komunës për të thithur banorë të rinj dhe për t‟u siguruar atyre mundësi punësimi	Po	Kjo propozohet të bëhet nëpërmjet zgjerimit në hapësirë në vendbanimet që kanë trende rritje dhe ofrimit të kushteve edhe në vendbanimte tjera	√
e. Integrimi i zonave		Është patur në konsideratë që në fazën e nismës së hartimit të PZHK-së.	√

rurale në komunë dhe ulja e shkallës së përjashtimit ekonmik dhe social të banorëve të tyre	Po		
f. Fuqizimi dhe zgjerimi i vendbanimeve brenda kufinjve ndërtimor të planifikuar	Po	Ky koncept ka si qëllim të ndihmojë zhvillimin dhe rigjenerimin e vendbanimeve në sistemin policentrik. Ai përfshin propozime mjedisore në formën e ruajtjes së zonave të gjelbra edhe përtej kufijve ndërtimor të vendbanimeve	√
g. Strukturimi dhe ekuilibrimi i zhvillimit komunal rreth nën-qendrave të reja	Po	Ky propozim ka si qëllim zhvillimin e nënqendrave të tjera për të ulur stresin në një zonë qendrore. Si i tillë, ai propozon ndërtimin e një serie funksionesh nëpër këto nënqendra. Megjithëse kjo është pozitive për qendrën administrative të Shtërpcës sot, mund të krijojë probleme lidhur me inkurajimin e shtrirjes së mëtejshme të infrastrukturës së nevojëshme.	?
h. Fuqizimi i korridorit industrial në dalje të Shtërpcës në përgjigjje të potencialeve dhe nevojave të reja ekonomike	Po	Ky koncept ka si qëllim të mbështesë por dhe ridimensionojë atë që po ndodh aktualisht, kur kjo rrugë regjionale ose ky korridor po zhvillohet pak më shpejtë dhe intensitet më të theksuar nga zonat tjera.	√
i. Potencimi i një dimensioni të ri në nivelin komunal siç është ai i Brezovicës dhe PN "Mali Sharr", në përgjigje të potencialeve dhe nevojave të reja ekonomike	Po	Vizion i ri ka për objektiv të gjejë hapësira të reja për zhvillimin dhe integrimin e Brezovicës dhe PN "Mali Sharr", si një fuqi ekonomike për Shtërpcën dhe nivelin e Kosovës.	√
j. Ruajtja e akseve të Lumenjve (lumit Lepenc)	Po	Ky koncept dhe kjo ndërhyrje ka për objektiv inserimin e disa zonave ujore brenda hapëirës së Shtërpcës, dimesionimi i zonës sipas kritereve mjedisore, dhe zgjidhja e një problemi të fortë mjedisor të zonës	√
k. Përmirësimi i shërbimeve publike dhe aksesit ndaj transportit në zonat rurale	Po	Po, por duhet arritur një ekuilibër mes aksesit të përmirësuar dhe inkurajimit të zhvillimit të mëtejshëm te ndertimeve rurale në zonat ku kjo gjë mund të mos jetë e dëshirueshme.	√
7. Ndikimet në klimë			
a. Përshtatja me	Po. Nuk është objekt parësor i	a. Përshtatja me ndryshimet globale	√

ndryshimet globale	parashikuar nga TeR, por në studimin mjedisor janë integruar objektiva dhe instrumenta zbatimi të cilat shkojnë në këtë drejtim si ai i uljes së "gjurmës së karbonit" të komunës.		
b. Marrja parasysh e ndryshimeve lokale	Po	Përfshihet si tregues mjedisor,por nuk trajtohet në mënyrë parësore.	?
8. Demografia			
a. Problemet e evolucionit demografik	Po	Njeh faktin se kjo është ende e vështirë për t"u parashikuar saktë. Megjithatë, mund të ketë nevojë për më shumë fleksibilitet ,për t"i lënë hapësirë ndryshimeve të mundshme.	√
b. Skenarët e zhvillimit demografik	Po	Merr parasysh faktin që popullsia mund të rritet jo edhe aq shumë deri në vitin 2025. PZHK mban larg presionit demografik zonat me ndjeshmëri mjedisore.	√
9. Zhvillimi dhe shfrytëzimi i Tokës			
Kriteri përkatës	**A është marrë parasysh në PZHK?**	**Si është trajtuar problemi në PZHK?**	**Treguesi**
a. Planifikimi komunal dhe Drejtimi i Zhvillimit	Po	Njeh nevojën për pranimin e zhvillimit aktual, përveç zonave ku mund të shkaktohen probleme mjedisore	√
b. Kapacitetet mjedisore në zonat dhe vendbanimet e propozuara për zhvillim	Po	Vlerësohet se vetëm në disazona si ajo ku shtrihet deponia e materialeve të lëngta te miniera, gurthyesit ka një gjurmë të cenimit ekologjik, duke e rrezikuar kapacitetin e saj mjedisor. Ndërsa në vendbanime nuk ka një gjurmë të cenimit ekologjik, duke qenë brenda kapaciteteve mjedisore. Zona e propozuara për zhvillim industrial apo ekonomik shtrihet në tokën jobujqësore dhe propozohet studimi i VNM-së së veçant për aspektet tjera mjedisore ndërs në vendbanimet brenda konceptit policentrik vrehen tendencat e shtrirjes në kategorinë "tokë bujqësore" të konvertuara vonë në zona informale, por edhe këtu tentohet të ruhet sa ma shumë	√

		tokë bujqësore dhe kompaktsim sa ma i madhë i zonës ndërtimore.	
c. Zhvillimi i parqeve dhe hapësirave të reja të çlodhëse	Po	Njeh problemin e mungesës së tokës për ketë qëllim vetëm brenda vendbanimeve dhe propozon mbrojtjen e zonave të gjelbra dhe parqeve duke krijuar një Kurorë të gjelbër të përbërë nga disa zona dhe sisteme kodrinore malore të mbrojtura. Megjithatë, për të gjithë këta elemente, përfshirë dhe zonat që gjendën brenda vendbanimeve dhe në zonat jashtë tyre janë të përcaktuara kufijtë, duhen marrë vendimet përkatëse për shpalljen zona të interesit komunal, dhe duhen aprovuar Planet e Menaxhimit lidhur me zhvillimet brenda këtyre kufijve.	?
d. Zhvillimi i parqeve të reja brenda vendbanimeve policentrike	Po	Edhe se pjesërisht e thamë më lartë se njohim problemin e mungesës së tokës brenda zonës së vendbanimeve poliicentrike PZHK propozon një varg masash për rritjen e sipërfaqes së gjelbër. Masat duhet të konkretizohen me veprime për çdo kategori zonash në vedbanime.	?
e. Mbrojta e pyejeve, gjelbrimeve dhe parqeve ekzistuese	Po	Njihen problemet dhe bëhen propozimet përkatëse, dhe për Pyjet, hapësirat e gjelbra duhet çuar përpara statusi i tyre dhe duhet hartuar dhe aprovuar Plani i Menaxhimit të tyre por edhe Parqet ekzistueseduhet trajtuar në mënyren adekuate në tërë territorin e komunës.	√
Kriteri përkatës	**A është marrë parasysh në PZHK?**	**Si është trajtuar problemi në PZHK?**	**Treguesi**
f. Zhvillimi i zonave të reja komunale	Po	Nxitet ky zhvillim veçanërisht në fushen e hapsirave dhe terreneve sportive, për të lehtësuar presionin në. Disa vendbanime me zhvillime të reja janë tashmë të me elemente urbene . Ekziston rreziku që të mund të inkurajojë shtrirje të mëtejshme jashtë kufijve ndërtimor, dhe për këtë shkak VSM ka sugjeruar shpalljen e kufizimit të ndërtimeve në këto drejtime të komunës. Mund të shkaktojë humbje të mëtejshme të tokës bujqësore.	?
g. Industritë	Po	Përdorimi i zonës me kualitet të dobët të tokës mbi Shtërpcë për zonë Industriale si zona prioritare për zhvillim. PZHK i përputhet me parimet strategjike ku aktivitetet ekonomike që shkaktojnë ndotje	√

		nuk do të lejohej dhe do të dekurajohen.	
i. Shërbimet dhe lehtësirat Publike (shkolla, stadiume sportive)	Po	Propozon norma dhe nevojën për to në komunën e Shtërpcës.	√
h. Pyjet, Kodrat dhe parqet	Po	Trajtohen si zona të mbrojtura për pyje dhe parqe. Dekurajohet me forcë ndërtimi në kto zona për pos kur është definuar me ketë planë. Vija problematike shtrihet rreth rrugës regjonale ku kërcnohet zona e shiritit të gjelbër dhe fillon edhe depërtimi në kodra. Duhet të trajtohen zonat prioritare edhe nga pikëpamja e peisazheve pra e pikave panoramike me rëndësi peizazhistike dhe turistike për komunën.	?
Kriteri përkatës	**A është marrë parasysh në PZHK?**	**Si është trajtuar problemi në PZHK?**	**Treguesi**
k. Forma e vendbanimeve dhe dendësia	Po	Propozime konkrete në kodin e zonimit për lartësinë e ndërtimeve. Ato bazohen në ruajtjen e formës së vendbanimeve, mbushjen e zonave me densitet të ulët, dhe identifikimin e zonave ku do të lejohet zhvillimi i ndërtimeve në lartësi.	√
l. Mbrojtja e detajuar e Zonave të Gjelbra			
m. Lumenjtë	Po	Të kthehen në korridore të gjelbër, por ndërkohë duhen përcaktuar kufijtë e shtratërve të lumejve dhe të hartohet Plan Menaxhimi dhe Monitorimi mjedisor	?
n. Parqet dhe zonat e mbrojtura			
a) Kombëtare	Po	PN "Mali Sharr" janë të përcaktuar kufij me planin e Parkut Nacional por duhet të hartohet Plan Menaxhimi dhe Monitorimi në kuptimin e zhvillimit mjedisor dhe afirmimin	?
b) Të reja	Po	Sugjerohet një seri Parqesh dhe zonave të rëndësisë komunale, por mbetet problemi i Planeve të Menaxhimit të tyre pasi që kufijët janë caktuar me PZHK.	?
o. Brezi i gjelbër	Po	Në zonat përgjat rrugëve magjistrale, zonat industriale dhe zhvillimet tjera.	√
p. Pjesa e brendshme e vendbanimeve	Po	Jepen standardet për zonat lokale. Njihet problemi i mungesës së hapësirës për rritjen e sipërfaqeve të gjelbra apo për zona komunitare si sheshe, kënde lojërash, etj. dhe bëhen propozime në lidhje me	√

		instrumentet planifikues në planet e detajuara vendore.	
q. Zona të reja	Po	Zonat e reja me përdorime të ndryshme propozohen të kthehen në zona të gjelbra dhe parqe.	√
10. Rreziqet natyrore apo humane			
a. Rreziqet natyrore në tërësi	Po	Trajtohen në përgjithësi, por ka nevojë për vëmendje më të madhe.	?
b. Rrëshqitjet e tokës	Po	Trajtohen në mënyrë specifike, sepse jepen standartet kufizuese për pjerrësitë e mëdha.	?
c. Përmbytjet	Po	Nuk jepen masa sesi do të trajtohen, ceket se nuk ka te dhena per permbytje në këto zona Sugjerohet vetëm si një tregues i mundshëm.	?
d. Tërmetet	Po	Në kodet e ndërtimit, por nuk gjen zbatim retrospektiv tek ndërtesat ekzistuese. Nuk ka detyrime për ndërtime me dalje emergjence në rast tërmeti.	?
Kriteri përkatës	**A është marrë parasysh në PZHK?**	**Si është trajtuar problemi në PZHK?**	**Treguesi**
c. Të ardhurat e ulëta	Po	Njeh problemin se strehimi në ndërtesa të reja të ligjshme është i mundshëm vetëm për grupet me të ardhura të larta. Rekomandon nevojën që të ndërmerren politika sociale të strehimit.	√
d. Cilësia	Po	Kerkohet miratimi dhe respektimi rigoroz i kodeve te ndertimit.	
e. Shkalla sizmike	Po	Rekomandon kritere projektimi në përputhje me nivelin 8 në shkallën MSK-64[21], pasi ky është një rrezik i njohur. Do të ishte mirë të sugjeroheshin projekte sipas Shkallës Evropiane Makrosizmike (EMS) për të respektuar standardet Evropiane.	?

Masat e Nevojshme në PZHK-ë për Mbrojtjen e Mjedisit


Tabela e mësipërme përmban një analizë e cila jep rekomandime të mëtejshme. Kriteret që janë shënuar me shenjën √ nuk diskutohen më tej, pasi nuk konsiderohen si problematikë. Tabela e mesiperme përmban një përmbledhje të të gjitha problemeve mjedisore dhe shkallën në të cilën plani u jep përgjigje secilit prej tyre. Megjithatë, një nga pikat e tabelës së mësipërme që ka të bëjë me skenarët dhe parashikimet e rritjes së popullsisë, megjithëse është trajtuar, ka nevojë për diskutim të mëtejshem.

Konceptet Urbanistike të Përdorimit të Tokës, përfshi Zhvillimin e Qendrave

Problem me përmasa ireverzibile për komunën e Shtërpcës është shtrirja e ndërtimeve në drejtim të PN "Malit Sharr", poashtu edhe ato ndërtime të cilat bëhen, nuk kanë ndo një kriter të përshtatjes me mjedisin natyrorë, problem tjetër mjedisorë është edhe shtrirja e ndërtimeve në tokat bujqësore sidomos në zonën kadastrale të Shtërpcës në drejtim të Gotovushës.

Harta e mëposhtme tregon destinimin e propozuar të tokës për vitin 2028. Ktu prezantohen edhe kufijt e rij ndërtimor edhe zhvillme tjera. Kjo do të sjellë humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht do të sigurojë ruajtjen e pjesës së konsiderushme të tokes me plleshmëri, tokës së pasur me resurse, të kodrave dhe pyjeve. Kemi te prezantuar edhe zonat e shënuara me ngjyrë e cila potencialisht mund të paraqesin pikat e nxehta mjedisor.

Konfliktet e mundshme për hapsira mund të adresohen vetëm nëpërmjet zbatimit më të mirë të këtyre planeve. Masa e parë duhet të jetë arritja e një marrëveshje për mbrojtjen e këtyre zonave, e cila duhet të ndiqet nga plane rregulluese dhe tjera për komunën, të cilat do të viheshin më pas në zbatim. Kjo është një sfidë e madhe për qeverinë komunale, gjë që pranohet edhe në Planin Zhvillimit Komunal të Shtërpcës. Janë organizuar takimet e para me komunitetin për të filluar këtë proces. Rreziku kryesor mjedisor do të ishte në se nuk arrihet marrëveshja për një vizion të përbashkët për Shtërpcës.



Harta: 22. Propozim për Shfrytëzimin e Tokës së bashku me Zonat Potenciale të Konfliktit

Tabela: 21. Nevoja shtesë për tokë në PZHK, Aktivitete Vende pune në 2022 Sip. e nevojshme Sip ekzistuese Zonat shtesë që duhet të krijohen

Aktivitete	Vende pune në 2022	Sip. e nevojshme	Sip ekzistuese	Zonat shtesë që duhet të krijohen
Industri dhe magazina (35%)		30 ha	16 ha	**ha**
Përdorime komerciale		18ha	14 ha	**ha**

Tabela e mësipërme pasqyron nevojat për tokë shtesë, me qëllim akomodimin e vendeve të reja të punës dhe një numër të banorëve të rinj deri në vitin 2022. Kjo do të kërkojë një sipërfaqe toke rreth 50 ha, e cila është planifikuar si në hapësirat bosh të komunës së Shtërpcës, ashtu edhe në zhvillimet e tokave të reja, në drejtimet e konsideruara si të drejtimetë përshtatshëm nga ana mjedisore. Në Kosovë e veçanërisht por edhe në Shtërpcës, shtrohet problemi i përmirësimit të kapaciteteve mbajtëse mjedisore nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të planeve të qëndrueshme (ky është një nga synimet edhe të PZHK-së), përmirësimit të menaxhimit komunal dhe investimeve në infrastrukturën e mjedisit.

Rritja e Shtërpcës besohet se do të vazhdojë, e në fakt sa më shumë sukses ekonomik të prodhojë Komuna e Shtërpcës, aq më shumë do të përshpejtohet rritja e saj. Kjo do të ishte e dëshirueshme dhe është në të mirë të Kosovës. Duke supozuar se realizohen investimet në infrastrukturën mjedisore dhe menaxhimi efektiv komunal Komuna e Shtërpcës ka mundësi të akomodojë një numër shumë më të madh popullsie, turist. Burimet ujore mund të ka të mjaftueshme. Kapaciteti mjedisor mbajtës i Shtërpcës nuk përbën problem, ndërkohë që problem përbëjnë menaxhimi dhe planifikimi urban jo-efektiv dhe nevoja për financimetë mëdha në infrastrukturën mjedisore. Plani i njeh këto probleme dhe përpiqet në mënyrë realiste të punojë brenda këtyre kufizimeve.

Ndikimi në e klimë

Nuk vëhet re se komuna e Shtërpcës me aktivitetin aktual dhe ate që do të ket në perspektivë të ndikoj në klimën globale, pasi që komuna e Shtërpcës nuk ka ndonjë industri apo objekt industrial që do të emitonte gazra të serrës në atë mas sa tëketë ndikim në klimën globale. Është e rëndësishme që të bëhen studime për të vlerësuar rritjen e temperaturës dhe faktorëve tjerëklimatik. Megjithatë skenari "mos bëj asgjë" i cili nuk ndihmon në ruajtjen e zonave të gjelbra dhe që lejon zhvillimin e pakontrolluar në mënyrë të pashmangshme do të shkaktojë një ndikim në mikroklimë, jo vetëm në rritjen e temperaturave, por edhe stuhi më të rralla, por më të fuqishme, të cilat do të shkaktojnë përmbytje.

8.3.3 Mbrojtja e Pyjeve ,Zonave të Gjelbra Ekzistuese dhe Zhvillimi i Zonave të Reja

Kodet e zonimit të propozuara nga PZHK-ja krijojnë mundësinë për struktura të gjelbra, kryesisht për përdorim të ndryshem, Pyllëzim, ripyllëzim etj. Duhen hartuar udhëzues për:

- Projekte pyllëzimi konform planit
- Projekte ripyllëzimi dhe mirë mbajtje konform planit

- Numrin e këtyre strukturave që do të lejohet dhe ku do të lejohet (apo nuk do të lejohet) ngritja e tyre;
- Përdorimin e tyre, të themi për grupe/festa të mëdha, gjë që do të kishte ndikime negative.
- Arkitekturën e tyre për të siguruar harmoninë vizuale me mjedisin rrethues në vikend zona; dhe
- Shërbimet e infrastrukturës për ofrimin e energjisë, ujit dhe menaxhimit të mbeturinave, me qëllim shmangien e ndikimeve vizuale dhe ndotjet e mundshme.

Ka deri diku zhvillim në këto zona. Duhen përgatitur propozimet lidhur me mënyrën se si do të trajtohen këto zhvillime. Plani i zhvillimit të komunës ku hynë edhe Lumejt e Shtërpcës shërbejn pikërisht për këtë qëllim.

Disa nga zonat e Shtërpcës kanë të përcaktuar në mënyrë të qartë kufijtë e zonës së gjelbër. Megjithatë, kjo çështje bëhet më komplekse në disa zona, ashtu siç tregohet edhe në Harten e zonave të mbrojtura.

Cilësia e Ajrit

PZHK-ja mundet të adresojë problemet e cilësisë së ajrit vetëm në mënyrë të pjesshme. Ndërtimi i rrugëve cilësore do të ulë trafikun nëpër vendbanime të mëdha, duke sjellë përmirësim të cilësisë së ajrit, ndërkohë që rritja e parashikuar për trafikun nëvitin 2022 do të bëjë që cilësia në përgjithësi e ajrit të përkeqësohet, veçanërisht për Pb, SOx, Nox, të cilat aktualisht janë brenda normave të BE-së dhe Kosovës. Zbatimii standardeve më strikte për çlirimet në ajër nga automjetet, permiresimi dhe kontrollii cilesise se karburanteve menaxhimi më i mirë i trafikut, perfshire perdorimin e rritur te bicikletave, si dhe furnizimi i plotë me energji (për të ulur përdorimin e gjeneratorëve)ka shumë gjasa të ngadalësojnë përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit për njëperiudhë afat-shkurtër deri në afat-mesme. PM10 mund të reduktohet nëpërmjet përdorimit të teknikave më të mira të ndërtimit dhe shtrimit të më shumë rrugëve. Duhet bërë vlerësimi i ndikimit të cilësisë së keqe të ajrit mbi shëndetin dhe ekonominë nëpërmjet llogaritjes së shkallës së semundshmerise me qëllim vlerësimin sasior tedemit në shëndet dhe kostos ekonomike që sjell ndotja e ajrit për Komunën. PZHK-ja nuk e ka adresuar problemin e zhurmave. Megjithatë, disa nga masat eparashikuara në Plan si shtimi i numrit tampon zonave, diversifikimi i transportit publik, futjae korsive te bicikletave, furnizmimi pa nderprerje me energji elektrike dhe shmangia eperdorimit te gjenratoreve, krahas masave administrative komunës së Shtërpcës per pakesimin e zhurmave në nje kategori te mjedisve publike qe aktualisht jane aktualisht problematike, do te ndikoje ne uljen e nivelit te zhurmave, krahasuar me vlerat aktuale.

8.3.6 Propozimet për Rrugë

PZHK-ja propozon një sistem rrugësh. Me të njëjtat probleme përballen edhe rrugë të tjera të propozuara, të cilat kalojnë nëpër zona të gjelbra në të cilat janë masat adekuate për rajtejn e tyre.

Ndikimi i zonave industriale, ekonomike, komerciale në mjedis

Shtërpca ka disa zona ekonomike dhe ato turistke në qytet dhe komunë duke përfshir edhe zonën e prodhimit të energjisë elektrike. Zona shtesë me aktivitete ekonomike janë zhvilluar përgjatë aksit rrugor të rrugës Shtërpcë-Prizeren-Kaçanik dhe në disa pjesë të ndryshme në afërsi të kësaj zone, kurse zona më e madhe me aktivitete ekonomike komerciale dhe industriale të lehta është e zhvilluar për gjatë gjitha akseve rrugor.

Vlerësohet se zbatimi rigoroz i masave të parapara me PZHK dhe zbatimi i objektivave të VSM-së do të ketë ndikime pozitive në gjitha aspektet në komunën e Shtërpcës. Vlerësimi i këtyre objektivave do të mund të bëhet përmes një sistemi monitorimi, i cili do të ndjekë ecurinë e tyre gjatë gjithë kohës që shtrihet zbatimi i këtij Plani shumë të rëndësishëm për këtë Komunë. Përputhja e objektivave të VSM me zhvillimin e aktiviteteve të gjithanshme dhe shumëllojshme ekonomike –sociale është një moment i rëndësishëm për mjedisin dhe shëndetin publik. bujqësia, industria e prodhimit të energjisë, ajo e pijeve sikurse edhe ajo e ndërtimit në qytet kryesisht te banimit kolektiv, turizmi industrial me shërbimet e tij por edhe elementë të tjerë të lidhur me to, si trafiku, cilësia e karburanteve dhe e automjeteve të transportit, duhen monitoruar në mënyrë rigoroze nga institucionet përkatëse. Realizimi i këtyre projekteve dhe plotësimi i objektivave të VSM do të sjellë një përmirësim në jetën e banorëve dhe të të ardhurve si në infrastrukturë, mjedis, shërbime dhe për shëndetin publik përmes rritjes së cilësisë së ajrit, ujit të pijshëm etj.

Është shumë me rëndësi që me këtë Plan është bërë një kufizim i përdorimit të tokës për aktivitete të ndryshme ekonomike dhe industriale si dhe janë dhë disa masa dhe janë parapar disa hapsira si tampn zona që shërbejn si barierë dhe filter për partikulat dhe emitmet tjera që vinj si rezultat i aktiviteteve ekonomike dhe industriale. Zonat industriale dhe zonat tjera të karakterit ekonomik dhe komercial janë të kufizuara dhe të destinuara me PZHK, kurse kushtet tjera zhvillimore, ndërtimore dhe kushtet e veçanta dhe masa mbrojtëse kundër ndotjes dhe ndikime tjera bezdisëse për këto zona jepen me Hartën Zonale Komunale. Kurse me Ligjin për VNM dhe Udhëzimin administrative për Leje Mjedisore Komunale (LMK) parashihet të bëhen Vlerësime të Ndikimit në Mjedis për secilin objekt dhe veprimtari ekonomike dhe industriale i cili bjen në kategorit e parapara më Ligjin për VNM dhe Udhëzimin Administrativ për LMK.

Zonat e banimit

Zonat e banimit janë të kategorizuara sipas tipologjive të mëposhtme:

Zona e banimit dhe zona të shfrytezimit të perzier ku përfshihen banim me afarizëm si dhe gjithe zonimi është bërë sipas nomenklaturës HILUCS sipas direktivës INSPIRE, kjo zonë përfrshin një hapësirë të konsiderueshme dhe shtrihet në zonën urbane të Qytetit të shtërpcës. Ato janë të karakterizuara nga blloqe banimi të organizuara me hapësira të kufizuara, rrugë të gjera dhe hapësira të përbashkëta të gjera të parapara me këtë Plan, kurse me Hartën Zonale Komunale do të jepen kushte tjera zhvillimore dhe kushtet e veçanta dhe masa tjera mbrojtëse. Në këto zona lejohet edhe afarizmi dhe aktivitetet tjera komerciale por jo industriale. Këto zona dhe aktivitetet tjera komerciale dhe afariste do të jenë konform me objektivat e VSM-së dhe masat do të jenë adekuate për kufizimin e zhurmës, ndotjes dhe elementeve tjera të dëmshme të cilat kanë ndikim në shëndetin publik. Këto zona sipas Planit do të përmbajn hapësira të gjelbërta me një fond më të madh se në zonat tjera të mbulueshmërisë me gjelbërim. Është me rëndësi që kryesisht ky lloj destinimi është i shtrir përgjat rrugëve kurse në pjesën e pasme kufizohen me pjesën tjetër të banimit.

Banim kolektiv kjo zonë rezidenciale përfshin një hapësir mjaft të madhe mire të kufizuar në zonën urbane të qytetit të Shtërpcës. Kjo zonë karakterizohet kryesisht me banim me aktivitete të kufizuara komerciale si shitore dhe minimarkete të vogla që shkojnë në shërbim të banimit, por që nuk kan ndikim në ndotje dhe në ndotjen akustike dhe bezdisjet tjera. Kjo zonë karakterizohet me parqe të mdha dhe sheshe publike të cilat do të jenë atraktive për banorët dhe do të jenë në favor të mjedisit jetësor.

Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe cilesia e strehimit brenda qytetit


Plani Zhvillimor Komunal propozon masa për zhvillimin e objekteve banesore të reja në zonën periferike por edhe në zonën qendrore të kombinuara me stimuj për rikonstruim urban të banimit ekzistuese brenda qendrës. Qendra e qytetit ka përmbajtje interesante ka lumin Lepenc për mes qytetit është një kategori e veçantë që ka turizmi dhe tregtia mund të sigurojë nxitje për investimet private. Për të ruajtur karakteristikat e tyre pozitive, si hapësirat e hapura publike, llojin e ndërtimit, si dhe t'i pranojnë ato si pjesë të historisë së qytetit dhe identitetit të qytetit, Plani i prezanton parimin minimal të ndërtimit, e cila mundëson zëvendësimin i njësisë me një ndërtim të ri në gjurmë të saktë të ish ndertimit, por me kate shtesë. Plani nxit rigjenerimin e qytetit në qendër të qytetit në aspektin e aksesit të përmirësuar, hapësira të hapura, vendet e parkimit dhe mjedisin e ndërtuar. Përmirësimi i imazhit të qytetit dhe rigjenerimin e hapësirës së hapur edhe të bëhet përmes vazhdimit e mëtejshëm të projekteve komunale. Natyrisht ritmi për përmirësimin e banimit do të varet nga ecuria e përgjithshme e ekonomisë së qytetit të Shtërpcës.

Krijimi i një rrjeti të hapësirave të gjelbra dhe të hapura


Plani parashe zhvillimin e një rrjeti të integruar hapësirë të hapur që i referohet gjithë qytetin. Hapësira e gjelbër në shkallë të gjerë të qytetit, të krijojë një entitet të vazhdueshëm fizik dhe mjedisore. Plani synon të maksimizoj qasje në shkallë të gjerë hapësirave të gjelbra, duke siguruar një koleksion të korridoreve të gjelbra dhe promovimin e biçikletave dhe këmbësorëve zonave. Për më tepër, hapësira nivel lagjeje të hapura do të duhet të rehabilitohet si kopshte xhep, në zonat e banimit të periferi të qytetit dhe në komplekset e banimit kolektive të banimit. Plani mbron kanaleve të ujit që ekzistojnë sot në periferi të qytetit. Pas zgjerimit të banimit dhe integrimin e zonave tjera të qytetit, këto kanale mund të zhvillohet në hapësira të gjelbra lineare dhe zonat rekreative që do të lidhin lagjet dhe dukshëm të përmirësuar imazhin dhe mikroklimë e zons së banimit dhe pritjet do të jenë rigjenerimi i mjedisi urban dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe mikroklimës urbane.

Ndikimi i Planit në Ekosistemet natyrore

Në disa zhvillime të cilat janë planifikuar ka disa ndikime të cilat janë të kthyeshme dhe të riparueshme. Në PZHK janë propozuar masa kundër zhurmës dhe masa kundër ndotjes në pjesët ku ndjeshmëria në ekosisteme është e lartë pasi që siç dihet se Komuina e Shterpcës ka natyr mjeft sensitive dhe zona me sensitivitet te larte. Ekosistemet ku atakohen janë ekosisteme pyjore të zonave të larta dhe në disa korie (zabele) ne zona te ulëta dhe në disa pjesë ekosisteme lumore por që ndikimi nuk është shumë i madh. Ndërkaq Plani parashe edhe projekte të cilat kanë ndikim pozitiv në ekosisteme siç shihen në hartat më posht.



Harta 23.
Ndikimi i PZHK-së në ekosistemet natyrore



Harta. 24. Parashikimi i ndikimeve të PZHK-së në aspektin hapësinore.

13. EFEKTET KUMULATIVE

VSM-ja nuk do të kufizohet vetëm në analizën e elementeve individuale të planit, por duhet të bëjë gjithashtu edhe një vlerësim të përgjithshëm në vazhdën e të gjitha aktiviteteve dhe politikave të cilat përfshihen në Planin Zhvillimor Komunal të Shtërpcës.

Komponentët mjedisore	Elementet e PZHK-së						Vlerësimi i efekteve kumulative
	Qendra e re e Skijimit dhe ekzistuesja	Rrugët e planifikuara	Zonat e planifikuara të ndërtimeve	Zonat ekonomike dhe industrial	Masat kufizuese për vikendzonat	Pyllëzimi	
Shëndeti i popullatës njerzore	+	0	0	-	+	+	Pozitive
Burimet natyrore dhe Ekosistemet	0	0	0	0	+	+	Pa ndonjë efekt domethënës
Toka	0	+	+	-	+	+	Pozitive
Uji	0	0	0	0	+	+	Pa ndonjë efekt domethënës
Ajri	+	0	+	-	+	+	Pozitive
Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura në parkun Nacional "Mali Sharr"	0	0	+	-	+	+	Pozitive
Faktorët klimatik	0	+	0	-	+	+	Pa ndonjë efekt domethënës

Tabela .21. Matrica e përmbledhjeve të efekteve kumulative të të gjitha elementeve të PZHK-së në komponentët mjedisore

Në këtë Raport ndikimet mjedisore kumulativ përcaktohen si një kombinim i ndikimeve të zbatimit të veprimeve të Planit në aspekte të ndryshme të mjedisit. Gjatë implementimit të zhvillimeve të planifikuara të Planit, impaktet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale te mjedisit. Kur vlerësohen impaktet mbi token, ajrin dhe faktorët klimatike, biodiversitetit impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si shuma e impakteve të të gjitha masave, si të tilla në vlerësimin e impakteve kumulative mbi:

- ajrin, shkarkimet e ndotësve që pasojnë zbatimin e masave qe kombinohen; dhe
- burimet natyrore si burimet ujore, minerale dhe resurseve tjera të cilat kombinohen;

- token, zona toke bujqësore dhe e pyjeve e fragmentuar për shkak te integrimit te strukturave te infrastrukturës së re që kombinohen si efekte;
- faktorët klimatik, shkarkimet e gazeve serrë që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen.

Nga aspekti i impakteve mbi ajrin dhe faktorët klimatik, impaktet kumulative si shumë e impakteve te të gjithë veprimeve të PZHK-së janë të rëndësishme për realizimin e objektivave mjedisore:

- shkarkimet limiteve të ndotësve
- menaxhimin e mbetjeve inerte dhe
- sasia vjetore më e lartë e shkarkimit të gazeve serre.

Në vlerësimin e impakteve mbi ujin, natyrën, trashëgiminë kulturore dhe peizazhin, efekteve kumulative zakonisht nuk mund të shprehën si një shumë e impakteve te të gjithë veprimeve për të arritur synimet e PZHK-së. Kur vlerësohen efektet kumulative në aspektet e përmendura me sipër, karakteristikat e një impakti individual që kontribuon në efektet kumulative janë shumë të rëndësishme. Këto janë përgjithësisht karakteristika në të cilat impaktet ndryshojnë njëri nga tjetri sipas vendit (impakt direkt dhe ne distance) dhe kohës (afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjate, përkohësisht dhe permanent) të efekteve.

Nëse vlerësohen efektet mbi shëndetin njerëzor, efekti komulativ të PZHK-së shprehen si efekte të kombinuara komulative dhe zakonisht referohen për:

- zvogëlimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të bezdisjes akustike;
- zvogëlimin e ekspozimit ne nivelet e tejkaluara të ajrit të ndotur në mjedis; dhe
- masat e marra në PZHK që lehtësojnë veprimtari çlodhëse dhe rekreative në një mjedis.

Kur vlerësohen impaktet mbi popullatën dhe asetet materiale, impaktet kumulative të zbatimit të PZHK-së shprehen si një kombinim i impakteve të ndryshme që ndikojnë në hapësirën e tyre të jetesës dhe në jetën e tyre. Masat për të arritur synimet e PZHK-së janë positive nga aspekti i impakteve mbi popullsinë dhe asetet materiale, nëse efektet kumulative të tyre kontribuojnë në arritjen e kohezionit social, sigurinë dhe qëndrueshmërinë. Në vlerësimin e efekteve komulative në Biodiversitet të llojeve organike në zhvillimet e planifikuara shprehën si efekte të kombinuara duke rritur impaktin në biodiversitet, mirëpo me masat që janë marr me PZHK efekti do të jetë më i zbutur deri te efekti pozitiv për biodiversitetin.

13.1 Probleme të Mjedisit në Shtërpcës dhe Përgjigja që Jepet përmes PZHK-së

Tabela 22. e mëposhtme bën një përmbledhje të problemeve mjedisore që u identifikuan në Kapitullin 4 dhe të shkallës në të cilën PZHK-ja i u përgjigjet atyre, duke sugjeruar njëkohësisht edhe masa të tjera për mbrojtjen e mjedisit.

Tabela: Përmbledhje e Problemeve Mjedisore dhe përgjigja sipas PZHK-së

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa PZHK	Propozimet e PZHK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
1. Cilësi e ajrit.	Aktiviteti ndërtimor i pakontrolluar Rrugë të pashtruara Rritja e shpejtë e numrit të automjeteve Karburante të cilësisë së keqe Gjeneratorë me naftë Ngrohjjet individuale	Të gjitha shkaqet e përmenduara e ulin cilësinë e ajrit edhe pse kjo komunë eshte mjaft e mbuluar mjaft me vegjetacion	Nuk ka të dhëna për lidhjen, por sëmundjet, apo ndonje sëmundje tjetër që vjen si rezultat i cilësisë së ajrit.	Do të vazhdojë të përkeqësohet me rritjen e numrit të automjeteve. Mundet vetëm të ngadalësohet. Mund të balancohet vetëm nëpërmjet reduktimit të aktiviteteve ndërtimore. Mund të riparohet vetëm në rast se ndërmerren masat e duhura	Propozimet për pyllëzim Propozimet për shirita gjelbrues Propozimet për transportin publik dhe ciklizmit ka si qëllim ngadalësimin e rritjes së numrit të makinave private dhe reduktimin e ndotjes së ajrit të disa zonave të komunës. Rrugët e reja të cilat duhet të lehtësojë trafikun nëpër vendbanime.	Janë kryer dhe po kryhen studime mbi pyllëzimin. Janë kryer dhe po kryhen studime mbi transportin Përdorimi i karburanteve më të pastra (përmbajtje e squfurit të bjerë). Përmirësimet e rrugëve nga Komuna e Shtërpcës në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës.	Studim për të përcaktuar ndikimin dhe koston e cilësisë së keqe të ajrit në shëndet dhe ne ekonomi. Përmirësimi i teknikave të ndërtimit për të pakësuar pluhurin. Shtrimi i rrugëve, përmirësimi i trafikut edhe futja e korsive të biçikletave. Edukim më i mirë i publikut mbi shëndetin dhe cilësinë e ajrit. Përmirësimi i furnizimit me energji-zbutja e kërkesës nëpërmjet burimeve alternative të energjisë dhe përdorimit të gjeneratorëve, Vendosja e kritereve strikte për pyllëzimin Vendosja e kritereve strikte për Cilësinë e zonave të gjelbra (cilësia e mbulesës së tokës, dhe e mbulesës bimore). Rehabilitimi i zonave të gjelbra ekzistuese nën këtë këndvështrim.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa PZHK	Propozimet e PZHK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
2. Cilësi jo e mirë e ujit të lumenjve	Të gjitha ujërat e ndotura derdhen në lumej.	Ndikim në shëndetin e popullates njerezore, humbje e flores dhe faunes ne ekosisteeme ujore (mikrozoobentosit dhe makrozoobentosit)	Ndikon në sëmundjet infektive, sëmundjet tjera të cilat lidhen me përdorim të ujit dhe përmes zingjirit ushqimor.	Do të përkeqësohet më tej dhe mund t"i kthejë lumenjtë në septikë, vecanerisht ne stinen e veres, me rritjen e ngarkesës së ndotjes dhe reduktimit të bazës së prurjes nga prerja e pemëve. E riparueshme në se ndërmerren masat e duhura.	Skenari i zhvillimit të PZHK në përputhje me studimin e Planit hapësinor të Kosovës. Vendi i identifikuar për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura është në përputhje me Planit hapësinor të Kosovës pjesa e trajtimit të ujërave të ndotura. Trajtimi i përkohshëm dhe sipas zonave I ujrave të ndotura	Përgatitja e Projekteve Sektoriale për Trajtimin e ujërave të zeza të Shtërpcës	Zëvendësimi i tubacioneve të vjetra dhe të vogla qe do te shoqerohet edhe me minimizimi i rrjedhjeve. Maksimizimi i lidhjeve. Rregullimi i lidhjeve të paligjshme. Reduktimi i përdorimit gropave septike dhe lidhja me sistemin e kanalizimeve per ujërat e ndotura, lidhja me kolektorin kryesor të fshatrave,dhe ndertimi i impiantit të planifikuar.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa PZHK	Propozimet e PZHK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
3. Cilësi dhe sasi jo e kënaqshme e ujit të pijshëm	Humbje në sistem të furnizimit, tubat jo të cilësisë së duhur dhe mungesa e kontrollit të ujërave	Ndotja e ujërave nëntokësore Konsum i ujit në shishe dhe gjenerimi i mbetjeve plastike.	Shpërthim i sëmundjeve gastro-enterike, por lidhja e qartë nuk është provuar nga të dhënat shëndetësore.	Do të përkeqësohet me rritjen e përmasave të disa vendbanimeve dhe të kërkesave. Është i nevojshëm zhvillimi i burimeve të reja. Një ndikim i kthyeshëm nëse merren masat e duhura..	Skenari i zhvillimit i PZHK përputhet me studimet e mëhershme për cilësin dhe sasinë, Në PZHK janë parashikuar edhe përfshirja e infrastrukturës për shkak të interferencave që ka.	Duhet përgatiten projektet Sektoriale përkatës dhe trajtohet mundësia e financimit.	Zvogëlimi i humbjeve në rrjet. Shmangia e intersektimeve me linjat e ujrave te zeza. Reduktimi i lidhjeve të paligjshme. Përgatitja e projekteve për të shkuar drejt furnizimit të vazhdueshëm me ujë Mbrojtja e burimeve mbi sipërfaqe, eleminimi i shfrytëzuesveindividual të burimeve ujore.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa PZHK	Propozimet e PZHK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
4. Mbledhja dhe grumbullimi mbeturinave	Mungesa e një sistemi reduktim-ripërdorim-riciklim për mbetjet e ngurta në nivel të Komunës së Shtërpcës Grumbullimi i mbetjeve në komunë nuk është plotësisht i rregulluar pasi shumë prej tyre hidhen në lumenj dhe zona të tjera. Nëse vazhdohet me këto ritme, Shtërpcës do të ketë disa landfill ilegal brenda vjetëve të ardhshme. Mbetjet ndërtimore, dhe ato të tjera përzihen me mbetjet komunale.	Komuna gjeneron sasi të mbetjesh të ngurta. Në disa vendëbanime të Shtërpcës pamjet e mbeturinave mbeten të shëmtuara. Në komuna, sidomos në shtratin e lumit Lepenc pamja është shumë e shëmtuar. Mund te jene burim semundjesh vecanerisht ne stinen e nxehte.	Djegia e mbeturinave shton ndotjen e ajrit. Personat që jetojnë pranë ktyre deponive dhe her pas here kontrollojnë mbetjet janë të ekspozuar ndaj rreziqeve serioze për shëndetin. Rrezik potencial për shëndetin nga hedhja e mbetjeve të rrezikshme në zona afër dhe në disa raste edhe brenda vendbanimeve të komunës së Shtërpcës .	Sasia e mbetjeve do të rritet njëherazi me zhvillimet e reja Duhet përmirësuar mbledhja e mbeturinave në komuna. Rreziku se mund të ketë rritje të hedhjes së paligjshme të mbeturinave, pasi deponia e Gjilanit dhe Gërlicës është largë, ka kosto për deponim dhe transport dhe disa pika grumbullimi të përkohëshmend e nuk jan organizuar.	PZHK sugjeron fort adoptimin e një sistemi të integrur të administrimi t të mbetjeve të ngurta, bazuar në itinerarin reduktim-ripërdorim-riciklim-rekuperim. PZHK propozon zhvillim të transdeponiv e.	Duhet përgatitet Projekti Sektorial përkatës me mundësi financimi Për pikat e grumbullimit të përkohëshem të mbetjeve. Ky projekt sektorial do të eksplorojë opsione të ndryshme të trajtimit dhe menaxhimit me deponi të përkohëshme dhe transportit drejtë deponisë regjionale,	Grumbullim më i mirë në vendbanime dhe nivel komunal. Vënie në jetë e strategjive për reduktimin e mbetjeve dhe për riciklimin. Ndarje më e mirë e materialeve të rrezikshme. Për të shmangur hedhjet e paligjshme, organizimi mund të bëhet nga komuna për një numër të mjaftueshëm kamionësh, dhe të menaxhohet me transport nga deponia e përkohëshme drejt asaj regjionale njejtë të menaxhohet me pagesë për tone për hedhjen e mbeturinave në Deponin e regjionale duke krijuar sistem pagesash nga ata që hudhin mbeturina. Zbatimi i projekteve për pika grumbullimi në sistemin e stacioneve të transferit .

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa PZHK	Propozimet e PZHK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
5. Rehabil-itimi /Inkapsulim i pikave te nxehta të ndotjes	Ndotja e tokes nga aktivitete e ndryshme ekonomike dhe bujqësore	Ndotja e tokes dhe ajrit nga perberje të demshme per shëndetin e njeriut dhe biodiversitet	Ne vartesi te lendeve ndotese, mund të shkaktojnë një game të gjerë semundjesh	Mundë përkeqsohet edhe më tepër aktivitetet njerzore dhe ekonomike kanë bere qe në shumë vende të kete deponi teegra te cilat nese nuk eleminohen dhe rehabilitohen do te ken pasoja per shendetin publik.	Propozohet të studiohen të gjitha hapësirat, zonat me rrethinë ku jan zhvilluar industritë të vogla ose edhe sot ku pjesërisht funksionojnë në territorin e komunës së Shtërpcës që kane perdorur ose gjeneruar kimikate te rrezikshme per shendetin, para, gjatë edhe pas viteve 90-ta dhe mbi bazen e shkalles se rrezikut të behen nderhyrja teknike	Te mblidhet informacione më të thelluara për ketë gjendje, per nivelin dhe llojin e ndotjes, për ndikimet në tokë,ujë ajrë egzistencen e lidhjeve të territoreve te ndotura me kërcnimet për shëndetin, llojin e kërcnimit të bëhen analiza ne terren dhe laborator	Plani i menaxhimit dhe rehabilitimit të pikave të nxehta bazuar edhe në studim, analiz dhe VNM të detajuar Masat adekuate për shëndetin e njerëzve Masat tjera për konsolidim të tokës, mbrojtje të ujit dhe cilësisë së ajrit dhe Biodiversitetit dhe ekosistemeve tjera.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa PZHK	Propozimet e PZHK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
6. Shtrirja e ndërtimeve	Nevojat për banim Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar brenda dhe rreth vendban-imeve sidomos nëpër terrene me tokë të plleshme bujqësore dhe ato kodrinore.	Humbje e tokës së plleshme dhe gjelbrimit e pemëve të ndryshme, humbje e shtresës së sipërme të tokës, rrjedhje dhe mundësi për rrëshqitje/ përmbytje. Humbje e vlerave estetike. Humbje e vlerave peizazhistik e të teritorit komunal.	Jo i drejtperdrejte dhe i menjëhershëm Por shtrirja pa përcjellë me infrastruktur normal që shkakton edhe pasoja në shëndet Edhe rrëshqitjet e mundëshme të tokës dhe përmbytjet mund të shkaktojnë dëme serioze për jetën dhe pronën. Edhe humbja e gjelbrimit ka ndikimin e vetë në shëndetin e njeriut	Do të vazhdojë të zhvillohet me këto trende shkon në drejtim të përkeqësimit dhe do të jetë e pakthyeshme ?	Planifikohet kufiri ndërtimor për të gjitha vendbanimet Standartet dhe normat e planifikimit të përdorura në PZHK bëhen automatikisht të vlefshme Për të gjitha vendbanimet në Komunë. Parqe,zona të gjelbra dhe tampon zona për rreth disa vendbanimeve	PZHK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor rreth vendbanimeve statusin e zonave ku nuk lejohet ndërtimi PZHK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të ndërtimit të marrin statusin e parkut, zones së gjelbër dhe tampon zonës	Të përgatitet ekipi dhe një plan i Menaxhimit të ndërtimeve Të përgatiten projekte për gjelbrim, parqe dhe tampn zona. Moratoriumi për ndërtimet duhet të shtrihet edhe në gjitha zonat jasht kufijve të propozuar ndërtimor. Është e nevojshme të hartohen plane rregulluese edhe për vendbanimet në konceptin e zhvillimit policentrik.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa PZHK	Propozimet e PZHK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
7. Degradimi i pyjeve,	Prerja e pakontrolluar dhe ilegale e pyjeve Djegëjet e pyjeve Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar i disa vendbanimeve.	Ndotja e ajrit Ndotje e ujit, mungesë e kënaqësisë si për rezidentët ashtu edhe për vizitorët. Erozini në shkall të lart dhe prishjee balancit natyror.	Ndotja e ajrit edhe e ujit kan ndikim dhe pasoja në shëndet Edhe ndikimim	Do të vazhdojë me degradimin e mëtejm I pyjeve Të ketë ndotje Humbje të habitateve dhe ekosistemeve te rendesishme per komunen dhe per Kosoven	Revitalizimi i pyjeve ekzistuese Propozohen mbulim me fidane të reja siperfaqet e zhveshura Dhe parqe tjera të reja në disa vendbanime. Gjelbrim dhe tampon zona gjelbruese	Projekte konkrete pyllëzimi, revitalizimi,sanim për pyjet e Shtërpcës në zonat e parapara me PZHK	Ngritja e një mekanizmi bashkpunues në nivel të komunës dhe ministrive për këto projekte Kushtëzimi i projekteve të reja të infrastrukturës me gjelbrim dhe tampon zona. Aktivizim i gjykatave, policis inspektorëve në mënyr cilësore. Në ish venddepozitimet legale dhe ilegale masat rehabilituese dhe ri gjelbrim ose gjelbrim.
8. Humbje e trashëgimisë së ndërtuar kalaja e brezovicës dhe disa ZVM	Zhvillimet me trende të ndryshme nëpër vendbanime nuk jan në harmoni me arkitekturën ekzistuese.	Humbja e disa nga karakteristikat unike të vendbanimeve, cenim i identitetit dhe e kujtesës historike.	Të dhëna të pa disponuesh me por aspekti psikologjik dhe shpirtror mendohet se do jetë prezent	Do të vazhdojë dhe ndoshta do të përshpejtohet, duke qenë i pakthyeshëm.	Identifikon zonat brenda studimit të cilat do të ruhen. Propozon masat për ruajtjen. E orienton presionin për ndërtime drejt vendbanimeve dhe zonave më pak të pasura me këtë lloj trashëgimie	Identifikimi i instrumentave ekonomike dhe të valorizimit të territorit (psh, itinerare apo shtigje kulturore) që mund të bëhen mbështetje për komunitetet autoktone të Shtërpcës që banojnë ne këto vendbanime dhe zona.	Përditësimi, zgjerimi dhe mbajtja/pasurimi i listës së monumenteve të kulturës, e cila është përgatitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe institucione tjera qendrore dhe lokale për të mirëmbajtur zonat, ndërtesat që kanë vlerë të trashëgimis së ndeërtuar.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa PZHK	Propozimet e PZHK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
9. Rrezik për tërmete,rrëshqitja e tokës,vërshimet dhe element tjer rreziku	Shtërpca bën pjesë në zonë sizmike aktive të nivelit mesatar Ka rrëshqitje në disa zona dhe erosion e burime tjera rreziku	Varsisht por dine të jetë me ndikim të lartë mjedisor sidomos nga ndikimet idirekte	Mund të rezultojë katastrofik	komuna nuk ka një strategji të meaxhimit të risqeve natyrore ose tjera të shkaktuara	Në kodet e ndërtimit, por nuk specifikon nevojat e ndërsjellta.	Komuna duhet të ndërtojë brenda standarteve të larta anti-sizmike	Studim i terreneve për qëndrueshmëri sizmikenë rast se do të duhet të ndërtohet ndonjë pikë karburanti, duhet patur parasysh raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe raporti i vlerësimit të sigurimit teknik të karburantit, i cili duhet të ketë standarde shumë të larta.
10. Rreziqe nga radoni.	Rreziku natyror nga shtresa e kuqe e sub – argjilës të deltës së lumenjve	Nuk dihet plotësisht shkaku	Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj radioaktivitetit mund të shkaktojë kancer..	Rreziku mbetet i pamenaxhuar	Nuk ka	Nuk njihen	Përcaktimi i rreziqeve për shëndetin Përcaktim i zonave me rrezatim të lartë Kode të ndërtimit për të siguruar mbrojtje i nga radioaktiviteti i tokës nëpërmjet materialeve të padepërtueshme si dhe ventilimin. Ndërgjegjësim më i mirë rreth problemit.

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa PZHK	Propozimet e PZHK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
12. Rreziqe nga amiati / azbesti.	Rreziku kancerogjen nga ekspozimi ndaj lëshimit të fibrave të holla të amiatit në ajër	Fijet e holla futen brenda trupit të njeriut dhe maturojnë sëmundje kancerogjene në harkun kohor të 10-30 vjetëve brenda trupit.	Ekspozimi i qoftë edhe i rastësishëm dhe sado i vogël ndaj fijeve të amiantit.	Rreziku do të mbetet i njëjtë.	Sugjeron identifikim të zonave me prani të trashëguar të amiantit dhe ndërhyrje për sanitarizim të këtyre zonave	Duhen ndërhyrje bonifikuese në ndërtesat me përmbajtje amianti.	Përcaktimi i rreziqeve për shëndetin nga amianti. Kode të ndërtimit për të siguruar mbrojtje i nga emetimi i radioaktivitetit. Ndërgjegjësim më i mirë rreth problemit.
13. Rënie e biodiversitetit dhe humbje e florës dhe faunës.	Rritja e disa vendbanimeve por edhe zhvillimet me karakter ndërtimi po shkaktojn humbje në pyje dhe habitat. rritje e ndotjes	Nuk njihet plotësisht, por ka probleme të përgjithshme të humbjeve ekologjike. Rënie e efektit zbutës të florës për gjurmën e karbonit në disa zona të komunës	Humbje e zingjirit ushqimor, Aspekti kulturor, shkencor dhe rekreativ. Ndikim negativ në gjendjen psikologjike të banorëve	Do të vazhdojë të përkeqësohet.	Përkufizimi i ndërtimit është propozim i drejtpërdrejtë, dhe ulja e zhvillimit të çrregullt të vendbanimeve do të sjellë edhe uljen e humbjes në biodiversitet.	Projekte të asistuara nga BE, me qëllim fuqizimin e monitorimit të mjedisit në komunëduhet zhvilluar studime të situatës.	Nevoja për të pasur një studim bazë për Shtërpcën me qëllim identifikimin e humbjeve në biodiversitet dhe mundesite per permiresimin e situates..

14. Zonat e ndikimit të aktiviteteve në Shtërpcën	Të gjitha problemet e lartpërmendura, por nuk ka informacion të detajuar mbi ndikimin	Ndotje e lumenjve dhe tokës	Nuk dihen në hollësi por nënkuptohen	Ndotja e ajrit do të shtrihet në një zonë më të madhe me zgjerimin e vendbanimeve dhe përkeqësimin e ndotjes	Jashtë studimit, por problemet janë të njohura, sidomos rritja vendbanimeve dhe zhvillimet tjera industrial dhe ndërtimore.	Projekte të asistuara nga MMPH, BE etj për identifikimin e nivelit të ndikimit dhe zones së veprimit loka, komunal, kombëtar ose edhe ndërkombëtar	Nevoja për të pasur një studim bazë për Shtërpcën me qëllim identifikimin e ndikimit të aktiviteteve në zona dhe mundesite për permiresimin e situates

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja pa PZHK	Propozimet e PZHK	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
15. Ndotje akustike në Shtërpc	Qarkullimi i dendur dhe kaotik rrugor vlen të ceket me theks rrugët regjionale mosrespektimi i rregullave të qarkullimit rrugor, numri i lartë i automjeteve private për shkak të moseficensës së transportit publik, ushtrimi i aktiviteteve argëtuese jashtë standarteve, cilësia e ulët e automjeteve,	Nivel i lartë i zhurmave. Në zonat turistike.	Efekte kronike dhe akute në sistemin e dëgjimit, dhe dëmtim i sistemit nervor.	Rritja e vazhdueshme ose mosdisiplinim i problematikës.	Krijim i një rrjeti më të disiplinuar dhe më të mirë rrugor Përmirësim i transportit publik Krijimi i barrierave me bimësi aty ku është e mundur anës rrugëve.	Edukimi qytetar për mosshkaktimin e ndotjes akustike. Aplikmi ne ndertesat ekzistuese dhe te reja te materialeve izolues te zhurmave.	Masa të karakterit rregullator për standartet e mjeteve që lëvizin në komunë dhe penalitetet daj shkaktuesve të zhurmave në vendbanimet e Shtërpcës.

14. MONITORIMI

Në ligjin e "Vleresimit Strategjik Mjedisor", kerkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose shendetesore të zbatimit të planit apo programit, në menyrë që të identifkohen në fazë të hereshme pasojat negative të paparshikuara dhe me qellim marjen e masave rregulluese.

E njejta kerkese eshte parashikuar ne nenin 10 te Direktives se BE per VSM-n. Sipas po kesaj direktive, me qellim qe te shmangen dublikimet ne procesin e monitorimit, mund te perdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i pershtatshem.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është MMPH-ja nëpërmjet AKMM Agjensise Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit, e cila zbaton Monitorimin në bashkepunim me institucionet perkatese të Ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal .

Me qellim që PZHK-të të zbatohen me efektivitet dhe te realizohen objektivat dhe synimet qe janë percaktuar në Plan, është e domosdoshme dhe sic e parashtuam edhe me siper; eshte kerkese ligjore, që tëmonitorohet zbatimi i Planit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative ne mjedis.

Për të qene sa me racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do ti referohemi atyre tregueseve qe kane rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë përcaktuar për mbrojtien e mjedisit dhe kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbutese të PZHK-së. Plani Monitorimit permbledh shumë treguesë që perfaqësojnë një numer të konsiderueshem të elementeve të mjedisit.

Realizimi me sukses i kesaj ndermarrje kerkon angazhimin e mjafte institucioneve te cilet duhet te bashkërendojne aktivitet perkates monitoruese nen drejtimin e Agjensise Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit.

Mbeshtetur ne Ligjin për mbrojtien e mjedisit, Ligjin për VSM dhe VNM Komuna e Shtërpcës ka per detyre të kryej monitorimin e aktiviteteve qe kryen në kuadrin e zbatimit te PZHK-së. Këtu perfshihen qoftë Planet, projektet e Infrastrukturës që po hartohen ndërkohe, edhe detajimi i PZHK-së në Plane rregulluese per vendbanimet policentrike, lagje apo blloqe banimi.

Komuna e Shtërpcës ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota dhe të afta për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe per rrjedhojë, nuk mund te mbuloje me kapacitetet dhe burimet e saj njerezore dhe financiare te gjithe kete veprimtari. Megjithate ajo, duke angazhuar Drejtorin e planifikimit e Mjedisit dhe struktura te tjera në vartesi te saj mund te kryej nje pjese të programit të monitorimit si cilesine e ndertimeve, ecurine e pyllzimit dhe zhvillimit të pyjeve,zgjerimit të parqeve dhe siperfaqeve te gjelbra, ecurine nderimit te rrugeve të reja perfshire ato për qarkullimin me bicikleta dhe dhe te tjere indikatore qe jane paraqitur ne programin e monitorimit te PZHK-së.

Rezultatet e monitorimit, komuna e Shtërpcës sipas ligjit për VSM-n, duhet ti publikoj ne menyre periodike çdo vit. Per elementet e tjere te mjedisit duhet te procedohet sipas ligjeve që mbulojn fushen VSM,VKM per monitorimin dhe rezultatet ti percillen komunës së Shtërpcës dhe Agjensise Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor ti publikoj ne kuader te Raportit Vjetor per Gjendjen e Mjedisit ne Republiken e Kosovës.

Receptoret mjedisor	Objektivat e Mbrojtes së Mjedisit	Synimi	Indikatori	Raportimi	Institucioni pergjegjes
Shendeti banoreve	Promovimi per krijimin e nje komune të qendrueshem dhe të shëndetshme	1. Cilesia e burimeve te ujit te pishem konform stand. te BE ujrat siperfaqsore dhe nentokesore destinuara per uje te pishem 2. Cilesai e ujit te pishem konfrom standardit 3. Dendesia e popullsise e qendrushme në vendbanimet me trend të rritjes së popullësisë	1. Cilesia e burimeve te ujit te pishem, kundrejt standardit te BE. 2. Cilesia e ujit te pishem ne perputhje me standardin 1. Dendesia mestare për këto vendbanime	1. Rap.Vjetor 2. Rap.Vejtor 3.Rap.Vjetor	1. Drejt. E Urbanizmit e Shtërpcës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. 2. Drejt. Shërbimeve Publike Shtërpcës 3. komuna e Shtërpcës
Biodiversiteti	Ruajtja e llojeve të cilat janë në rrezik të zhdukjes nga aktiviteti njerzor	1. ndalimi i gjuetis së egër 2. marrja emasave per mbledhesit e bimeve mjekuese 3.Rehabilitimi i siperfaqeve te pyjore në zonat pyjore dhe ato të gjelbra ne zonat e banimit 5. Krijimi i korridoreve të gjelbera dhe tampon zonave	1. Siperfaqet e reja te krijuara, sip. m^2 2. Siperfaqe te reja, m^2 3.Siperfaqet te rehabilituara, m^2 5. Siperfaqe te kthyera ne zone te gjelber, pjese e koridorrit dhe	1. Raportim 1 here vit 2. Raportim 1 here ne vit. 3. Raportim 1 here ne vit 4. Raportim	1. komuna e Shtërpcës dhe MMPH 2. komuna e Shtërpcës dhe MMPH 3. komuna e Shtërpcës dhe MMPH 4. komuna e Shtërpcës

			tampon zona; m^2	1 here ne vit 5. Raportim 1 here ne vit	dhe MMPH &MBPZHR 5. komuna e Shtërpcës dhe MMPH &MBPZHR dhe Ministria e Infrastrukturës
Ajri	Permiresimi i cilesise se ajrit	1. Ulja e niveli te ndotjes se ajrit per: NOx; CO2 ; O3. 2. Rruge te asfaltuara rishtas 3. Ulja e nivelt te zhurmave ne zonat e ndjeshme ndaj zhurmave 4. Aplikimi ne banesat e reja i materialeve termizolues dhe mbrojtie akustike	1. Arritja e vlerave te standardit per cilesin e ajrit lidhur me tregusit mbi norme 2. Gjatesia e rrugeve te asfaltuara rishtas 3. Respekt i niveleve te lejuara te zhurmes gjate dites dhe nates 4. Ulja e niveli te zhurmave ne mjediste e banimit	1. Raportim 1 here ne 6 muaj 2. Raportim 1 here ne vit 3. Raportim 1 here ne 6 muaj 4. Raportim 1 here ne vit	1. AKMM dhe komuna e Shtërpcës 2. komuna e Shtërpcës 3. komuna e Shtërpcës 4. komuna e Shtërpcës
Faktoret klimatik	Kursimi i, energjise dhe paksimi i emisioneve te gazeve serre	1. Promovimi i objekteve me izolim adekuat 2. Promovimi i paneleve diellor per gjenerim energjie ne	1. Siperfaqja e objekteve (m_2) me izolim adekuat 2. Siperfaqja (m^2)e paneleve te instaluar	1. 1 here ne vit 2. 1 here ne vit	1. komuna e Shtërpcës 2. komuna e Shtërpcës

		ndertesat residenciale dhe sociale dhe energjia e krijuar nga era	dhe sipërfaqja e ngrohur nga energjia e erës (m^2)		
Uji	Cilesia e ujrave sip.ne perputhje me kerkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktives kuadre per ujin te BE	1.Shmangia e shkarkimeve te ujrave te ndotura ne Lumenj 2. Sigurimi i hudhjeve të mbeturinave në lumenj. me qellim ruajtien e niveleve minimal të ndotjes	1a. Vellimi i ujrave qe shkarkohen ne Lumenj; 1b. Vellimi i ujrave mbi normat e lejuara qe shkarkohen Lumenjë; m^3. 2. Siperfaqia e ndotjes (m^2) vllimi i mbeturinave (kg ose m^3) ,lloji mbeturinave shkruhet emir i saktë i mbeturinave të forta të gjetura në shtrat të lumit	1.Dy here ne vit 2. Dy here ne vit	komuna e Shtërpcës, AKMM. 2. komuna e Shtërpcës dhe AKMM
Mbetjet	3)Pakesimi i sasise se mbetjeve dhe manaxhimi qendrueshem i tyre b) Shnderrimi i pikave te nxehta mjedisore ne siperfaqe te gjelbra/parqe ose zona residenciale	a.1. Pakesimi ne burim dhe riciklimi i mbetjeve a.2. Vendosja e sistemit me disa konteniere per ndarjen ne burim te mbetjeve urbane b.1. Rehabilitim/inkapsulimi i	a.1. Sasia e mbetjeve urbane/person/vit dhe sasia(ton) e mbetjeve te ricikluara. a.2. Numri i residenteve qe mbulohen nga sherbimi me kontenier b.1. m^2te rehabilituara	a.1. 1 here ne vit a.2. 1 here ne vit b.1. 1 here ne vit	a.1. komuna e Shtërpcës ,kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjësisht AKMM a.2 komuna e Shtërpcës ,kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjësisht AKMM b.1. komuna e Shtërpcës ,kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjësisht AKMM

		pikave te nxehta ne territoret te mbyllura	ose inkapsuluara		
Rruget dhe Transporti	Reduktimi i intesnsitetit te trafikut nepermjet promovimit te transportit publik, qarkullimi me bicikleta ku mundet me ndodhë	1.Zgjerimi i rrjetit rrugor per trafikun publik 2. Zgjerimi i rrjetit te korsive per bicikleta 3. Ndertimi i rrugeve te reja me hapsira te pershtatshme trotuaresh (perfshire korsite e bicikletave). Zgjerimi i trotuareve gjate rehabilitimit te rrugeve ekzistuese. 4. Rehabilitim/asfaltimi i rrugeve lokale	1. Km rruge shtese qe mbulohen nga trafiku urban. 2. Km korsi shtese per levizje me bicikleta. Numuri i bicikletave ne qarkullim. 3. Km rruge te reja dhe te rehabilituara. m^2trotuarre dhe korsi bicikletash te shtuara. 4. Km rruge lokale te rehabilituara ose/dhe asfaltuara	1.1 here ne vit 2. 1 here ne vit 3. 1 here ne vit 4. 1 here ne vit	1. Komuna e Shtërpcës ,Ministria e infrastrukturës dhe MMPH 2. Komuna e Shtërpcës. 3. Komuna e Shtërpcës, Ministria e infrastrukturës dhe MMPH 4. Komuna e Shtërpcës.
Trashegimia kulturore	Shtimi dhe mbrojtia e vlerave te kulturore, perfshire ato arkeologjike dhe arkitekturore	Rehabilitimi, mirembajtia dhe ruajtja e objekteve te trashegimise kulturore	1.Numri i objekteve/ndertesave me status mbrojtes 2. Numri i objeketve/ndertesave te restauruara	1. 1 here ne vit 2. 1 here ne vit	1. Komuna e Shtërpcës Instituti për mbrojtjen e Monumenteve 2. Komuna e Shtërpcës Instituti për mbrojtjen e Monumenteve

Trashëgimia natyrore dhe zonat e mbrojtura	Mbrojtja e vlerave të trashëgimis natyrore, llojeve të cilat janë në "Listën e Kuqe" të Evropës ruajtja e zonave të mbrojtura në PN"Mali Sharr"	Promovimin e vlerave natyrore rekreative, turistike dhe shkencore të këtyre zonave dhe rendesisë së llojeve te cilat janë në "Listën e Kuqe".	Gjetja e formave per sensibilizim dhe kërkime shkencore me te shumta.	1 here ne vit	Komuna e Shtërpcës, Ministria e MMPH-ja dhe instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës
Peizazhi, pyjet dhe toka	1.Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik 2. Mbrojtja e mjedisit natyror ne hapësirat për rreth vendbanimeve 3. Riperdorimi i tokave te ndotura 4.Mirmbajtje dhe zhvillim i pyjeve 5.Kultivim i pyjeve të reja	1. Shtimi i hapsirave te reja dhe numurit te pemeve e shkurreve. 2. Dhenie e statusi mbrojtie dhe hartimi i nje plani manaxhimi mjedisor I ktyre hapësirave. 3. Rehabilitimi i tokave te ndotura(pikat e nxehta mjedisore) dhe venia ne eficiense per zona te gjelbera/parqe ose rezidenciale 4.Zhvillimi i pyjeve ekzistuese 5. Pyllëzimi I hapësirave të zhveshura	1. Siperfaqet ne m_2 dhe numuri i pemeve te mbjella 2.Progresi i zbatimit te planit 3. Siperfaqe toke e ndotur e rehabilituar (m_2) dhe e vene ne perdorim sipas PZHK. 4. Siperfaqe toke së zhvilluar pyjore (ha) 5. Siperfaqe toke së re pyjore (ha)	1. Një here ne vit 2. Një here ne vit 3. Një here ne vit 4. Një here ne vit 5. Një here ne vit	1. Komuna e Shtërpcës 2. Komuna e Shtërpcës 3. Komuna e Shtërpcës 4. Komuna e Shtërpcës dhe MBPZHR 5. Komuna e Shtërpcës dhe MBPZHR

15. PERFUNDIME DHE REKOMANDIMET

Shtërpca është komuna e cila ndodhët në territorin me vlera të larta natyrore për shkak të bjeshkëve të Sharrit dhe parkut nacional "Mali Sharr" po ashtu kjo komunë posedon begati të mdha natyrore për shkak të relievit të saj dhe kushteve tjera klimatike, orografike, biodiversitetit, ekosistemeve të veçanta, shtrirjeve e mbulesave vegjetative nga nivelet me të ulta deri te zona subalpike dhe alpike. Andaj projektet e parapara me PZHK dhe zbatimi rigoroz i tyre dhe sugjerimeve të cilat u dhan në VSM në përgjithësi do të ketë ndikime pozitive në mjedis. PZHK do të orientojë rritjen e mundëshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa vendbanime të komunës së Shtërpcës me qëllim dendësimin në zonat që janë të pastabilizuara ende dhe të zhvillojë zona të reja banimi dhe shërbimesh të qëndrueshme rreth ktyre vendbanimeve aktuale në komunën e Shtërpcës. PZHK gjithashtu do të ruajë trashëgiminë e ndërtimit, krahas nxitjes së një peizazhi me pamje më të këndshme duke eleminuar pamjet e vrazhda sidomos në vikendzonën në Brezovicë. PZHK-ja do të sjellë përmirësime në mjedis, do të kontribojë në mbrojtjen e zonave me vlera natyrore dhe ekosistemet me vlera të larta si dhe zhvillimin e pyjeve në të gjitha zonat pyjore dhe parqeve brenda dhe rreth vendbanimeve, krahas aspektit të rëndësishëm të parandalimit të depërtimit (shtrirjes) në tokat e plleshme bujqësore përreth lumit Lepenc. Përfitimet kryesore të këtij plani lidhen kryesisht me përdorimin në mënyrë me efikase të tokës. Komuna duhet të kujdeset për ruajtjen e vlerave natyrore dhe peisazhore të lumenjve sidomos lumit Lepencë i cili kohëve të fundit "vuan" nga ndotja e lartë nga kanalizimet dhe nga ndërhyrjet në devijimin e rrjedhës së tij.

Plani Zhvillimor Komunal ka përfshirë edhe planin e PN "Malit Sharr" dhe Master Planin e qendres se re të skijimit si dhe mundësin e ndërlidhjes së zonave turistike të kësaj komune me zonën turistike të Përvallës, keshtu duke i harmonizuar zhvillimet e reja në raport me këto dy plane dhe zhvillimet dhe planet tjera. Ai gjithashtu shoqerohet me pjesemarrje të gjere publike në nivelin teknik dhe strategjik, me VSM, me disa strategji e plane të më hershme, me GIS, Vlersim të Kapaciteteve Investive, si dhe mundesine e publikut të gjere të konsultohet dhe te shprehet për projekt-Planin. PZHK lejon mundesinë e qartesimit dhe detajimit më të hollësishëm gjatë hartimit të Planeve dhe projekteve tjera lokale (planeve rregulluese). Si e tillë, alternativa e paraparë me PZHK vlersohet e mirë dhe adekuate në kuptimin mjedisor dhe aspektet tjera .

Jane pasur parasysh parimet e pergjithshme për planifikimin hapesinor të bazuar mbi eksperiencat ndërkombëtare, si nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm, parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror, ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejsazhere, zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, informimi dhe përfshirja e komunitetit në vendimmarrje, etj.

Zbatimi praktik i parimeve të përgjithshme në rastin e PZHK-së nxjerr disa përparësive si psh. Zhvillimi kompakt dhe policentrik i vendbanimeve, densifikim përpara shtrirjes për ngadalësimin e shpërndarjes pertej vijave cilat kufizojn ndërtimin, strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent, krijimi i rrugëve të reja brenda vendbanimeve ekzistuese, rehabilitimi i lagjeve ekzistuese, ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe historike, ruajta e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve në vendbanime, dhe zgjerimi i zonës së ndërtimit atje ku kushtet janë të favorshme.

Plani përpiqet të përmbushë disa objektiva strategjike të pranuara gjerësisht përfshi:

- Komuna e Shtërpcës komunë e cila perballon nevojat për banim të banorëve të saj dhe turist nga jasht vendit;
- Komuna e Shtërpcës komunë e shëndetshem me peizazhe dhe ekosisteme interesante;
- Komuna e Shtërpcës komunë policentrike sipas konceptit perfundimtar;
- Shtimi i siperfaqeve te gjelbra duke synuar rritjen e potencialit ekologjik dhe zhvillimin, krijimin e pyjeve, koridoreve ekologjike dhe tampon zonave në Shtërpcës;
- Zgjerim të rrugeve por dhe nxitjes se ecjes kembesore dhe me bicikleta;
- Permiresim transportit publik (përmiresim i shërbimit të autobusëve);
- Zgjerim i vendbanimeve me trende pozitive në drejtimin të tokave me plleshmëri më të dobët

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në Shtërpcës, rritjen e sigurisë, shtim të mundësive për mënyrë aktive të jeteses, shtim i siperfaqeve të gjelbra, përmiresim i cilësisë së ajrit, etj. dhe duhen shoqeruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

VSM sugjeron disa veprime operacionale konkrete per ruajtjen e vlerave mjedisore dhe vlerave tjera te trashëgimisë

Veprime operacionale në Shtërpc:
Krijimi i projekteve për zbatim në zonat e mbrojtura të rekognozuara në komunën e Shtërpcës siç janë: Zonat e mbrojtura në PN "Mali Sharr", Pyllëzimi dhe ripyllzimi i zonave të parapara me PZHK, krijimi i parqeve të reja nëpër dhe për reth vendbanimeve; zgjatimi dhe permiresimi i kushteve ekologjike në koridorin pergjate lumejve; krijimi i lulishteve dhe kopshteve në qytetin e Shtërpcës; kthimi i zonave te ndotura ne siperfaqe te gjelbra; gjelberimi me peme dhe shkurre dekorative pergjate rrugeve dhe trotuareve; ngritja e barrierave të dendura me gjelberim si perde që ndajn rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjate rrugeve me trafik të dendur me qellim te shumefishte (rritje gjelberimi, permiresim cilesise se ajrit permes filtrimit te pluhurave, si edhe rritje e sigurise rrugore); trajnim i grupeve të ndryshme të cilat merren me mbrojtje dhe sensibilizim të vlerave mjedisore. Veprimet në infrastrukturë: ndertimi i një rrjeti rrugor që lidhin Shtërpcës me rajonin; përmiresim i gjendjes së rrugeve ekzistuese dhe zgjerim sipas mundesise; krijim i rrjetit të plote rrugor në vendbanmet e mëdha me përmbajtje edhe për biciklistet dhe kembesoret; permiresim i sistemit, orareve dhe cilesise se autobuzeve; përmiresimi i projektimit te rrugeve me parashikimin e trotuareve te plota dhe shiritave/korsive per bicikletat sipas standarteve europiane te rrugeve;

Plani do të jete një dokument që që ofron vizion, qëllime dhe objektiva per zhvillimin hapësinor të komunës së Shtërpcës. PZHK-ja duhet te fuqizoje komunën të luaje rol me aktiv mes paleve për të ofruar mundesi për të mos mbetur peng i mosmarrveshjeve mes paleve.

VSM gjithashtu i vendos disa kufizime zhvillimit që parashikohet nga PZHK-ja. Kriteret mjedisore qe kufizojne zhvillimin komunal jane (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetsore, (2) kritere të trashegimisë kulturore, (3) kritere peisazhike dhe (4) kritere inxhinierike dhe te infrastrukturës.

Parashikohen një seri masash zbutëse ndaj ndikimeve të mundshme mjedisore gjatë zbatitmit të PZHK-së. Masat zbutëse synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku

standardet mjedisore janë të cënuara dhe të sigurojnë që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Planin Zhvillimor Komunal të bëhen në përputhje me standardet mjedisore.

Monitorim i zbatimit të PZHK-së dhe parametrave mjedisore te tij do jetë kyç i suksesit për garantimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Parashikohet të monitorohen treguesit e mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

16. LITERATURA

1. American Planning Association (Steiner Frederick and Butler Kent eds.). 2010. Standartet e planifikimit dhe projektimit urban, Ufo University Press.
2. Agjensia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit . Raport i Gjendjes së Monitorimit të Mjedisit per vitin 2010.
3. Komuna e Shtërpcës. 2020 Hartat e prezantuar në PZHK.
4. Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 – 2009; UNDP- Kosovë
5. Technical Support to design Brezovica development plan, Kosova
6. Publikim Drejtoria e Parqeve Nacionale- Parku Nacional "Mali Sharr" Drejtoria e Parkut Nacional "Mali Sharr"
7. Vlerat natyrore Flora dhe fauna e Parkut nacional ,,Malet e Sharrit" Drejtoria e Parkut Nacional "Mali Sharr"
8. Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2008-2010
9. Parku Nacional "Mali Sharr" Draft Plani Hapësino 2009
10. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin; 2011 – 2020
11. Vlerësimi Strategjik Mjedisor i PZHK-së, 2012
12. Gjendja e Resurseve Natyrore në Parkun Nacional Për Vitin 2008.
13. Sustainable Development Goals (SDG)
14. Qendra Rajonale e Mjedisit. REC
15. Raporti për gjendjen e natyrës 2015-2017;
16. Raport mbi menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë 2018;
17. Raporti i Mbuleshmerisë së Sipërfaqes së Tokës, CLC 2018;
18. Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2017;
19. Ernest A. LoËe (1997-2001) Eco-industrial Park Handbook for Asian Developing Countries;
20. Agenda 21, UN-Habitat (2009). Planning for Sustainable Cities, UN-Habitat. Nairobi, Kenya.
21. Environment, Health and Safety Resource Centre Limited, 2014, Environmental Impact
22. Assessment Study for the Proposed Eastern Industrial Park Njiru area, Nairobi County
23. Parlamenti Evropian/Direktiva e Këshillit SEA. [www dokument] URL: AktetLigjore: http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32001L0042:EN:NOT;
24. Dalal-Clayton, D., Sadler, B. (2005). Vlerësimi Strategjik Mjedisor: libër i të dhënave dhe udhëzues rreth përvojës ndërkombëtare. Earthscan, SHBA
25. Konventa e UNECE Mbi Qasjen në Informacione, Pjesëmarrjen Publike në Vendim-marrje dhe Qasjen në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Konventa Aarhus), 1998. [WWW. dokument] URL: http://live.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf
26. Ligji i Kosovës mbi Planifikimin Hapësinor. [WWW dokument] URL: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_14_en.pdf
27. Ligji i Kosovës mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor. [WWW dokument] URL:

http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-230-eng.pdf
28. Qendra Rajonale Mjedisore për Evropën Qendrore dhe Lindore, REC. (2000). Analiza Strategjike Mjedisore e Kosovës. Zyra e REC në Kosovë, Prishtinë. URL: http://archive.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF
29. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2011). Strategjia mbi Menaxhimin e Mbeturinave 2011-2020). Prishtinë, 2011;
30. The Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe, REC. (2000). Strategic Environmental Analysis of Kosovo. REC field office in Kosovo, Pristina. http://archive.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF
31. The UNECE Convention on Environmental Impact Assessment in a TransboundaryContext(EspooConvention),1991.WWWdocument] RL:http://www.unece.org/env/eia/about/eia_text.html.
32. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (2011). Strategjia për Mjedisin 2013-2022).
33. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin; 2011 – 2020;